


VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
PËR
HARTËN ZONALE TE KOMUNËS SË DEÇANIT



Qershor 2026

Ekipi hartues i raportit të VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Deçanit
Përgatitur nga

Aida Dobruna eksperte e VSM-së.

Tel: +383 49 112038

aidadobruna@gmail.com

Nr. i licencës 30/19/24

Lumnije Gashi Shabani eksperte e VSM-së.

Tel: +383 49 647 457

Lumnijegashi8@gmail.com

Nr. i licencës 45/19

I.Hyrje.....	6
1.1. Prapavija.....	6
1.2. Qëllimi i raportit të VSM-së.....	6
1.3. Baza ligjore	7
1.4. Metodologjia për hartimin e raportit të VSM-së	10
1.5. Struktura e raportit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM)	10
II. PËRMBLEDHJE E PËRMBAJTJES SË HARTËS ZONALE TË KOMUNËS (HZK)	11
2.1. Struktura e përmbajtjes së HZK-së	11
2.2. Përshkrimi i përmbajtjes së HZK-së	13
2.3.Përmbledhja përmbajtësore e HZK-së.....	18
2.3.1 Kushtet e përgjithshme për zhvillim në të gjitha zonat	19
2.3.2 Lista e zonave.....	20
2.3.3 Shfrytëzimet e tokës për të gjithë territorin e komunës	23
Shfrytëzimet e lejuara	24
Shfrytëzimet dytësore	24
Strukturat e përkohshme	24
Shfrytëzimet e veçanta	25
Shfrytëzimet e ndaluara.....	25
Qasja në infrastrukturën teknike.....	25
Qasja në infrastrukturën sociale	25
2.3.4 Zonat e destinuar, kushtet zhvillimore/ ndërtimore dhe shfrytëzimet ...	26
2.3.5 Trajtimi Vendbanimeve joformale	32
2.3.6 Përcaktimi i zonave për të cilat hartohet Plani Rregullues i Hollësishëm. 33	
2.3.8 Proceset për ndryshime, përjashtime, jokonformitete dhe bonuset e zonimit.....	36
2.3.9 Dispozitat për interpretimin, ankesat, zbatimin dhe monitorimin e zbatimit	

të Hartës Zonale të Komunës.....	37
III. ÇËSHTJET KYÇE MJEDISORE DHE OBJEKTIVAT E VSM-së	38
3.1. Analiza e aspekteve mjedisore.....	38
3.2 Karakteristikat gjeografike	38
3.2.1 Gjeologjia	38
3.2.2 Seizmika	39
3.2.4 Erozioni	40
3.3 Karakteristika socio-ekonomike të Komunës së Deçanit.....	40
3.3.1 Popullsia dhe shëndeti publik	40
3.4 Përshkrimi i gjendjes ekzistuese të mjedisit dhe zhvillimit të tij të mundshëm	41
3.4.1 Cilësia e ajrit.....	41
3.4.2 Faktorët klimatik	42
3.4.3 Biodiversiteti, flora, fauna dhe peizazhi	42
3.4.4 Aspekti arkitekturor dhe visual	43
3.4.5 Toka	43
3.4.6 Uji.....	45
3.4.7. Trashëgimia kulturore	46
3.4.8 Mbeturinat.....	47
3.4.10 Faktorët socio-ekonomik	50
3.5 Analizë e problemeve dhe mundësive të aspekteve mjedisore.....	51
3.6. Objektivat e VSM-së	54
IV. VLERËSIMI I PËRPUTSHMËRISË SË ZHVILLIMEVE TË ZONAVE TË PËRCAKTUARA ME HZK-së me OBJEKTIVAT E VSM-së.....	54
4.1. Metodologjia e vlerësimit.....	54
4.2. Vlerësimi i përputshmërisë së zhvillimeve të parapara në kuadër të HZK-së dhe efekteve të tyre me objektivat e VSM-së	55
4.2.1. Faktori mjedisor A: Cilësia e dheut dhe shfrytëzimi i tokës	55
4.2.2. Faktori mjedisor B: Cilësia e ujërave	57
4.2.3. Faktori mjedisor C: Cilësia e ajrit.....	58
4.2.4. Faktori mjedisor D: Zhurma dhe vibrimi	60
4.2.5. Faktori mjedisor E: Biodiversiteti dhe zonat natyrore të mbrojtura.....	61
4.2.6. Faktori mjedisor F: Faktorët e ndryshimeve klimatike	63
4.2.7. Faktori mjedisor G: Mirëqenia e popullsisë dhe ekonomia lokale	65
4.2.8. Faktori mjedisor H: Shëndeti publik.....	66
4.2.9. Faktori mjedisor I: Trashëgimia kulturore	68
4.2.10. Faktori mjedisor J: Peizazhi dhe vlerat vizuale estetike.....	70
4.2.11. Faktori mjedisor K: Menaxhimi i mbeturinave	71
4.2.12. Faktori mjedisor L: Trafiku dhe transporti.....	73
4.3. Gjetjet kryesore mbi efektet e pritshme nga zbatimi i HZK-së	75
V. VLERËSIMI I EFEKTEVE MJEDISORE DHE MASAT E PARASHIKUARA.....	75

5.1 Masat e parapara lehtësuese për eliminimin apo zbutjen e efekteve të mundshme negative të shkaktuara nga zbatimi i HZK-së	75
VI. PLANI I MONITORIMIT TË ZBATIMIT TË MASAVE	78
VII. Rezultatet e konsultimeve me organet, organizatat dhe publikun	83
VIII Konkluzione dhe rekomandime	83
Shtojce: Permbledhja joteknike	85

LISTA E FIGURAVE

- Figura 1 - Harta e shfrytëzimit të tokës
- Figura 2. Harta për propozimet për hartimin e Planeve të Hollësishme Rregullues
- Figura 3. Harta gjeologjike e komunës së Deçanit (Burimi: Plani Zhvillimor Komunal 2024-2032)
- Figura 4. Harta e erozionit (burimi: Plani Zhvillimor Komunal 2024-20032)
- Figura 5, Harta e rrjetit të Ujësjellësit
- Figura 6. Harta e Rrjetit të kanalizimit
- Figura 7. Vendndodhja e objekteve të parashikuara për menaxhimin e mbeturinave në ZMM

LISTA E TABELAVE

- Tabela 1. Ligje, strategji dhe dokumente tjera të rëndësishme për hartimin e raportit të VSM
- Tabela 2.- Planet dhe strategjitë lokale
- Tabela 3. Tërësitë, zonat, njësitë
- Tabela 4. Lista e llojeve të zonave, nën zonave dhe zonave mbishtresore
- Tabela 5. Llojet e zonave recreative turistike
- Tabela 6. Zonat, parametrat zhvillimor, shfrytëzimet
- Tabela 7 - Masat zbutese që duhet me i ndermarre për minimizimin apo eliminimin e ndikimit negativ në mjedis
- Tabela 8.- Emetimet në ajër -Deçan, 2021-2022
- Tabela 9- Lloji i tokës
- Tabela 10 - Shfrytëzimi i tokës
- Tabela 11 - Lista e kategorive të trashëgimisë kulturore
- Tabela 12 . Deponit ilegale komunale ndër vite
- Tabela 13- Numri i ekonomive familjare dhe mbeturinat e gjeneruara
- Tabela 14 - Normativat e ndërtimit të deponive
- Tabela 15 - Analiza e problemeve dhe mundësive mjedisore në Komunën e Deçanit
- Tabela 16 - Objektivat e VSM-së
- Tabela 17 : Kriteret për vlerësim
- Tabela 18: Cilësia e dheut dhe shfrytëzimi i tokës
- Tabela 19: Cilësia e ujërave
- Tabela 20 : Cilësia e ajrit
- Tabela 21: Zhurma dhe vibrimi
- Tabela 22: Biodiversiteti dhe zonat natyrore të mbrojtura
- Tabela 23: Faktorët e ndryshimeve
- Tabela 24: : Mirëqenia e popullsisë dhe ekonomia lokale
- Tabela 25: Shëndeti publik

Tabela 26: Trashëgimia kulturore

Tabela 27 : Peizazhi dhe vlerat vizuale estetike

Tabela 28: Menaxhimi i mbeturinave

Tabela 29 : Trafiku dhe transporti

Tabela 30: Tabela përmbledhëse e efekteve dhe masat zbutëse

Tabela 31 : Plani për monitorimin e zbatimit të masave dhe menaxhim mjedisor

LISTA E AKRONIMEVE DHE SHKURTESAVE

AMMK	Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit në Kosovë
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
HEC	Hidrocentralet
HZK	Harta Zonale Komunale
IHM K	Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KK	Kuvendi Komunal
MAPL	Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal
MBPZHR	Ministria për Bujqësi, Pylltari, dhe Zhvillim Rural
MEM	Ministria e Energjisë dhe Minierave
MI	Ministria e Infrastrukturës
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
PRrH	Plani Rregullues i Hollësishëm
PRrU	Plani Rregullues I Hollësishëm
PTK	Posta dhe Telekomu i Kosovës
PZHK	Plani Zhvillimor Komunal
TIK	Teknologjia Informative dhe e Komunikimit
VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
VSM	Vlerësimi Strategjik Mjedisor

I.Hyrje

Ky Vlerësim Strategjik i Mjedisit (VSM) është hartuar për Hartën Zonale të Komunës së Deçanit, me synim adresimin e sfidave ekzistuese që lidhen me zbatimin e saj. Duke marrë parasysh rëndësinë e një qeverisjeje të përgjegjshme ndaj mjedisit, VSM siguron që ndikimet e mundshme të HZK-së të analizohen në mënyrë të kujdesshme dhe që mbrojtja e mjedisit të integrohet në procesin e vendimmarrjes që në fazat fillestare.

1.1. Prapavija

Procesi i hartimit të Hartës Zonale Komunale (HZK) të Komunës së Deçanit për periudhën 2026–2034 ka filluar në mënyrë formale me marrjen e vendimit për hartimin e saj më 31.05.2018, duke u zhvilluar në përputhje me kornizën ligjore për planifikimin hapësinor dhe në funksion të zbatimit të objektivave të Planit Zhvillimor Komunal. Që në fazën fillestare, Komuna ka dëshmuar një përkushtim të strukturuar institucional për këtë proces, përmes grumbullimit të dokumentacionit relevant, analizës së bazës ligjore dhe krijimit të grupeve punuese ndërsektoriale që mbulojnë çështje të mjedisit, shëndetësisë, ekonomisë, arsimit, infrastrukturës dhe shërbimeve sociale.

Procesi është realizuar përmes një sërë fazash të përcaktuara në mënyrë sistematike, duke përfshirë rifunksionalizimin e mekanizmave institucionalë si Ekipi Komunal për Planifikim dhe Ekipi Komunal për Mbrojtje të Mjedisit, si dhe organizimin e një serie veprimesh procedurale dhe pjesëmarrëse, si takimet publike, konsultimet me grupet tematike dhe institucionet qendrore, hapjen e shqyrtimit publik dhe prezantimet në nivel lokal në lagje dhe fshatra. Ky proces gjithëpërfshirës dhe transparent ka garantuar përfshirjen aktive të qytetarëve, ekspertëve dhe aktorëve institucionalë në ndërtimin e një dokumenti strategjik që reflekton nevojat dhe potencialet e territorit komunal.

HZK paraqet një instrument kyç shumësektorial që orienton zhvillimin e qëndrueshëm dhe menaxhimin racional të hapësirës, duke përcaktuar zonat për zhvillim ekonomik, bujqësi, turizëm, infrastrukturë dhe mbrojtje mjedisore e kulturore. Në këtë kontekst, domosdoshmëria për hartimin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM) ka qenë e integruar që në fillim të procesit, si një obligim ligjor dhe një instrument thelbësor për të siguruar që ndikimet mjedisore të planifikimit të vlerësohen në mënyrë sistematike dhe të përfshihen në vendimmarrje.

Përkushtimi i Komunës së Deçanit për hartimin e VSM-së reflektohet në integrimin e konsideratave mjedisore në të gjitha fazat e hartimit të HZK-së, në bashkëpunimin e ngushtë ndërinstitutional dhe në përfshirjen e ekspertizës relevante për të identifikuar, parashikuar dhe vlerësuar efektet potenciale në mjedis. Ky qasje siguron një balancë të qëndrueshme ndërmjet zhvillimit dhe ruajtjes së resurseve natyrore dhe kulturore, duke kontribuar drejtpërdrejt në përmirësimin e cilësisë së jetës, rritjen e kapaciteteve institucionale dhe orientimin afatgjatë të zhvillimit të komunës.

Në përfundim, HZK dhe VSM përbëjnë një kornizë të integruar planifikuese që dëshmon angazhimin e Komunës së Deçanit për zhvillim të qëndrueshëm, gjithëpërfshirës dhe në përputhje me parimet bashkëkohore të menaxhimit të territorit dhe mbrojtjes së mjedisit

1.2. Qëllimi i raportit të VSM-së

Qëllimi i Raportit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM) për Hartën Zonale të Komunës së Deçanit është të sigurojë që zhvillimi hapësinor i paraparë përmes këtij dokumenti planifikues të jetë në përputhje me parimet e mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Raporti synon të identifikojë, parashikojë dhe vlerësojë në mënyrë sistematike ndikimet e mundshme mjedisore që mund të rezultojnë nga zbatimi i Hartës Zonale, duke garantuar që konsideratat mjedisore të integrohen që në fazat e hershme të planifikimit.

Në këtë kuadër, VSM shërben si instrument për të mbështetur vendimmarrjen e informuar, duke analizuar ndërveprimin ndërmjet përdorimit të tokës, zhvillimit urban, aktiviteteve ekonomike dhe burimeve natyrore. Ai synon të sigurojë mbrojtjen dhe përmirësimin e cilësisë së mjedisit, përfshirë ajrin, ujin, tokën, biodiversitetin dhe peizazhin, si dhe ruajtjen e trashëgimisë natyrore dhe kulturore të komunës.

Raporti gjithashtu ka për qëllim të propozojë masa parandaluese, zbutëse dhe përmirësuese për të adresuar ndikimet negative të identifikuar, duke forcuar efektet pozitive të planifikimit hapësinor. Përmes këtij procesi, VSM kontribuon në harmonizimin e Hartës Zonale me dokumentet strategjike të nivelit më të lartë, veçanërisht me Planin Zhvillimor Komunal, si dhe me kornizën ligjore në fuqi, duke siguruar një zhvillim të balancuar, gjithëpërfshirës dhe afatgjatë për Komunën e Deçanit. Raporti i VSM-së duhet të lexohet në bashkë me HZK-në

1.3. Baza ligjore

Baza ligjore për Vlerësimin Strategjik Mjedisor (VSM) mbështetet në Ligjin Nr. 03/L-230 për VSM (2010), i cili është i harmonizuar me Direktivën 2001/42/EC të Bashkimit Evropian, si dhe me ndryshimet e fundit përmes Ligjit Nr. 08/L-176 (2023), në përputhje me procedurat e përgjithshme administrative.

Përmes VSM-së synohet të sigurohet një nivel i lartë i mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit të njeriut, duke integruar konsideratat mjedisore në procesin e hartimit, miratimit dhe zbatimit të Hartës Zonale Komunale. Ky proces garanton që ndikimet mjedisore të identifikohen dhe të merren në konsideratë gjatë vendimmarrjes, si dhe të propozojnë masa për parandalimin dhe zbutjen e efekteve negative

Tabela 1. Ligje, strategji dhe dokumente tjera të rëndësishme për hartimin e raportit të VSM

Ligji	Qëllimi
Ligji Nr. 08/L-165 për Vlerësimin Strategjik Mjedisor (VSM, 2023)	Ky ligj rregullon vlerësimet mjedisore për politikën, planet dhe programet publike, duke siguruar që konsideratat mjedisore të integrohen që në fazat më të hershme të planifikimit strategjik. Ai përfshin kërkesat për konsultime ndërkufitare dhe është plotësisht në përputhje me Direktivat e BE-së 2001/42/EC për Vlerësimin Strategjik Mjedisor (SEA).
Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit	Ky ligj do të harmonizojë zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien sociale me parimet themelore për mbrojtjen e mjedisit sipas konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm. Qëllimi i këtij ligji është të promovojë krijimin e mjedisit të shëndetshëm për popullin e Kosovës me sjelljen graduale të standardeve të Bashkimit Evropian për mjedisin
Ligji Nr. 08/L-181 mbi Vlerësimin e ndikimit në mjedis	Qëllimi i këtij ligji është të parandalojë ose zbusë ndikimet negative të projekteve të propozuara publike dhe private dhe në këtë mënyrë të kontribuojë në ruajtjen dhe përmirësimin e mjedisit, mbrojtjen e shëndetit të njeriut, si dhe përmirësimin e cilësisë së jetës.
Ligjinr.04/L-174për planifikimin hapësinor:	Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm dhe të baraspeshuar të planifikimit hapësinor për tërë territorin e Kosovës si vlerë e përgjithshme kombëtare, përmes qeverisjes së mirë, shfrytëzimit të përshtatshëm të tokës, mbrojtjes së mjedisit dhe trashëgimisë kulturore dhe natyrore. Ligji ka për qëllim të sigurojë qeverisje të qëndrueshme, shfrytëzim efikas të fondeve publike, parakushte për zhvillim social dhe ekonomik të baraspeshuar, rregullim të qëndrueshëm të hapësirës, duke siguruar trajtim të barabartë, lëvizje të lirë dhe qasje adekuate në shërbimet publike për qytetarët
Ligji nr. 04/L-110 për ndërtim	Përcakton kërkesat kryesore për projektim, ndërtim, përdorim të produkteve ndërtimore, mbikëqyrje profesionale si dhe për procedurat e lejeve të ndërtimit, lejeve të përdorimit dhe inspektimit e ndërtimit. Dispozitat e këtij Ligji rregullojnë kushtet e projektimit dhe të ndërtimit lidhur me sigurinë publike dhe mbrojtjen e mjedisit në Kosovë

Ligji nr. 03/L-233 për mbrojtjen e natyrës	Ky ligj do të vendosë një sistem për mbrojtjen e përgjithshme dhe konservimin e natyrës (gjithë diversitetit biologjik dhe natyror) dhe vlerat e saj
Ligji nr 03/L-160 për mbrojtjen e ajrit nga ndotja:	Qëllimi i këtij ligji është të rregullojë dhe garantojë të drejtat e qytetarëve për të jetuar në një mjedis me ajër të shëndetshëm dhe të pastër, duke mbrojtur shëndetin e njeriut, faunën, florën dhe vlerat natyrore e kulturore të mjedisit
Ligji nr 03/L-043 parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes	Qëllimi i këtij ligji është ndërhyrja, parandalimi dhe kontrolli i integruar i ndotjes që rrjedh nga veprimtaritë industriale, në veçanti duke parandaluar dhe reduktuar mbeturinat, emetimet në ajër, ujë dhe tokë.
Ligji nr 03 / L-104 për mbrojtje nga rrezatimi jo-jonizues, jonizues dhe sigurinë nukleare:	Qëllimi i këtij ligji është të siguroj pajtueshmërinë me normat dhe konventat ndërkombëtare në fushën e rrezatimit jo-jonizues, jonizues dhe sigurinë nukleare; siguroj se krijimi i një mjedisi të tillë të shëndetshëm, që të përballojë ndotjet dhe shpenzimet lidhur me mbrojtjen nga rrezatimi dhe siguria bërthamore që është e përbalueshme dhe konform me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik; krijimin e autoriteteve specifike dhe detyrimet e autoriteteve publike që janë përgjegjëse për sjelljen dhe fuqizimin gradual të standardeve të tilla; përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e personave dhe ndërmarrjeve që preken nga aktivitete të tilla ose që promovojnë një mjedis të shëndetshëm në Kosovë.
Ligji nr. 04/L-120 për mbrojtjen e bimëve:	Ky ligj rregullon të gjitha aktivitetet që lidhen me: mbrojtjen e bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera të përfshira në prodhimin e bimëve; identifikimin e masave për parandalimin e futjes dhe përhapjes së organizmave të dëmshëm në bimë, produkte bimore dhe objekte të tjera dhe çrrënjosjen e tyre; favorizon mbledhjen dhe shkëmbimin e informatave dhe të dhënave me vendet e tjera; financimin dhe kompensimin për kryerjen e punëve në mbrojtjen e bimëve; Detyrat e përcaktuara dhe përgjegjësitë e subjekteve të përfshira në mbrojtjen e bimëve dhe në zbatimin e këtij ligji në Kosovë.
Ligji nr. 04/L-147 për ujrat e Kosovës:	Ky Ligj rregullon çështjet që kanë të bëjnë me menaxhimin, planifikimin, mbrojtjen dhe përgjegjësinë institucionale në fushën e ujërave dhe të resurseve ujore.
Ligji mbi tokën bujqësore nr. 02/L-26:	Përcakton përdorimin, mbrojtjen, rregullimin dhe qiradhënien e tokës bujqësore me qëllim të ruajtjes së përhershme dhe mbrojtjes së potencialit bujqësor, bazuar në parimet e zhvillimit të qëndrueshëm.
Ligji nr. 02/L-79 për veprimtaritë hidrometeorologjike	Ky ligj i konsideron të gjitha llojet e matjeve të elementeve, vëzhgimin e dukurive meteorologjike, hidrologjike, bio-meteorologjike, hidro-biologjike, përpunimi dhe shpallja e rezultateve të mbledhura të këtyre matjeve dhe vrojtimeve, shpallja e informatave të rregullta dhe të kohë pas kohshme për motin, gjendja e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, përcjellja dhe hulumtimi i ndryshimeve dhe dukurive në atmosferën e hidrosferës me rëndësi për ekonominë e Kosovës, studimi dhe vlerësimi i ndikimit të tyre në mjedis.
Ligji nr 02/L-102 për mbrojtjen nga zhurma	Qëllimi i këtij ligji është shmangia, parandalimi ose zvogëlimi në baza prioritare I efekteve të dëmshme, duke përfshirë edhe bezdisjen, për shkak të ekspozimit të zhurmës. Ky ligj do të sigurojë një bazë për zhvillimin e masave për zvogëlimin e zhurmës së emituar nga burimet e mëdha, veçanti trafikun rrugor dhe hekurudhorë, ajrorë dhe pajisje industriale, makineritë mobile dhe burimet e tjera të ndotjes së mjedisit nga zhurma dhe bezdisja
Ligji nr. 02/L-116 për kimikate:	Qëllimi i këtij ligji është rregullimi i administrimit të qëndrueshëm të kimikateve, duke përfshirë masat për mbrojtjen e mjedisit dhe ekspozimit të njeriut ndaj substancave
Ligji nr. 04/L-060 për mbeturina:	Ky ligj ka për qëllim: evitimin dhe reduktimin sa më të madh të mundshëm të gjenerimit të mbeturinave; ripërdorimi i komponentëve të përdorshëm nga mbeturinat; zhvillimin e qëndrueshëm përmes

	mbrojtjes dhe ruajtjes së resurseve natyrore; parandalimin e ndikimeve negative të mbeturinave në mjedis dhe shëndetin e njeriut; deponimi përfundimtar i mbeturinave në mënyrë të pranueshme mjedisore.
Strategjia dhe plani i veprimit për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm (MMPH):	Është dokument që përcakton qëllime dhe objektiva për mbrojtjen e mjedisit si dhe përfaqëson bazën për hartimin e Planit të Veprimit Mjedisor të Kosovës (PVMK). PVMK specifikon në detaje të gjitha aktivitetet e kërkuara për realizimin e Strategjisë së Mjedisit dhe përmban programin operativ për arritjen e objektivave të Strategjisë.
Strategjia dhe plani i veprimit për biodiversitetin 2011-2020 (MMPH):	Është një dokument themelor për mbrojtjen e natyrës, i cili përcakton objektivat afatgjata për ruajtjen e biodiversitetit dhe diversitetit të peizazhit, vlerës së mbrojtur të natyrës, dhe mënyrën e zbatimit në harmoni me zhvillimin e përgjithshëm ekonomik, social dhe kulturor
Strategjia e Kosovës për menaxhim të mbeturinave (MMPH):	Ka rol kyç për të arritur një menaxhim të qëndrueshëm të mbeturinave. Përmes strategjisë synohet të vendosen politikat që ofrojnë një kornizë të planifikimit e cila për menaxhimin e mbeturinave do të përcaktojë caqet sipas Planit të veprimit për menaxhimin e mbeturinave dhe planeve lokale që janë instrumentet më të rëndësishme për zbatimin e politikave dhe arritjen objektivave për menaxhimin e mbeturinave, si komponentë e zhvillimit ekonomik.
Strategjia dhe Plani i veprimit për cilësinë e ajrit (MMPH):	Cakton objektivat për cilësinë e ajrit dhe politikat alternative për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së ajrit, për të siguruar përfitime të rëndësishme për cilësinë e jetës dhe ndihmesë në mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm.

- Informatat në dispozicion relevante mbi çështjet për VSM përfshijnë:
- Gjendja e ujit në Kosovë, 2015, MMPH/AMMK
- Gjendja e Natyrës 2008-2009 MMPH/AMMK
- Menaxhimi i mbeturinave komunale në Kosovë, Raporti mbi gjendjen 2018, MMPH/AMMK
- Gjendja e mjedisit në Kosovë, 2008-2010 MMPH/AMMK
- Raport vjetor për gjendjen e ajrit, 2018, MMPH/AMMK
- Raportet mujore për cilësinë e ajrit Janar – Dhjetor 2018, MMPH/AMMK
- Mbulueshmëria e tokave CLC, MMPH/AMMK
- Biodiversiteti i Kosovës, MMPH/AMMK
- Vlerësimi i biodiversiteti në Kosovë, 2003 USAID/Kosovë
- Analiza Mjedisore e Vendit të Kosovës. Vlerësimi i Shpenzimeve të Degradimit Mjedisor, Shqyrtim institucional dhe Shqyrtimi i Shpenzimeve, Banka Botërore

Tabela 2.- Planet dhe strategjitë lokale

Strategjia/plani	Përshkrimi
Plani zhvillimor komunal 2024-2032	Është një plan strategjik shumësektorial që përcakton objektiva afatgjata për zhvillimin ekonomik, social dhe hapësinor të komunës
Draft Harta Zonale Komunale 2026 – 2034	Është dokument që, përmes grafikëve, fotografive, hartave dhe tekstit, përcakton në mënyrë të detajuar llojin, destinacionin, përdorimin e planifikuar të hapësirës dhe masat e veprimit, të bazuara në kohëzgjatje dhe projeksione të realizueshme të investimeve publike dhe private në të gjithë territorin e komunal..HZK përcakton kushtet zhvillimore dhe masat për zhvillimin ekonomik, shoqëror dhe hapësinor.
Plani komunale për menaxhimin e mbeturinave	Plani synon shtrirjen e shërbimit për menaxhimin e mbeturinave komunale në të gjithë territorin e komunës
Plani lokal i veprimit në mjedis 2023-2028	Rekomandon integrimin e menaxhimit dhe mbrojtjes së mjedisit në të gjitha sektorët komunalë
PKVEE - Plani Komunal i veprimit për Eficiençën e Energjisë	Objektivi i PKVEE është zvogëlimi i konsumit të energjisë në objektet publike, transporti dhe ndriçimi publik, rritja e nivelit të komoditetit, zvogëlimi i kostos së shpenzimeve të energjisë dhe krijimi i sistemit për menaxhimin e energjisë në komunën e Deçanit.

PLMMIND - Plani lokal për Menaxhimin e Mbeturinave Inerte nga Ndërrimi dhe Demolim 2021	Plani synon të përmirson menaxhimin e mbeturinave në mënyrë të qëndrueshme
Plani Lokal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave 2021- 2025	Plani Lokal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave synon hartimin dhe zbatimin e politikave mjedisore që fokusohen në reduktimin, riciklimin dhe trajtimin e qëndrueshëm të mbeturinave, duke nxitur njëkohësisht zhvillimin ekonomik në këtë sektor në nivel komunal dhe kombëtar, si dhe duke promovuar përdorimin racional të burimeve natyrore.
Plani Lokal i Veprimit për Cilësi të Ajrit 2025-2029	Qëllimi i përgjithshëm i Planit Lokal të Veprimit për Cilësi të Ajrit për Komunën e Deçanit është që të definojë veprimet për menaxhimin e cilësisë së ajrit përbrenda territorit të komunës për periudhën pesë vjeçare.
Plani Komunal i Veprimit për Eficencë të Energjisë për Komunën e Deçanit (PKVEE) 2019-2021	Objektivi i PKVEE-së është të ulë konsumin e energjisë në objektet publike, në sektorin e transportit dhe në ndriçimin publik, duke përmirësuar njëkohësisht nivelin e komoditetit, reduktuar kostot e energjisë dhe duke vendosur një sistem efikas të menaxhimit të energjisë në Komunën e Deçanit.
PVRRFNFT - Plani për Vlerësimin e Rreziqeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e Tjera	Qëllimi i këtij plani është identifikimi i kërcënimeve dhe rreziqeve si dhe bëhet vlerësimi i shkallës së rrezikshmërisë së tyre duke identifikuar mundësitë dhe nevojat për parandalimin, zvogëlimin e rreziqeve, reagimin rimëkëmbjen dhe evitimin e pasojave nga fatkeqësitë dhe katastrofat me qëllim të mbrojtjes dhe shpëtimit të jetës së qytetarëve të Komunës së Deçanit nga fatkeqësitë natyrore dhe të shkaktuara nga faktori njeri.
PZHEL -Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal dhe Plani I Veprimit 2023-2030	Ka për qëllim zhvillimin e qëndrueshëm përmes investimeve në infrastrukturë, bujqësi, përkrahje të bizneseve të reja, arsim, shëndetësi, mirëqenie sociale, kulturë, rini dhe sport.
Plani I Transportit Rrugor 2023-2027	Synon planifikimin e transportit të qëndrueshëm në komunën e Deçanit.
Vlerësimi Strategjik Mjedisor Për Planin Ndërkomunal Për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave 2025-2035	Promovon integrimin e konsideratave mjedisore në PNMIM-në dhe kontribuon në arritjen e objektivave më të gjera të Kosovës për zhvillim të qëndrueshëm, mbrojtje të mjedisit dhe përmirësim të shëndetit publik.

1.4. Metodologjia për hartimin e raportit të VSM-së

Metodologjia e punës në hartimin e raportit të VSM-së dhe procedurat përmblihen si në vijim:
Përgatitja e raportit VSM-së në të cilin janë identifikuar çështjet kryesore të cilat mund të kenë ndikim potencial nga propozimet e dhëna me HZK për të cilat janë propozuar masat për eliminimin/zvogëlimin e këtyre efekteve në mjedis
Takime me institucionet dhe intervista me palët përkatëse për të siguruar të dhëna mbi çështje specifike mjedisore;
Debati publik mbi raportin VSM-së;
Trajtimi i komenteve para se të miratohet HZK-se
Pëlqimi nga MMPHI-ja
Aprovimi nga Kuvendi Komunal.

1.5. Struktura e raportit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM)

Raporti i Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM) për Hartën Zonale të Komunës së Deçanit është strukturuar në mënyrë të tillë që të sigurojë një trajtim të integruar, sistematik dhe transparent të çështjeve mjedisore në procesin e planifikimit hapësinor. Struktura e raportit ndjek kërkesat ligjore në fuqi dhe praktikën më të mira ndërkombëtare për VSM, duke mundësuar analizë të thelluar të ndikimeve potenciale dhe integrimin e konsideratave mjedisore në vendimmarrje.

Raporti është i organizuar në kapituj tematikë, të cilët trajtojnë në mënyrë progresive kontekstin, analizën, vlerësimin dhe masat për menaxhimin e ndikimeve mjedisore, si në vijim:

Kapitulli i parë – Hyrje paraqet prapavijën e dokumentit, qëllimin e raportit të VSM-së, bazën ligjore mbi të cilën mbështetet hartimi i tij, si dhe metodologjinë e përdorur për identifikimin dhe vlerësimin e ndikimeve mjedisore. Në këtë kapitull përfshihet edhe vetë struktura e raportit, duke orientuar lexuesin për përmbajtjen dhe rrjedhën e analizës.

Kapitulli i dytë – Përmbledhje e përmbajtjes së Hartës Zonale të Komunës (HZK) ofron një pasqyrë të përgjithshme të dokumentit, duke përshkruar përmbajtjen dhe orientimet kryesore zhvillimore të HZK-së. Gjithashtu, analizohet marrëdhënia e saj me planet dhe programet tjera relevante në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar, me qëllim sigurimin e koherencës dhe harmonizimit ndërsektorial.

Kapitulli i tretë – Çështjet kyçe mjedisore dhe objektivat e VSM-së fokusohet në identifikimin dhe analizën e gjendjes ekzistuese të mjedisit në territorin e Komunës së Deçanit, si dhe zhvillimin e mundshëm të tij në mungesë të zbatimit të HZK-së (skenari “pa projekt”). Ky kapitull përfshin analizën e problemeve dhe potencialeve mjedisore, si dhe përcaktimin e objektivave të VSM-së, të cilat shërbejnë si bazë për vlerësimin e ndikimeve.

Kapitulli i katërt – Vlerësimi i përputhshmërisë së zhvillimeve të parashikuara me objektivat e VSM-së analizon shkallën e harmonizimit ndërmjet zhvillimeve të planifikuara në HZK dhe objektivave mjedisore të përcaktuara, duke identifikuar përputhjet, mospërputhjet dhe nevojat për ndërhyrje.

Kapitulli pestë – Vlerësimi i efekteve mjedisore dhe masat e parashikuara paraqet analizën e detajuar të ndikimeve të mundshme pozitive dhe negative në komponentët kryesorë të mjedisit (ajri, uji, toka, biodiversiteti, shëndeti i njeriut, etj.), si dhe përcakton masat për parandalimin, zbutjen ose kompensimin e efekteve negative dhe përfortimin e atyre pozitive.

Kapitulli gjashtë – Plani i monitorimit përcakton indikatorët, mekanizmat dhe përgjegjësitë institucionale për ndjekjen e zbatimit të HZK-së dhe të masave të VSM-së, me qëllim vlerësimin e vazhdueshëm të ndikimeve mjedisore dhe ndërmarrjen e masave korigjuese kur është e nevojshme.

Kapitulli shtatë– Rezultatet e konsultimeve me organet, organizatat dhe publikun paraqet procesin e përfshirjes së palëve të interesit dhe publikun, si dhe mënyrën se si komentet dhe shqetësimet e ngritura janë reflektuar në raportin e VSM-së dhe në dokumentin e HZK-së.

Kapitulli tetë – Përmbledhja jo-teknike ofron një prezantim të thjeshtuar dhe të kuptueshëm për publikun e gjerë, duke përmbledhur gjetjet kryesore të raportit, ndikimet mjedisore dhe masat e propozuara, pa përdorur terminologji teknike.

Në tërësi, kjo strukturë siguron që raporti i VSM-së të jetë një instrument funksional dhe vendimmarrës, i cili jo vetëm identifikon dhe vlerëson ndikimet mjedisore, por edhe kontribuon në orientimin e zhvillimit të qëndrueshëm të territorit të Komunës së Deçanit.

II. PËRMBLEDHJE E PËRMBAJTJES SË HARTËS ZONALE TË KOMUNËS (HZK)

2.1. Struktura e përmbajtjes së HZK-së

Harta Zonale e Komunës së Deçanit është e strukturuar në tetë kapituj kryesorë, të cilët ofrojnë një kornizë të integruar për planifikimin hapësinor dhe rregullimin e përdorimit të tokës në nivel komunal, në përputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm si dhe tetë të tjerë të cilët paraqesin kornizën për administrimin, zbatimin dhe monitorimin e HZK-së, duke përfshirë procedurat për ndryshime dhe revidim, trajtimin e përjashtimeve dhe jo-konformiteteve, si dhe interpretimin e dispozitave të planit. Kapitulli i parë i Hartës Zonale Komunale (HZK) të Deçanit paraqet bazën ligjore, kontekstin institucional dhe qëllimin e dokumentit, duke e pozicionuar HZK-në si instrument kyç rregullator i planifikimit hapësinor në nivel loka që përcakton përdorimin, destinimin dhe zhvillimin e territorit për

një periudhë 8 vjeqare. Qëllimi i HZK-së është të orientojë zhvillimin e qëndrueshëm të komunës përmes përcaktimit të rregullave të përdorimit të tokës, menaxhimit të resurseve natyrore dhe zhvillimit të infrastrukturës dhe ekonomisë lokale.

Kapitulli 2 i HZK-së së Deçanit paraqet arsyetimin për përcaktimin e zonave dhe zonave mbishtresore, duke u bazuar në aspektet ligjore, mjedisore, ekonomike dhe sociale. Zonimi përcakton përdorimin e tokës dhe kushtet e zhvillimit për secilën pjesë të territorit, me synim zhvillim të qëndrueshëm, mbrojtje të resurseve natyrore dhe menaxhim të kontrolluar të hapësirës. Zonat mbishtresore vendosin kushte shtesë për mbrojtje dhe zhvillim, ndërsa Plani i Veprimit përkthen objektivat në masa konkrete me prioritete dhe afate për zbatim.

Kapitulli 3, përcakton rregullat e shfrytëzimit të tokës në Komunën e Deçanit, duke klasifikuar përdorimet në të lejuara, dytësore, të përkohshme, të veçanta dhe të ndaluara, si dhe duke vendosur kushte të qarta për ndërtim dhe zhvillim sipas zonave funksionale. Ai siguron kontrollin e përdorimit të hapësirës, mbrojtjen e mjedisit dhe resurseve natyrore, si dhe qasjen në infrastrukturë, duke kufizuar zhvillimet në zonat e ndjeshme dhe duke orientuar zhvillimin e qëndrueshëm të territorit.

Kapitulli 4, paraqet listën e plotë të zonave dhe zonave mbishtresore në territorin e Komunës së Deçanit, të bazuara në PZHK dhe të strukturuar sipas sistemit HILUCS. Zonat përfshijnë kategori kryesore si: banimi, shfrytëzimi i përzier, bujqësia, industria, komerciali, transporti dhe komunikacioni, zonat e mbrojtura, zonë e mbrojtur arkeologjike – historike, zonë minierë sipërfaqësore, pyjore, rekreative dhe turistike, shërbimeve, secila me nënzona dhe përdorime të përcaktuara. Përveç zonave bazë, kapitulli prezanton edhe zonat mbishtresore, të cilat vendosin kufizime dhe kushte shtesë për zhvillim në zona me ndjeshmëri të lartë, si rreziqet natyrore (përmytje, erozion, rrëshqitje), akuiferët dhe resurset minerare. Në tërësi, ky kapitull siguron klasifikimin e detajuar hapësinor dhe bazën për zbatimin e rregullave të zhvillimit dhe menaxhimit të territorit.

Kapitulli 5, përcakton zonat e destinuar dhe kushtet zhvillimore në Komunën e Deçanit, duke detajuar përdorimin e tokës, tipologjinë e ndërtimeve dhe parametrat ndërtimorë për zonat rurale, urbane dhe ato të mbrojtura. Ai definon shfrytëzimet e lejuara dhe kufizimet për secilën zonë, si dhe vendos norma për zhvillim të kontrolluar, mbrojtje të tokës bujqësore dhe resurseve natyrore, duke orientuar zhvillimin e qëndrueshëm të territorit

Kapitulli 6, trajton zonat mbishtresore si instrument për vendosjen e kushteve të veçanta zhvillimore në zona me ndjeshmëri të lartë, duke adresuar rreziqet natyrore (vërshime, erozion, tërmete), ndotjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore e natyrore. Ai përcakton masa parandaluese, mbrojtëse dhe rehabilituese për këto zona, me qëllim kontrollin e zhvillimit, uljen e rreziqeve dhe ruajtjen e qëndrueshme të territorit.

Kapitulli 7, trajton infrastrukturën teknike në Komunën e Deçanit, duke përfshirë rrjetet e ujësjellësit, kanalizimit, ujërave atmosferike, energjisë dhe shërbimeve tjera, si dhe përcakton standardet dhe kushtet për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e tyre. Ai adreson sfidat ekzistuese si amortizimi i rrjeteve dhe mungesa e trajtimit adekuat të ujërave, duke orientuar përmirësimin dhe zgjerimin e infrastrukturës për sigurimin e shërbimeve efikase dhe zhvillim të qëndrueshëm.

Kapitulli 8, trajton transportin dhe infrastrukturën publike në Komunën e Deçanit, duke përfshirë rrjetin rrugor, transportin publik, parkimin dhe mobilitetin e qëndrueshëm, si dhe infrastrukturën sociale si hapësirat publike, shëndetësia, arsimi dhe administrata. Ai identifikon gjendjen ekzistuese dhe nevojën për përmirësim dhe investime, me synim rritjen e efikasitetit të shërbimeve dhe cilësisë së jetës në komunë.

Kapitulli 9, trajton nevojën për hartimin e Planeve Rregulluese të Hollësishme si instrument për zbatimin e HZK-së, duke mundësuar kontroll më të detajuar të zhvillimit urban dhe mbrojtjen e

interesit publik. Ai përfshin edhe trajtimin e vendbanimeve joformale, të cilat parashihen të formalizohen dhe integrohen në sistemin planifikues, si dhe përcakton zonat prioritare për hartimin e këtyre planeve.

Kapitulli 10, paraqet Planin e Veprimit për zbatimin e HZK-së, duke përkthyer objektivat në projekte konkrete në sektorë si infrastruktura, ekonomia, mjedisi, shërbimet publike dhe zhvillimi social. Për secilin projekt përcaktohen përgjegjësit, afatet dhe burimet financiare, duke siguruar një kornizë të qartë për realizimin dhe monitorimin e zhvillimit të qëndrueshëm në Komunën e Deçanit.

Kapitulli 11, trajton administrimin, zbatimin dhe monitorimin e HZK-së në Komunën e Deçanit, duke përcaktuar rolet e institucioneve komunale, koordinimin ndërsektorial dhe përgatitjen e planeve dhe raporteve të rregullta. Ai thekson rëndësinë e bashkëpunimit me akterët relevantë dhe parashikon monitorim të vazhdueshëm përmes indikatorëve, me qëllim sigurimin e zbatimit efektiv dhe, në rast nevoje, rishikimin e planit.

Kapitulli 12, trajton ndryshimet, plotësimet dhe revidimin e HZK-së, duke përcaktuar procedurat ligjore, kriteret dhe përfshirjen e publikut për çdo ndërhyrje në plan, gjithmonë në funksion të interesit publik. Ai parashikon gjithashtu rishikimin e planit pas katër vitesh nëse niveli i zbatimit është i pamjaftueshëm, për të siguruar përshtatjen me zhvillimet reale.

Kapitulli 13, trajton revidimin e Hartës Zonale të Komunës së Deçanit, i cili parashihet të bëhet pas katër vitesh nga miratimi i saj, nëse niveli i zbatimit është më i ulët se 40%. Revidimi realizohet sipas të njëjtave procedura si hartimi dhe miratimi i planit fillestar, me qëllim përshtatjen e tij me kushtet dhe nevojat e reja zhvillimore.

Kapitulli 14, trajton përjashtimet nga kushtet zhvillimore të HZK-së, të cilat lejohen vetëm në raste të justifikuar kur karakteristikat e parcelës e bëjnë të pamundur zbatimin e plotë të rregullave, pa cenuar mjedisin, sigurinë dhe pronat përreth. Ai përcakton kriteret, procedurat dhe kushtet për miratimin e përjashtimeve, duke përfshirë edhe rastet për qasje të personave me aftësi të kufizuara, me qëllim ruajtjen e interesit publik dhe standardeve hapësinore.

Kapitulli 15, trajton jo-konformitetet si përdorime ekzistuese që nuk përputhen me zonimin, por që lejohen të vazhdojnë pa zgjerim apo ndryshim funksional jashtë kushteve të HZK-së, si dhe bonuset e zonimit si mekanizëm stimulues për zhvilluesit në këmbim të përfitimeve publike, me qëllim përmirësimin e cilësisë urbane dhe realizimin e interesit publik.

Kapitulli 16, trajton interpretimin e HZK-së, duke përcaktuar autoritetin komunal përgjegjës për sqarimin e rregullave të zonimit dhe trajtimin e rasteve të paqarta në përdorimin e tokës dhe kushtet zhvillimore, pa ndryshuar përmbajtjen e planit. Ai mundëson zbatim fleksibil përmes interpretimit zyrtar dhe, kur nevojitet, përmes instrumenteve plotësuese të planifikimit.

2.2. Përshkrimi i përmbajtjes së HZK-së

Zona sub-urbane është një hapësirë tranzicioni mes qytetit dhe fshatit, ku kombinohen banimi, bujqësia, industria e lehtë dhe shërbimet tregtare. Ajo ka rëndësi për ruajtjen e trashëgimisë kulturore, biodiversitetit dhe peizazhit, ndërsa zhvillimi i saj duhet të jetë i kontrolluar për të mbrojtur cilësinë e ajrit, ujërave dhe shëndetin publik.

Zona urbane e Deçanit është qendra e zhvillimit social, ekonomik dhe kulturor. Ajo ka dendësi të lartë banimi, shërbime të plota, por hapësirat e gjelbërta dhe rekreative janë të mangëta. Menaxhimi i mbeturinave, mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe përdorimi i energjisë së ripërtëritshme janë masa kyçe për zhvillim të qëndrueshëm.

Zonat rekreative-turistike janë të dizajnuara për të balancuar rekreacionin, turizmin, sportin dhe mbrojtjen e mjedisit, duke kontribuar në cilësinë e jetës, shëndetin publik dhe ekonominë lokale. Ato

ruajnë biodiversitetin, peizazhin natyror dhe trashëgiminë kulturore, ndërsa menaxhimi i gjelbërimit dhe mbeturinave është kusht i domosdoshëm për zhvillim të qëndrueshëm.

Zona pyjore e Deçanit është një aset ekologjik dhe ekonomik, me rol të madh në ruajtjen e biodiversitetit, cilësisë së ajrit dhe ujërave, si dhe në adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike. Ajo ofron vlera kulturore, estetike dhe rekreative, ndërsa menaxhimi i qëndrueshëm është kusht i domosdoshëm për të balancuar zhvillimin me mbrojtjen e mjedisit.

Zona bujqësore e Deçanit është një aset mjedisor dhe ekonomik i rëndësishëm, me tokë pjellore, ujtit të zhvilluar dhe traditë bujqësore të pasur. Ajo kontribuon në mirëqenien e popullsisë, ruajtjen e biodiversitetit dhe sigurinë ushqimore, ndërsa sfidat lidhen me menaxhimin e pesticideve, mbeturinave bujqësore dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.

Zona industriale e Deçanit është e planifikuar në toka me cilësi të ulët, me fokus në industrinë e lehtë, reciklimin dhe prodhimin e energjisë së ripërtëritshme. Ajo synon të gjenerojë punësim, të ardhura dhe zhvillim ekonomik, duke respektuar standardet mjedisore për mbrojtjen e ajrit, ujërave dhe shëndetit publik.

Zonat e minierave sipërfaqësore në Deçan janë të lejuara vetëm me kushte të rrepta mjedisore. Distanca mbrojtëse nga vendbanimet, burimet ujore, zonat e mbrojtura dhe trashëgimia kulturore janë masa kyçe për të balancuar zhvillimin ekonomik me mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit publik.

Mbrojtja e trashëgimisë kulturore në Deçan është e lidhur ngushtë me ruajtjen e mjedisit natyror dhe urban. Ndalohet zhvillimi industrial dhe infrastruktura e rëndë pranë monumenteve, ndërsa projektet e restaurimit dhe digjitalizimit sigurojnë ruajtjen e identitetit kulturor, përmirësimin e peizazhit dhe zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm. Zona e Veçantë e Mbrojtur e Manastirit të Deçanit është një hapësirë me vlera të jashtëzakonshme kulturore dhe natyrore. Ajo ruan biodiversitetin, peizazhin dhe trashëgiminë kulturore, duke ndaluar aktivitetet industriale dhe ndërtimet e pakontrolluara. Masat mbrojtëse janë të domosdoshme për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm dhe për të ruajtur statusin e saj si pasuri botërore e UNESCO-s.

Trashëgimia natyrore e Deçanit është një aset i pasur ekologjik dhe kulturor, me rezervate, pyje dhe bimësi të rrallë. Mbrojtja e saj kërkon masa kundër shpyllëzimit, erozionit dhe shfrytëzimit të pakontrolluar, duke siguruar ruajtjen e biodiversitetit, peizazhit dhe shëndetit publik, si dhe zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm.

Infrastruktura teknike:

- **Rrjeti I ujësjellësit:** Deçani ka 37 fshatra, prej të cilëve 35 janë të mbuluar me furnizim të plotë me ujë të pijshëm, ndërsa dy fshatra malore furnizohen nga burime natyrore. Shkalla e mbulimit është pothuajse 100%, me mbi 27 mijë banorë që kanë qasje në ujësjellës. Konsumi vjetor i ujit arrin mbi 1.25 milion metra kub, ku amvisëritë janë përdoruesit kryesorë, pasuar nga bizneset dhe institucionet publike. Megjithatë, sistemi përballet me sfida të mëdha: rrjeti është i amortizuar, humbjet e ujit janë të larta, ka lidhje ilegale, ndikime nga hidrocentralet dhe raste sporadike të kontaminimit. Ndryshimet klimatike dhe thatësitat e shpeshta kanë ulur nivelin e burimeve ujore, duke e bërë furnizimin më të pasigurt, sidomos në zonat rurale. Për këtë arsye, rekomandohen masa emergjente si investime të rregullta në rrjet, digjitalizimi i monitorimit, ndërtimi i rezervuarëve, rritja e vetëdijesimit të banorëve dhe kontrole të rregullta të cilësisë së ujit. Standardet e furnizimit janë të përcaktuara sipas ligjit dhe rregullave të Autoritetit Rregullativ të Ujërave: në zonat urbane banorët duhet të kenë 120–150 litra ujë në ditë, në zonat periferike 100–120 litra, ndërsa në zonat rurale 80–100 litra. Në raste krizash, minimumi i furnizimit duhet të jetë 50 litra për person në ditë. Projektionet demografike tregojnë një rritje të ngadalshme të popullsisë deri në vitin 2031, me një konsum

të parashikuar prej rreth 1.26 milion metra kub ujë në vit. rrjeti i ujësjellësit të Deçanit është i shtrirë gjerësisht dhe ofron furnizim pothuajse të plotë, por kërkon modernizim dhe menaxhim më të mirë për të siguruar qëndrueshmëri afatgjatë dhe furnizim të pandërprerë me ujë të pijshëm për të gjithë banorët.

- **Rrjeti I kanalizimit:** Sistemi i kanalizimit në Komunën e Deçanit ka njohur një zhvillim të dukshëm gjatë viteve të fundit. Ai është ndërtuar pjesë-pjesë që nga viti 2007 dhe sot përfshin një rrjet me gjatësi mbi 64 kilometra, duke mbuluar qytetin e Deçanit dhe një sërë fshatrash si Beleg, Carrabregu i Epërm e i Ulët, Llukë e Epërme e e Ulët, Lumbardhë, Rastavicë, Pobergjë, Drenoc dhe Sllup. Megjithatë, një pjesë e madhe e fshatrave ende nuk ka sistem kanalizimi, ndaj është e domosdoshme ndërtimi i impianteve të reja për trajtimin e ujërave të zeza, sipas standardeve mjedisore, për të shmangur ndotjen dhe rreziqet për shëndetin e banorëve. Rrjeti është i ndarë në linja primare dhe sekondare, me tubacione PVC të dimensioneve të ndryshme, nga 200 mm deri në 1000 mm. Kolektorët kryesorë kanë diametra më të mëdhenj, ndërsa lidhjet shtëpiake përdorin tubacione më të vogla. Përveç kësaj, janë ngritur tetë gropa septike kolektive që shërbejnë zona të ndryshme të komunës, me sipërfaqe të mbuluara që variojnë nga 10 deri në 78 hektarë. Vjetërsia mesatare e këtyre gropave është rreth 17 vjet, çka tregon nevojën për modernizim. Normat e ndërtimit kërkojnë distanca të caktuara nga ndërtesat, rrugët dhe rrjetet e tjera të infrastrukturës, për të siguruar mirëmbajtje të lehtë dhe për të shmangur ndotjen. Për shembull, rrjeti i kanalizimit duhet të jetë të paktën 30 metra larg burimeve të ujit dhe 10 metra larg lumenjve. Po ashtu, pjerrësia e tubacioneve dhe shpejtësia e rrjedhjes janë të standardizuara për të garantuar vetëpastrimin e sistemit. Në thelb, sistemi i kanalizimit në Deçan është një projekt në zhvillim, me një bazë të konsoliduar në qytet dhe disa fshatra, por me nevojë të madhe për zgjerim në vendbanimet e tjera. Modernizimi i rrjetit, ndërtimi i impianteve të trajtimit dhe respektimi i normave teknike janë hapa të domosdoshëm për të siguruar mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetin e popullatës.
- **Rrjeti atmosferik:** Rrjeti atmosferik në qytetin e Deçanit është ndërtuar për të larguar ujërat e reshjeve sipas normave teknike të planifikimit urban. Aktualisht, ky sistem është i përqendruar kryesisht në zonën urbane dhe veçanërisht në qendrën e qytetit, ku ekziston një rrjet me gjatësi rreth 6.5 kilometra, me diametra tubacionesh nga 200 deri në 500 mm. Pusetat janë vendosur çdo 25–30 metra përgjatë rrugës kryesore, ndërsa shkarkimi i ujërave bëhet në kanale të hapura dhe në rrjedhat e lumenjve. Në të ardhmen, parashikohet zgjerimi i rrjetit atmosferik edhe në pjesën e vjetër të qytetit, me një gjatësi prej 3 km, si dhe në disa vendbanime rurale si Strellci i Epërm, Isniqi, Carrabregu i Epërm, Irzniqi dhe Drenoci, ku do të ndërtohen rreth 12 km rrjet i ri. Kjo është e domosdoshme për të parandaluar vërshimet që shpesh ndodhin nga prurjet e lumenjve, sidomos gjatë reshjeve të dendura. Megjithëse rrjeti ekzistues është funksional, ai vuan nga mungesa e mirëmbajtjes dhe digjitalizimit. Kjo e bën të nevojshme monitorimin e vazhdueshëm, shkëputjen e lidhjeve ilegale dhe përmirësimin e gjendjes së tij. Normat teknike kërkojnë distanca të caktuara nga ndërtesat, trotualet dhe rrjetet e tjera të infrastrukturës, për të shmangur dëmtimet dhe përzjerjen e ujërave atmosferike me ato të zeza. Diametrat e tubacioneve ndryshojnë sipas zonës: në rrugët urbane rekomandohet 400–1200 mm, në rrugët rajonale mbi 1200 mm, ndërsa në lagjet e vogla urbane dhe rurale 200–400 mm. Thellësia e vendosjes varion nga 0.8 m në zonat rurale deri në 1.5 m në rrugët kryesore. Pjerrësia e tubacioneve përcaktohet sipas diametrit, ndërsa shpejtësia e rrjedhjes duhet të jetë mbi 0.7 m/s për vetëpastrim. Pusetat menaxhuese vendosen çdo 25–50 metra, ndërsa pusetat për mbledhjen e reshjeve çdo 20–25 metra, në

mënyrë zigzag në të dy anët e rrugës. Në përmbledhje, rrjeti atmosferik i Deçanit është një sistem i domosdoshëm për menaxhimin e ujërave të reshjeve, por kërkon zgjerim, mirëmbajtje të rregullt dhe digjitalizim për të përballuar sfidat e vërshimeve dhe ndryshimeve klimatike.

- **Impiantet** për trajtimin e ujërave të zeza në Komunën e Deçanit janë planifikuar të ndërtohen në përputhje me sektorët përgjegjës dhe organizatat ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë. Vendosja e tyre do të bëhet në pikat më të ulëta të territorit, në mënyrë që rrjedhja e ujërave të ndotura të jetë e lirë dhe pa shpenzime të mëdha për pompim. Një kusht i rëndësishëm është që impiantet të mos ndërtohen nën nivelin e lumenjve, për të siguruar që ujërat e trajtuara të shkarkohen natyrshëm në rrjedhat e tyre dhe që vetë impiantet të mos rrezikohen nga përmytjet apo nga erozioni. Në thelb, ky plan synon të garantojë trajtimin e sigurt dhe efikas të ujërave të zeza, duke mbrojtur mjedisin dhe shëndetin e banorëve, si dhe duke shmangur rreziqet që lidhen me vërshimet dhe dëmtimet natyrore.
- **Sistemet e drenazhimit** në Komunën e Deçanit janë të menduara për të siguruar largimin e ujërave nëntokësore dhe për të mbrojtur ndërtesat, rrugët dhe infrastrukturën teknike nga lagështia e tepërt. Ndërtimi i tyre kërkon respektimin e disa parametrave të qartë: rrjeti nuk duhet të vendoset shumë afër ndërtesave, trotuareve apo rrugëve të asfaltuara, duke ruajtur distanca minimale prej 2 metrash nga objektet, 1 metër nga trotuaret dhe rrugët, si dhe 1.5 metra nga rrjetet e tjera të infrastrukturës. Në raport me kanalizimin, drenazhimi duhet të jetë të paktën 1 metër larg në drejtim horizontal, ndërsa me rrjetin energjetik dhe kabllor distancat variojnë nga 0.5 deri në 1 metër.
- **Rrjeti i ujitjes** në Komunën e Deçanit trajtohet sipas Ligjit Nr. 04/L-147 për Ujërat dhe ka për qëllim të mbulojë të gjitha tokat bujqësore të komunës. Deri më tani janë bërë investime të rëndësishme dhe planifikohet vazhdimi i tyre, përfshirë rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e kanaleve ekzistuese, si dhe ndërtimin e 32 kanaleve të reja me gjatësi rreth 51.5 km që do të mbulojnë zonën rurale. Një pjesë e rëndësishme e zhvillimit është ndërtimi i tre pendave akumuluese në Grykën e Lloqanit, të cilat do të ndihmojnë bujqësinë gjatë periudhave të thatësirës, do të furnizojnë me ujë banorët dhe kafshët, do të shërbejnë për prodhim energjie hidroelektrike, do të mbrojnë nga përmytjet dhe do të krijojnë mundësi për rekreacion e turizëm. Parametrat teknikë të sistemit të ujitjes përcaktojnë distancat minimale nga ndërtesat dhe rrjetet e tjera të infrastrukturës, si dhe dimensionet e tubacioneve dhe kanaleve, të cilat ndryshojnë sipas llojit të përdorimit (shtëpi, parcela bujqësore, kolektorë kryesorë). Sistemi ndahet në ujitje gravituese, me presion dhe pikë-pikë, me presione dhe shpejtësi të përcaktuara për të siguruar efikasitet dhe vetëpastrim.
- **Rrjeti i energjisë termike:** Në Komunën e Deçanit nuk është planifikuar rrjet lokal për shpërndarjen e energjisë termike.
- **Rrjeti i energjisë elektrike:** Furnizimi bëhet nga termocentralet “Kosova A” dhe “Kosova B”, si dhe nga hidrocentrali i Kozhnjerit. Komuna ka dy nënstacione kryesore (NS Deçan dhe NS Isniq). Planifikohen investime për përmirësimin e rrjetit ekzistues, ndërrimin e trafave dhe shtyllave të vjetra, elektrifikimin e zonave malore për zhvillimin e turizmit, si dhe ndërtimin e një parku solar.
- **Rrjeti i telekomunikacionit:** Deçani ka mbulim të mirë me telekomunikacion, por synon zgjerim të rrjetit optik dhe mobil në zonat malore për të përmirësuar komunikimin dhe shërbimet digjitale.

- **Menaxhimi i mbeturinave:** Komuna e Deçanit ka një deponi lokale për mbeturina dhe përdor stacionin transferues në Sverkë (Pejë). Shërbimi i grumbullimit mbulon pothuajse të gjitha vendbanimet, me mbi 8,300 klientë dhe rreth 797 mijë ton mbeturina të grumbulluara në vit. Janë shpërndarë mbi 8,300 kontejnerë, kryesisht në qytetin e Deçanit. Menaxhimi i mbeturinave bazohet në Planin 2022–2030 dhe synon selektim, riciklim, kompostim dhe reduktim të mbetjeve. Komuna ka planifikuar investime në kontejnerë, kamionë, stacione transferimi dhe qendra riciklimi, si dhe kampanja vetëdijësimi për ndarjen e mbeturinave në burim (në shkolla, institucione dhe amvisëri). Normat ligjore përcaktojnë distancat e deponive nga zonat e banuara, monumentet kulturore, burimet e ujit dhe infrastruktura, duke ndaluar ndërtimin në zona të rrezikuara nga erozioni, përmytjet apo me biodiversitet të lartë.
- **Infrastruktura rrugore:** Deçani ka një rrjet rrugor të mirë që lidh vendbanimet lokale me rajonet e tjera dhe shtetet fqinje, por kërkon investime të mëtejshme për modernizim, siguri dhe zhvillim të turizmit. Komuna e Deçanit ka një rrjet rrugor të zhvilluar që përfshin:
 - **405 km rrugë lokale** (345 km të asfaltuara, 60 km jo të asfaltuara),
 - **28 km rrugë nacionale,**
 - **41.5 km rrugë regjionale.**

Rruga rajonale R-107 (Deçan–Mali i Zi) plotëson kriteret për rrugë nacionale, ndërsa projekti i “Autoudhës së Dukagjinit” është ende i pezulluar. Rrjetet rrugore janë të kategorizuara sipas ligjeve dhe normave teknike, duke përfshirë rrugët nacionale, regjionale, lidhëse dhe lokale.

Prioritetet e PZHK-së: Rritja e sigurisë në trafik, Promovimi i lëvizjes aktive (ecje, çiklizëm), Lidhja e zonës urbane me atë rurale përmes “korridoreve të gjelbra”, Integrimi i politikave të transportit me zhvillimin e turizmit.

Rrjeti hekurudhor: Në Komunën e Deçanit nuk ekziston rrjet hekurudhor. Linja e planifikuar Klina–Gjakovë–Durrës e anashkalon territorin e saj.

Transporti ajror: Deçani shërbehet nga Aeroporti “Adem Jashari” në Sllatinë dhe në të ardhmen nga Aeroporti i Gjakovës. Lëvizjet ajrore lejohen vetëm për turizëm dhe rekreacion (paraglajd, balona, fluturime turistike).

Transporti publik urban/rural: Aktualisht nuk ka stacion të mirëfilltë autobusësh. Planifikohet ndërtimi i një stacioni shumë-modal që do të kombinojë transportin ndërkombëtar, rajonal, urban periferik, taksit dhe biçikleta, duke promovuar lëvizshmërinë e qëndrueshme.

Parkimet publike: Deçani ka 4 parkingje ekzistuese me rreth 280 vende. Politikat e ardhshme synojnë parkime të reja, garazhe publike me dy etazhe, integrim me transportin publik dhe aplikimin e koncepteve “parko dhe ec/çiklo”.

- **Infrastruktura publike:**

Shërbimet mjekësore: Ofrimi bëhet përmes një QKMF, 3 QMF dhe 7 AMF (disa jo funksionale). Ka 120 punëtorë shëndetësorë. Planifikohet renovim, pajisje të reja, qasje për persona me aftësi të kufizuara dhe ndërtimi i një inceneratori në Irzniq.

Shërbimet sociale: Funksionon Qendra për Punë Sociale dhe disa qendra banimi. Planifikohet ndërtimi i një qendre për të moshuar dhe për raste të dhunës në familje.

Institucionet parashkollore: Nuk parashikohet ndërtimi i institucioneve të reja, por përmirësim i kushteve ekzistuese.

Shkollat dhe universitetet: Nuk ka universitet, por planifikohen ndërtime dhe anekse të reja për shkollat fillore dhe të mesme, si dhe salla sportive.

Qendrat administrative: Planifikohet ndërtimi i një objekti të ri komunal me shërbime të integruara (“One Stop Shop”), avancim elektronik dhe decentralizim të shërbimeve.

Siguria publike: Nuk ka ndërtesa të reja të planifikuara; stacioni policor ekzistues i plotëson kushtet. Siguria e kufirit menaxhohet nga niveli qendror.

Varrezat

- **Infrastruktura sociale:** Përfshin parqe, fusha sportive, shërbime shëndetësore, sociale, arsimore, administrative, siguri publike dhe varreza. Synohet zgjerim dhe përmirësim i shërbimeve.

Parqet dhe hapësirat publike: Aktualisht ka 3 parqe dhe 7 sheshe publike me sipërfaqe totale 53,400 m². Synohet lidhja e tyre me korridore të gjelbra dhe krijimi i hapësirave të reja për rekreacion e turizëm.

Fushat sportive dhe rekreative: Ekzistojnë palestra sportive, stadiumi “Ruzhdi Ramosaj” dhe fusha lojërash. Ka klube futbollit, hendbollit dhe ping-pongu. Infrastruktura sportive është e pamjaftueshme dhe kërkon investime për të përmbushur normat teknike.

2.3.Përmbledhja përmbajtësore e HZK-së

Territori i komunës është strukturuar në tri tërësi funksionale kryesore: zona e trashëgimisë natyrore (Bjeshkët e Nemuna), zona urbane dhe zona rurale bujqësore dhe disa nënzona .HZK siguron bazën për menaxhimin e qëndrueshëm të territorit dhe shërben si dokument udhëzues për zhvillimin e ardhshëm të Komunës së Deçanit.

Tabela 3. Tërësitë, zonat, njësitë

Tërësia / Zona / Njësia	Përshkrimi	Funksioni / Potenciali
Tërësia I – Trashëgimia natyrore – Bjeshkët	Përfshin pjesën perëndimore të komunës dhe territorin e Bjeshkët e Nemuna.	Mbrojtja e biodiversitetit, pyjeve dhe peizazhit natyror; zhvillimi i turizmit malor dhe ekologjik.
Tërësia II – Zona urbane dhe trashëgimia kulturore	Hapësira qendrore urbane dhe kodrinore e komunës, që përfshin qytetin e Deçanit dhe zonat me vlera kulturore e natyrore.	Zhvillim urban, ekonomik, kulturor dhe turistik; lidhje ndërmjet zonës malore dhe asaj rurale.
Zona e vendbanimeve	Përfshin Pleqen, Bellen dhe fshatin Shkëlzen Haradinaj.	Zhvillim i kontrolluar i banimit dhe integrim me zonat urbane dhe turistike.
Zona e zhvillimit	Hapësira jashtë zonës urbane të dedikuara për zhvillim.	Turizëm, sport dhe rekreacion.
Zona e pyjeve private	Hapësira me interes zhvillimi në kuadër të pyjeve private.	Zhvillim i kontrolluar duke respektuar mbrojtjen e mjedisit dhe kriteret e Parkut Kombëtar.
Zona e Veçantë e Mbrojtur	Hapësira rreth Manastiri i Deçanit me sipërfaqe rreth 790.7 ha.	Mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe peizazhit; potencial për turizëm kulturor dhe natyror.
Zona urbane	Përfshin qytetin e Deçanit dhe hapësirat urbane/rurale përreth.	Qendra kryesore e zhvillimit urban, institucional dhe ekonomik.

1.Njësia qendrore	Pjesa më vitale e qytetit me funksione administrative dhe afariste.	Zhvillimi i biznesit, shërbimeve, banimit dhe Korridorit Ekonomik të Deçanit.
2. Njësia lindore	Zonë me banim individual dhe afarizëm.	Zgjerim urban dhe zhvillim i kontrolluar i qytetit.
3.Njësia jugore	Zonë me dominim të banimit të ulët dhe afarizmit.	Zhvillim ekonomik përgjatë korridorit drejt Gjakovës.
4. Njësia veriore	Zonë përgjatë Lumëbardhit të Deçanit me vlera mjedisore dhe sportive.	Turizëm, rekreacion, sport dhe zhvillim hotelier.
5.Njësia perëndimore (Qesta)	Zonë me potencial të lartë kulturor dhe turistik.	Turizëm, gastronomi, aktivitete kulturore dhe rekreative.
Tërësia III – Zona rurale e Komunës së Deçanit	Përfshin rrafshin aluvial të Lumëbardhit të Deçanit dhe Lumëbardhit të Lloqanit.	Zhvillimi intensiv i bujqësisë dhe blegtorisë në toka pjellore.

2.3.1 Kushtet e përgjithshme për zhvillim në të gjitha zonat

Korniza e kushteve të përgjithshme për zhvillim në territorin e Komunës së Deçanit bazohet në orientimet strategjike të Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) dhe përcaktimet rregullative të Hartës Zonale të Komunës (HZK), e cila i përkthen këto drejtime në zona funksionale, kushte zhvillimore dhe rregulla të qarta për shfrytëzimin e tokës, ndërtimin, mbrojtjen e mjedisit, ruajtjen e trashëgimisë dhe zhvillimin e infrastrukturës.

Rregullat dhe kushtet zhvillimore të përcaktuara me HZK zbatohen për të gjitha shfrytëzimet, zhvillimet dhe ndërtesat në territorin e Komunës së Deçanit, përveç rasteve kur me HZK përcaktohet ndryshe për zona të caktuara. Në përputhje me Udhëzimin Administrativ Nr. 24/2015, këto kushte përfshijnë kërkesa, rregulla, masa mbrojtëse, modele projektimi dhe udhëzime për organizimin dhe zhvillimin e territorit komunal.

Kushtet zhvillimore përfshijnë rregullat për shfrytëzimin e tokës, duke përcaktuar shfrytëzimet e lejuara, shfrytëzimet dytësore, shfrytëzimet e veçanta, strukturat e përkohshme dhe shfrytëzimet e ndaluara për secilën zonë funksionale.

Kushtet e përgjithshme përfshijnë:

- **shfrytëzimin e tokës** – përcaktojnë shfrytëzimet: e lejuara, dytësore, të veçanta, strukturat e përkohshme dhe shfrytëzimet e ndaluara për secilën zonë funksionale;
- **qasjen në parcelën kadastrale** – rregullojnë qasjen funksionale dhe lidhjen me rrjetin rrugor dhe infrastrukturën publike;
- **qasjen infrastrukturën teknike** – përfshijnë kyçjen në ujësjellës, kanalizim, energji elektrike, telekomunikacion dhe sisteme të menaxhimit të mbeturinave;
- **për parkim, ngarkim dhe shkarkim** – përcaktojnë standardet për organizimin e parkingut, qarkullimit dhe hapësirave shërbyese;
- **për zhvillimin e peizazhit dhe gjelbërimit** – përfshijnë ruajtjen dhe zhvillimin e hapësirave të gjelbra, shiritave mbrojtës dhe peizazhit natyror;
- **për ndriçimin natyror dhe artificial** – përcaktojnë standardet për ndriçim funksional, efikasitet energjetik dhe siguri publike;
- **për mbrojtje nga zhurma dhe ndotja** – përfshijnë masa për reduktimin e ndikimeve negative nga trafiku, industria dhe aktivitetet ekonomike;
- **për mbrojtjen e mjedisit dhe trashëgimisë** – sigurojnë mbrojtjen e tokës bujqësore, biodiversitetit, burimeve ujore, trashëgimisë kulturore dhe zonave të mbrojtura;
- **për mbrojtje nga rreziqet natyrore** – kufizojnë zhvillimin në zonat me rrezik nga përmytjet, erozioni, rrëshqitjet e dheut dhe fatkeqësitë tjera natyrore;

- **për projektim dhe zhvillim urban/rural** – përcaktojnë parametrat ndërtimorë si ISHN, etazhiteti, dendësia, përqindja e ndërtimit, distancat dhe raportet ndërmjet sipërfaqes së ndërtuar dhe hapësirës së lirë.





Kushtet ndërtimore



















Kushtet ndërtimore konkretizohen përmes parametrave urbanistikë dhe teknikë që duhet të respektohen në çdo parcelë. Ndërtimi përcaktohet nga madhësia minimale e parcelës (p.sh. $\geq 400 \text{ m}^2$ për banim individual), indekset e shfrytëzimit (ISN dhe ISHPKZH), përqindja e sipërfaqes së ndërtuar dhe e gjelbëruar, si dhe kufizimet në lartësi (zakonisht deri në P+2K në zonat rurale) . Po ashtu, vendosen distanca minimale nga kufijtë e parcelës dhe vijat ndërtimore për të siguruar qasje, ndriçim dhe ventilim adekuat. Ndërtimet duhet të jenë në përputhje me karakterin e zonës (sidomos në zonat rurale dhe turistike ku kërkohet arkitekturë tradicionale) dhe të respektojnë kriteret mjedisore, duke ndaluar aktivitetet ndotëse dhe duke favorizuar zhvillime të qëndrueshme dhe funksione në përputhshmëri me zonimin.

2.3.2 Lista e zonave

HZK ka bërë ndarjen e territorit në zona/nënzona në përputhje me rekomandimet e PZHK-së, LPH , dhe Udhëzimit administrativ MMPH - Nr. 24/2015 Mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e hartës zonale të komunës. Për çdo zonë janë të përcaktuara shfrytëzimet e lejuara, e lejuara dytësore, të ndaluara, **të veçanta**, të përkohshme si dhe kushtet zhvillimore.

Tabela 4. Lista e llojeve të zonave, nën zonave dhe zonave mbishtetëse

Lloji i zonës	Nën zona	Përmbajta e zonave (shfrytëzimi i planifikuar i zonave)	Kodi HILUCS	Kodi në HZK	Simboli
Zonë banimi	Nën zona rurale: me intensitet të ulët me intensitet të lartë Nën zona urbane: periferike urbane qendrore Nën zona e Parkut Kombëtarë “Bjeshkët e Nemuna”	Shtëpi individuale vetëm për banim Shtëpi individuale me shërbime tregtare Shtëpi dyshe	5.1	ZB1	
		Shtëpi dyshe me shërbime tregtare		ZB2 ZB3	
		Shtëpi në varg Shtëpi terracore			
		Ndërtesa me shumë njësi vetëm për banim Ndërtesa me shumë njësi me shërbime tregtare.			
Zonë për shfrytëzim të përzier	Nën zona rurale: me intensitet të ulët me intensitet të lartë Nën zona urbane: periferike urbane qendrore	Zonë e cila përfshinë hapësirat e banimit të kombinuara edhe me shfrytëzime tjera të ndryshme.	5.2	ZSHP	
Zonë bujqësore	Nën zona rurale: me intensitet të ulët me intensitet të lartë Nën zona urbane: periferike Nën zona e Parkut Kombëtarë “Bjeshkët e Nemuna”	Drithëra	1.1.1	Zb1	
		Fruta		Zb2	
		Perime		Zb3	
		Bimë foragjerë		Zb4	
		Vreshta		Zb5	
		Kullosa		Zb6	
		...			
		Infrastrukturë bujqësore (ferma)	1.1.2	ZbX	
Prodhim bujqësor për konsum vetjak	1.1.3	ZbX			

Zonë industriale	Nën zona urbane: - periferike	Industri e lëndës së parë	2.1.1 2.1.2 2.1.3 2.1.7 2.1.9 2.3.5	ZIX	
		Industri e lehtë	2.3.1 2.3.2 2.3.5		
Zonë komerciale	Nën zona rurale: me intensitet të ulët me intensitet të lartë Nën zona urbane: periferike urbane qendrore	Kjo klasë përfshinë hapësira të shfrytëzuara për shitje me shumicë dhe pakicë të automjeteve, karburantit, lëndëve të para bujqësore, kafshëve të gjalla, mineralëve, metaleve, lëndë drusore, mobile, mallrat shtëpiake, tekstile, ushqim, pije, produktet e duhanit, produktet farmaceutike, mallrave të dorës së dytë, produkte të tjera, mbetjet dhe skrapet. Kjo	3.1.1	ZK2	
	Nën zona e Parkut Kombëtarë “Bjeshkët e Nemuna”	klasë përfshin edhe riparimin e automjeteve, personal dhe mallrave shtëpiake			
		Hotele	3.1.3	ZK	
		Restorante	3.1.3	ZK	
		Fshat turistik	3.1.1	ZK	
		Vend kampingu	3.1.3	ZK	
		Shërbim i patundshmërisë	3.1.2	ZK	
		Shërbim financiar dhe i sigurimit	3.2.1	ZK	
		Shërbime teknike profesionale dhe shkencore	3.2.2	ZK	
		Shërbim i informimit dhe komunikimit	3.2.3	ZK	
		Shërbim administrativ dhe mbështetës	3.2.4	ZK	
		Shërbim tjetër profesional financiar dhe i Informacionit	3.2.5	ZK	
Zonë e komunikacionit – transport	Nën zona rurale: me intensitet të ulët me intensitet të lartë Nën zona urbane: periferike urbane qendrore Nën zona e Parkut Kombëtarë “Bjeshkët e Nemuna”	Rrugë	4.1.1	ZKT1	
		Parking	4.1.1	ZKT2	
		Trotuar	4.1.1	ZKT3	
		Stacion i autobusëve	4.1.1	ZKT4	
		Stacion multimodal	4.1.1	ZKT5	
Zonë mbrojtur	Nën zona e Parkut Kombëtarë “Bjeshkët e Nemuna”	Parku kombëtarë	3.4.4 6.3.1	ZM	
		Manasëri i Deçanit	3.4.4	ZM	
Zonë e mbrojtur arkeologjike – historike	Nën zona rurale: me intensitet të ulët me intensitet të lartë Nën zona urbane: periferike urbane qendrore Nën zona e Parkut Kombëtarë “Bjeshkët e Nemuna”	Hapësira të Mbrojtur Arkeologjike dhe Historike	6.3.1	ZmaH	

Zonë minierë sipërfaqësore	Nën zona rurale: me intensitet të ulët me intensitet të lartë Nën zona urbane: periferike	Minierë / Gurore	1.3.3	ZmS	
Zonë pyjore	Nën zona rurale: me intensitet të ulët me intensitet të lartë Nën zona urbane: periferike Nën zona e Parkut Kombëtarë “Bjeshkët e Nemuna”	Pylltari e bazuar në rotacion të shkurtër	1.2.1	ZP	
Zonë rekreative turistike	Nën zona rurale: me intensitet të ulët me intensitet të lartë Nën zona urbane: periferike urbane qendrore Nën zona e Parkut Kombëtarë “Bjeshkët e Nemuna”	Hapësirat e gjelbra dhe park	3.4.2	ZrT	
		Hapësira për rekreim	3.4.4	ZrT	
		Insitucionet sportive / stadiumi / fushat sportive	3.4.3	ZrT	
Zonë e shërbimeve	Nën zona rurale: - me intensitet të ulët	Insitucione të arsimit para universitar - Shkollë	3.2.2	ZSH	
	me intensitet të lartë Nën zona urbane: periferike - urbane Nën zona e Parkut Kombëtarë “Bjeshkët e Nemuna”	Insitucione të arsimit parashkollor - Çerdhe	3.2.2	ZSH	
		Insitucione shëndetësore	3.2.3	ZSH	
		Insitucione shëndetësore–Spitali Përgjithshëm	3.3.3	ZSH	
		Insitucione administrative	3.1.3	ZSH	
		Insitucione fetare – xhami	3.3.4	ZSH	
		Insitucione fetare – kishë	3.3.4	ZSH	
		Varreza	3.3.5	ZSH	
		Zjarrfikës	3.3.1	ZSH	
		Insitucione fetare – tyrbe dhe teqe	3.3.4	ZSH	
		Qendër e kontrollit teknik	3.3.1	ZSH	
		Stacioni policor	3.3.1	ZSH	
		Trafo për energji elektrike	4.3.1	ZSH	
		Insitucione kulturore – shtëpi kulturore	3.4.1	ZSH	
		Posta	3.2.3	ZSH	
		Insitucione kulturore -Muze	3.4.1	ZSH	
		Shërbime tjera të komunitetit	3.3.1	ZSH	

		Insitucione kulturore – bibliotekë	3.4.1		
		Deponi transite – mbeturina	4.3.3	ZSH	
		Insitucione të mirëqenies sociale – shtëpi epleqve	3.3.3	ZSH	
		Fabrika e ujit	4.3.2	ZSH	
		Panel solar	2.4.4	ZSH	
		Lapidar	3.3.5	ZSH	
		Impiant	4.3.2	ZSH	
		Rezervuar dhe sisteme pompimi	4.3.2	ZSH	
		Qendra për edukimin jo formal të fëmijëve	3.3.2	ZSH	
Sipërfaqe ujore	Nën zona rurale: me intensitet të ulët me intensitet të lartë Nën zona urbane: periferike urbane qendrore Nën zona e Parkut Kombëtarë “Bjeshkët e Nemuna”	Lumenjtë	6.3.2	SU	
Llojet e zonave mbishtresore				Kodi	
Zonë sizmike				ZmSH – S	
Zonë e vërshimeve				ZmSH – V	
Zonë e akuiferëve				ZmSH – A	
Zonë e pasurive minerare				ZmSH – PM	
Zonë me rrëshqitje të dheut				ZmSH – Rr	
Zonë me erozion				ZmSH – E	

2.3.3 Shfrytëzimet e tokës për të gjithë territorin e komunës

Shfrytëzimi i tokës në Komunën e Deçanit përcaktohet përmes HZK-së, duke u bazuar në zonimin e PZHK-së dhe Sistemin Hierarkik të Shfrytëzimit të Tokës. Çdo parcelë mund të zhvillohet vetëm në përputhje me destinimin e zonës, kushtet zhvillimore, normat teknike dhe kërkesat për mbrojtjen e mjedisit, trashëgimisë natyrore e kulturore dhe tokës bujqësore.

Shfrytëzimet kryesore përfshijnë zonat e banimit, komerciale, industriale, bujqësore, të përziera, pyjore, të mbrojtura, rekreative-turistike, sipërfaqet ujore, komunikacionin/transportin dhe zonat e shërbimeve. Këto kategori përcaktojnë zonat ku lejohet zhvillimi, ku kufizohet ndërtimi dhe ku kërkohet mbrojtje e veçantë.

Toka bujqësore e kategorive 1–4 mbrohet nga ndërtimi i pakontrolluar dhe zhvillimi në këto zona lejohet vetëm në raste të veçanta të përcaktuara me HZK. Zhvillimi orientohet kryesisht në toka me kategori më të ulët bujqësore për ruajtjen e potencialit prodhues.

HZK përcakton shfrytëzime të lejuara, dytësore, të veçanta, struktura të përkohshme dhe shfrytëzime të ndaluara. Shfrytëzimet dytësore lejohen vetëm si funksione ndihmëse të shfrytëzimit kryesor, ndërsa strukturat e përkohshme nuk duhet të pengojnë qarkullimin, hapësirat publike dhe gjelbërimin.

Në aspektin mjedisor, ndalohen zhvillimet që bien ndesh me PZHK-në dhe HZK-në, ndërtimet në brigjet e lumenjve, në zona me rrezik nga përmytjet, erozioni dhe rrëshqitjet e dheut, si dhe aktivitetet që shkaktojnë ndotje ose cenojnë trashëgiminë dhe resurset natyrore.

HZK krijon bazën rregulluese për përdorim racional të tokës, mbrojtjen e tokës bujqësore dhe burimeve natyrore, kontrollin e zgjerimit urban dhe orientimin e zhvillimit drejt zonave më të përshtatshme.




Figura 1 - Harta e shfrytëzimit të tokës

Shfrytëzimet e lejuara

Shfrytëzimet e lejuara përfaqësojnë aktivitetet dhe zhvillimet kryesore që mund të realizohen brenda parcelave kadastrale, në përputhje me destinimin e zonës së përcaktuar nga PZHK dhe HZK. Këto zhvillime përfshijnë zonat e banimit, ekonomike, bujqësore, turistike, pyjore, të mbrojtura dhe infrastrukturore. Çdo zhvillim duhet të respektojë kushtet zhvillimore, normat teknike dhe kriteret për mbrojtjen e mjedisit, trashëgimisë natyrore dhe kulturore, si dhe përdorimin racional të tokës. Në zonat rurale, ndërtimi kufizohet në mbrojtje të tokës bujqësore me cilësi të lartë.

Shfrytëzimet dytësore

Shfrytëzimet dytësore janë struktura ose funksione ndihmëse që lejohen vetëm në shërbim të shfrytëzimit kryesor. Në këtë kategori përfshihen garazhet, depot, punëtoritë, shtëpitë e kopshtit, panelet diellore dhe infrastruktura ndihmëse publike e sociale. Këto zhvillime duhet të respektojnë kufizimet për sipërfaqen, lartësinë, distancat dhe indeksin e shfrytëzimit të parcelës, në mënyrë që të mos dominojnë mbi funksionin primar dhe të mos krijojnë ndikime negative në mjedisin përreth.

Strukturat e përkohshme

Strukturat e përkohshme lejohen në shumicën e zonave urbane dhe rurale, përveç zonave të mbrojtura si Parku Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” dhe zonat e ndjeshme të përcaktuara me HZK.

Këto struktura kanë karakter montues ose modular dhe përdoren për aktivitete të përkohshme si panaire, koncerte, promovime apo funksione sezonale. Vendosja e tyre nuk duhet të pengojë qarkullimin, hapësirat publike, gjelbërimin, parkingjet apo objektet me vlera administrative, shëndetësore dhe kulturore.

Shfrytëzimet e veçanta

Shfrytëzimet dhe strukturat e veçanta përfshijnë infrastrukturën teknike dhe objektet me rëndësi publike, si impiantet për trajtimin e ujit të pijshëm dhe ujërave të zeza, objektet për trajtimin e mbeturinave, trafostacionet dhe antenat e telekomunikimit. Këto struktura janë të domosdoshme për funksionimin e territorit, por kërkojnë trajtim të veçantë për shkak të ndikimeve të mundshme mjedisore dhe sociale. Vendosja e tyre duhet të jetë në përputhje me dokumentet hapësinore, kërkesat ligjore dhe standardet për mbrojtjen e mjedisit dhe sigurinë publike.

Shfrytëzimet e ndaluara

Shfrytëzimet e ndaluara përfshijnë të gjitha zhvillimet që bien në kundërshtim me PZHK-në, HZK-në dhe rregulloret përkatëse të planifikimit hapësinor. Në këtë kategori hyjnë ndërtimet në toka bujqësore të kategorisë së lartë, zhvillimet në brigjet e lumenjve në kundërshtim me ligjin, prerja e pakontrolluar e pyjeve, ndërtimet në zona me rrezik nga përmytjet, erozioni dhe rrëshqitjet e dheut, si dhe aktivitetet që shkaktojnë ndotje ose cenojnë trashëgiminë natyrore e kulturore. Këto kufizime synojnë mbrojtjen e resurseve natyrore, sigurisë publike dhe zhvillimit të qëndrueshëm territorial.

Qasja në infrastrukturën teknike

HZK parasheh që çdo zonë dhe çdo ndërtesë të ketë qasje në infrastrukturën teknike bazike, përfshirë rrjetin energjetik, ujësjellësin, kanalizimin, rrjetin e reshjeve atmosferike, telekomunikacionin, menaxhimin e mbeturinave dhe sistemet e trajtimit të ujërave. Pajisja me leje ndërtimi kushtëzohet me sigurimin e lidhjeve të rregullta në infrastrukturën teknike dhe me respektimin e standardeve të përcaktuara nga institucionet përgjegjëse. Kjo qasje synon përmirësimin e kushteve të jetesës dhe reduktimin e ndotjes mjedisore.

Qasja në infrastrukturën sociale

Komuna ka obligim të sigurojë infrastrukturë sociale dhe publike për të gjitha zonat e banimit. Në zonat ekzistuese dhe ato të reja duhet të planifikohen hapësira për gjelbërim publik, terrene sportive, kënde lojërash për fëmijë, çerdhe dhe hapësira për socializim. Këto hapësira janë të rëndësishme për rritjen e cilësisë së jetesës, integrimin social dhe krijimin e një mjedisi funksional dhe të qëndrueshëm urban e rural.

Ndërtimet në terren të pjerrët

Në pjesët kodrinore dhe malore të Komunës së Deçanit, ndërtimet duhet të përshtaten me konfiguracionin natyror të terrenit. HZK përcakton masa të veçanta për trajtimin e bodrumeve, niveleve të ndërtesave, distancave nga parcelat fqinje dhe organizimin e qasjes në terrene të pjerrëta. Qëllimi i këtyre masave është zvogëlimi i rrezikut nga destabilizimi i terrenit, mbrojtja nga erozioni dhe ruajtja e sigurisë strukturore të ndërtesave dhe infrastrukturës.

Ndërtimet në Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”

Ndërtimet në territorin e Parkut Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” trajtohen sipas Planit Hapësinor të Parkut dhe legjislacionit për zonat e mbrojtura. Zhvillimi lejohet vetëm në zonat e përcaktuara për ndërtim dhe duhet të shoqërohet me masa të rrepta për mbrojtjen e biodiversitetit, habitateve natyrore, peizazhit dhe burimeve ujore. Çdo projekt duhet t’i nënshtrohet vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe konsultimit publik, kontroll i materialeve ndërtimore, qasje në infrastrukturë dhe plan monitorimi për qëndrueshmërinë e zhvillimit.

2.3.4 Zonat e destinuar, kushtet zhvillimore/ ndërtimore dhe shfrytëzimet

Tabela 6. Zonat, parametrat zhvillimor, shfrytëzimet

Zona / Nënzona	Kushtet zhvillimore dhe ndërtimore	Shfrytëzimet
ZONA RURALE		
ZRIU - Zona Rurale me Intensitet të Ulët	D≤10 ban./ha; P+2K; bujtina P+2K+Nk; parc. min. 400 m ² për banim, 600 m ² për banim+tregti, 1000-2000 m ² për vila; balli min. 12 m; parametrat e detajuar sipas HZK-së.	Sh.L.: banim individual, bujqësi, blegtori, sera, pemëtari, turizëm rural dhe agroturizëm. Sh.D.: tregti e vogël, punishte artizanale, depo dhe magazina të vogla. Sh.V.: objekte publike, komunitare, arsimore, shëndetësore dhe infrastrukturore. Sh.N.: industri e rëndë, deponi dhe aktivitete me ndikim të lartë mjedisor.
ZRIL - Zona Rurale me Intensitet të Lartë	D≤50 ban./ha; P+2K; turizëm deri P+3K; mbulueshmëria ≤40%; parc. min. 400 m ² ; parametrat sipas HZK-së.	Sh.L.: banim individual dhe i kombinuar, bujqësi, blegtori, turizëm rural, tregti dhe shërbime lokale. Sh.D.: punishte, magazina dhe veprimtari ekonomike me ndikim të ulët. Sh.V.: objekte publike, komunitare dhe infrastrukturore. Sh.N.: industri e rëndë, deponi dhe aktivitete që cenojnë karakterin rural.
Feramat	Ndërtimet lejohen vetëm në funksion të fermës, prodhimit bujqësor dhe blegtoral; kushtet sanitare, mjedisore dhe infrastrukturore sipas HZK-së.	Sh.L.: ferma, stalla, sera, depo bujqësore, objekte për përpunim primar të produkteve bujqësore dhe blegtorale. Sh.D.: tregtim dhe ekspozim i produkteve të fermës. Sh.V.: objekte veterinare, edukative dhe infrastrukturore. Sh.N.: banim urban, industri e rëndë dhe aktivitete të papajtueshme me funksionin bujqësor.
ZS - Zona Suburbane	D≤80 ban./ha; P+2K; zhvillim me karakter kalimtar ndërmjet zonës rurale dhe urbane; parametrat e parcelës, ISN, ISHPKZh, SNP dhe SGJP sipas HZK-së.	Sh.L.: banim individual dhe i kombinuar, tregti, shërbime, arsim, shëndetësi, rekreacion dhe hapësira publike. Sh.D.: aktivitete ekonomike me ndikim të ulët, hoteleri, gastronomi, punishte dhe depo të vogla. Sh.V.: objekte publike, komunitare, sportive, fetare dhe infrastrukturore. Sh.N.: industri e rëndë, deponi dhe aktivitete me ndikim të lartë mjedisor.
ZU - Zona Urbane (Njësia Qendrore, Lindore, Jugore, Perëndimore dhe Veriore)	D≤250 ban./ha; zhvillim urban me intensitet mesatar-të lartë; tregti dhe shërbime me intensitet të lartë; parametrat e parcelës, lartësisë, ISN, ISHPKZh, SNP dhe SGJP sipas tipologjive të HZK-së.	Sh.L.: banim individual dhe kolektiv, tregti, shërbime, administratë, arsim, shëndetësi, kulturë, sport, rekreacion dhe qendra biznesore. Sh.D.: hoteleri, gastronomi, punishte, depo të vogla dhe veprimtari afariste me ndikim të ulët. Sh.V.: objekte publike, komunitare, fetare, energjetike dhe infrastrukturore. Sh.N.: industri e rëndë, deponi dhe aktivitete me ndikim të lartë mjedisor.
ZQ - Zona Qendrore e Qytetit të Deçanit	D≤500 ban./ha; intensiteti më i lartë i zhvillimit urban; funksione administrative, tregtare, kulturore dhe turistike; parametrat sipas tipologjive qendrore të HZK-së.	Sh.L.: administratë, tregti, shërbime, financa, hoteleri, gastronomi, kulturë, turizëm, banim kolektiv dhe individual. Sh.D.: artizanat urban, qendra biznesore dhe veprimtari afariste me ndikim të ulët. Sh.V.: objekte institucionale, publike, kulturore dhe infrastrukturore. Sh.N.: industri, depo të mëdha dhe aktivitete që cenojnë karakterin qendror dhe trashëgiminë kulturore.

Zona / Nënzona	Kushtet zhvillimore dhe ndërtimore	Shfrytëzimet
ZB - Zona Bujqësore	Ndërtimet lejohen vetëm në funksion të prodhimit bujqësor dhe blegtoral; mbrojtja e tokave bujqësore, veçanërisht kategorive I-IV; parametrat sipas HZK-së.	Sh.L.: ara, pemëtari, vreshta, sera, livadhe, kullosa, akuakulturë dhe objekte mbështetëse bujqësore. Sh.D.: përpunim primar, magazinim dhe tregtim i produkteve bujqësore. Sh.V.: objekte infrastrukturore, kërkimore dhe edukative në funksion të bujqësisë. Sh.N.: urbanizim intensiv, industri dhe aktivitete që cenojnë potencialin prodhues të tokës bujqësore.
ZP - Zona Pyjore	Ruajtja, menaxhimi dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i fondit pyjor; ndërtime vetëm në funksion të pylltarisë, rekreacionit dhe turizmit natyror.	Sh.L.: pylltari, menaxhim pyjor, rekreacion, turizëm natyror dhe edukim mjedisor. Sh.D.: aktivitete turistike dhe rekreative me ndikim të ulët. Sh.V.: bujtina, shtëpi malore, objekte menaxhuese dhe infrastrukturore. Sh.N.: shpyllëzim, industri, deponi dhe aktivitete që dëmtojnë fondin pyjor dhe biodiversitetin.
ZONA REKREATIVE-TURISTIKE		
ZrT1 - Park dhe Hapësira të Gjelbra	Ruajtja dhe zhvillimi i hapësirave publike të gjelbra; ndërtime vetëm në funksion të rekreacionit, sportit dhe mirëmbajtjes; parametrat sipas HZK-së.	Sh.L.: parqe, hapësira të gjelbra, shtigje këmbësorësh, kënde lojërash, rekreacion dhe aktivitete në natyrë. Sh.D.: kioska, gastronomi e lehtë dhe aktivitete kulturore. Sh.V.: objekte mirëmbajtëse dhe infrastrukturore. Sh.N.: banim, industri dhe aktivitete që cenojnë karakterin publik të zonës.
ZrT2 - Bjeshka e Belegut	Zhvillim i kontrolluar turistik dhe rekreativ; ruajtje e peizazhit natyror dhe biodiversitetit; parametrat sipas HZK-së dhe planeve përkatëse.	Sh.L.: turizëm malor, kamping, bujtina, ecje, alpinizëm, sporte malore dhe rekreacion. Sh.D.: gastronomi tradicionale dhe aktivitete kulturore. Sh.V.: infrastrukturë turistike dhe objekte mbështetëse. Sh.N.: zhvillime intensive dhe aktivitete që cenojnë vlerat natyrore.
ZrT3 - Laku i Kryqës	Ruajtja e peizazhit natyror dhe zhvillimi i kontrolluar i aktiviteteve turistike dhe rekreative.	Sh.L.: rekreacion, turizëm natyror, sporte në natyrë dhe edukim mjedisor. Sh.D.: shërbime turistike dhe gastronomi. Sh.V.: pajisje turistike dhe infrastrukturë mbështetëse. Sh.N.: aktivitete industriale dhe zhvillime intensive.
ZrT4 - Stadium/Fusha Sportive	Zhvillim dhe mirëmbajtje e infrastrukturës sportive sipas standardeve përkatëse.	Sh.L.: stadiume, fusha sportive, palestra, aktivitete sportive dhe rekreative. Sh.D.: gastronomi dhe shërbime mbështetëse. Sh.V.: objekte administrative dhe teknike sportive. Sh.N.: aktivitete të papajtueshme me funksionin sportiv.
ZrT5 - Qendra Rinore - Pishina "Fitnete Ramosaj"	Zhvillim për sport, rekreacion dhe aktivitete rinore; parametrat sipas HZK-së.	Sh.L.: pishina, aktivitete sportive, edukative dhe rinore. Sh.D.: gastronomi dhe aktivitete kulturore. Sh.V.: objekte edukative, sportive dhe infrastrukturore. Sh.N.: industri, depo dhe aktivitete të papajtueshme me karakterin rekreativ.
ZSh - Zona e Shërbimeve	Parametrat sipas HZK-së; zhvillim për funksione shërbyese publike dhe private; parking sipas	Sh.L.: administratë, arsim, shëndetësi, kulturë, shërbime sociale, shërbime publike dhe private. Sh.D.: tregti, gastronomi dhe aktivitete mbështetëse. Sh.V.: objekte infrastrukturore dhe

Zona / Nënzona	Kushtet zhvillimore dhe ndërtimore	Shfrytëzimet
	normativave; qasje e përshtatshme infrastrukture.	komunitare. Sh.N.: industri e rëndë dhe aktivitete me ndikim të lartë mjedisor.
ZK - Zona Komerciale	Parametrat sipas HZK-së; zhvillim i aktiviteteve tregtare dhe afariste; parking dhe qasje sipas standardeve.	Sh.L.: tregti, qendra tregtare, zyra, hoteleri, gastronomi dhe shërbime biznesore. Sh.D.: magazinim dhe logjistikë e lehtë. Sh.V.: objekte infrastrukture. Sh.N.: industri e rëndë dhe banim i papajtueshëm me funksionin komercial.
ZE - Zona Ekonomike	Parametrat sipas HZK-së; zhvillim ekonomik, prodhues dhe logjistik; infrastrukturë adekuate për zhvillim ekonomik.	Sh.L.: prodhim, përpunim, logjistikë, tregti dhe shërbime biznesore. Sh.D.: magazinim, ekspozim dhe aktivitete mbështetëse. Sh.V.: objekte infrastrukture dhe energjetike. Sh.N.: veprimtari të papajtueshme me destinimin ekonomik.
ZI - Zona Industriale	Parametrat sipas HZK-së; masa mbrojtëse mjedisore, distanca sigurie dhe kushte teknike sipas veprimtarisë industriale.	Sh.L.: industri, prodhim, magazinim dhe logjistikë. Sh.D.: tregti dhe shërbime mbështetëse. Sh.V.: objekte infrastrukture dhe energjetike. Sh.N.: banim dhe funksione të papajtueshme me karakterin industrial.
ZKT - Zona e Komunikacionit dhe Transportit	Korridore transporti, nje komunikacioni, terminale dhe infrastrukturë transporti; brezat mbrojtës dhe kushtet e sigurisë sipas HZK-së dhe legjislacionit sektorial.	Sh.L.: rrugë, terminale, stacione, parkingje publike, infrastrukturë transporti dhe objekte shërbyese të transportit. Sh.D.: tregti dhe shërbime mbështetëse të transportit. Sh.V.: infrastrukturë strategjike dhe objekte teknike. Sh.N.: ndërtime që pengojnë funksionimin dhe sigurinë e sistemit të transportit.
Su - Sipërfaqe Ujore	Ruajtja e regjimit hidrogjik, shtretërve të lumenjve dhe brezave mbrojtës sipas HZK-së dhe legjislacionit për ujërat.	Sh.L.: lumenj, përrenj, rezervuarë, kanale dhe sipërfaqe të tjera ujore. Sh.D.: rekreacion dhe aktivitete të kontrolluara ujore. Sh.V.: infrastrukturë hidroteknike. Sh.N.: aktivitete që cenojnë cilësinë e ujit, regjimin ujor dhe brezat mbrojtës.
Zona Infrastrukture	Korridore dhe objekte infrastrukture për furnizim me ujë, kanalizim, energji, telekomunikim dhe shërbime publike; parametrat sipas HZK-së.	Sh.L.: ujësjellës, kanalizim, trajtim i ujërave të zeza, energji, telekomunikim dhe objekte infrastrukture. Sh.D.: objekte mbështetëse teknike. Sh.V.: infrastrukturë strategjike. Sh.N.: ndërtime që pengojnë funksionimin e sistemeve infrastrukture.
Zona Minierë Sipërfaqësore	Shfrytëzim dhe rehabilitim sipas planeve dhe lejeve përkatëse; masa mbrojtëse mjedisore dhe të sigurisë.	Sh.L.: aktivitete minerare dhe nxjerrje e materialeve minerale. Sh.D.: përpunim, depozitim dhe magazinim i materialeve minerale. Sh.V.: objekte teknike dhe infrastrukture. Sh.N.: banim dhe funksione të papajtueshme me aktivitetin minerar.
ZONAT E MBROJTURA		
ZM1 - Kanioni i Lumëbardhit të Deçanit	Mbrojtje e vlerave natyrore, gjeomorfologjike dhe peizazhike	Sh.L. rekreacioni në natyrë, turizmi malor dhe sportiv, përdorimi i kontrolluar i infrastrukturës ekzistuese rrugore dhe shërbimeve bazike (energji, ujë, telekomunikacion), si dhe aktivitete edukative mjedisore. Po ashtu lejohet zhvillimi i turizmit të butë, përfshirë

Zona / Nënzona	Kushtet zhvillimore dhe ndërtimore	Shfrytëzimet
	sipas legjislacionit për mbrojtjen e natyrës.	<p>gastronominë e vogël, kampingun, ecjen, çiklizmin dhe aktivitetet ujore të lehta, pa ndërhyrje në natyrën e zonës.</p> <p>Sh.D.-aktivitete të kufizuara si mbledhja e produkteve natyrore dhe pylltaria selektive e kontrolluar, si dhe peshkimi e gjuetia vetëm në mënyrë të rregulluar dhe të kufizuar.</p> <p>Sh.N.- ndërtimet e banimit, hidrocentralet, industria, infrastruktura e re e rëndë apo ndërhyrjet që ndryshojnë natyrën e terrenit si mihja, nxjerrja e materialeve minerale dhe deponimi i mbeturinave .Ndalohet çdo aktivitet që shkakton ndotje, shpyllëzim apo dëmtim të faunës dhe florës, me qëllim ruajtjen e integritetit natyror dhe peizazhor të zonës.</p> <p>Sh.V.- aktivitete të kufizuara që lejohen vetëm për nevoja të kontrolluara dhe pa ndikim të rëndësishëm në mjedis,përfshijnë kryesisht prodhimin bujqësor për konsum vetjak, si dhe mbledhjen e produkteve natyrore (p.sh. fruta pylli, bimë mjekësore dhe produkte të tjera jo-drurorë të pyllit), gjithmonë në mënyrë të qëndrueshme dhe pa dëmtuar ekosistemin apo biodiversitetin e zonës.Këto aktivitete nuk kanë karakter intensiv ekonomik dhe synojnë përdorim tradicional të burimeve natyrore, duke ruajtur funksionin kryesor mbrojtës të zonës.</p>
ZM2 - Kanioni i Lumëbardhit të Lloqanit	Mbrojtje e vlerave natyrore, peizazhike dhe ekologjike.	<p>Sh.L.: konservim, rekreacion, turizëm natyror dhe edukim mjedisor. Sh.D.: aktivitete edukative dhe shkencore. Sh.V.: infrastrukturë e lehtë turistike. Sh.N.: aktivitete degraduese dhe zhvillime intensive.</p> <p>Sh.L.- aktivitete të qëndrueshme si rekreacioni në natyrë, turizmi malor dhe sportiv, përdorimi i kontrolluar i infrastrukturës ekzistuese rrugore dhe shërbimeve bazike (energji, ujë, telekomunikacion), si dhe aktivitete edukative mjedisore. aktivitete ekonomike të buta si gastronomia, tregtia e vogël, kampingu, ecja, çiklizmi dhe sportet ujore të lehta, pa ndikim në natyrën e zonës.</p> <p>Sh.D.- lejohen në mënyrë të kufizuar gjuetia, peshkimi, mbledhja e produkteve natyrore dhe pylltaria selektive, me menaxhim të rreptë për të shmangur ndikimet negative në biodiversitet.</p> <p>Sh, V.- prodhimin bujqësor për konsum vetjak dhe mbledhjen e produkteve natyrore, në mënyrë tradicionale dhe të qëndrueshme.</p> <p>Sh.N.- ndërtimet e banimit, hidrocentralet, industria e rëndë apo e lehtë, infrastruktura e re të mëdha, si dhe çdo ndërhyrje që shkakton shpyllëzim, ndotje apo ndryshim të terrenit si mihja dhe nxjerrja e materialeve minerale. Gjithashtu ndalohet deponimi i mbeturinave, dëmtimi i faunës dhe florës, mbjellja e</p>

Zona / Nënzona	Kushtet zhvillimore dhe ndërtimore	Shfrytëzimet
		monokulturave dhe çdo aktivitet tjetër që cenon vlerat natyrore të zones.
ZM3 - Parku Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna"	Mbrojtje sipas legjislacionit për Parkun Kombëtar dhe planeve të menaxhimit; zhvillimet lejohen vetëm sipas zonimit të parkut.	Sh.L.: konservim, kërkim shkencor, turizëm i kontrolluar, rekreacion dhe edukim mjedisor. Sh.D.: aktivitete tradicionale në përputhje me planin e menaxhimit. Sh.V.: infrastrukturë menaxhuese dhe turistike. Sh.N.: zhvillime që cenojnë vlerat natyrore, peizazhin dhe biodiversitetin.
ZM4 - Peizazhe Natyrore	Ruajtja e karakterit peizazhik, estetik dhe ekologjik të zonës.	<p>SH.L aktivitete të qëndrueshme si rekreacioni në natyrë, sportet dhe turizmi malor, përdorimi i infrastrukturës ekzistuese rrugore dhe shërbimeve bazike (energji, ujë, telekomunikacion), si dhe aktivitete edukative dhe kulturore mjedisore. Lejohen gjithashtu shërbime turistike si ecja, vrapimi, çiklizmi, si dhe zhvillimi i turizmit rekreativ dhe kulturor.</p> <p>Sh. D. - lejohen grumbullimi i produkteve natyrore dhe përdorimi i kontrolluar i habitateve për mbrojtjen e llojeve dhe ekosistemeve të rëndësishme.</p> <p>Sh. V- përfshijnë prodhimin bujqësor për konsum vetjak, tregtinë e vogël, kampingun, shërbimet hoteliere dhe gastronomike, parkingjet dhe aktivitetet që mbështesin zhvillimin e turizmit malor, sportiv dhe kulturor.</p> <p>Sh. P- lejohen kryesisht për mbledhjen e produkteve natyrore, me kusht që ato të mos kenë ndikim afatgjatë në mjedis.</p> <p>Sh.N - ndërhyrjet të mëdha infrastrukturore, ndustria e rëndë, hidrocentralet, ndërhyrjet që shkaktojnë shpyllëzim, ndotje apo ndryshim të peizazhit, si dhe instalimet e reja energjetike dhe telekomunikuese në sipërfaqe. Gjithashtu ndalohet deponimi i mbeturinave, gurthyesit, prerjet ilegale, zjarret, si dhe çdo aktivitet që cenon vlerat natyrore dhe estetike të zonës.</p>
Zona e Mbrojtur Arkeologjike-Historike	Mbrojtje sipas legjislacionit për trashëgiminë kulturore; çdo ndërhyrje kërkon pëlqimin e institucioneve kompetente.	Sh.L.: konservim, restaurim, hulumtim, prezantim dhe interpretim i trashëgimisë kulturore. Sh.D.: aktivitete kulturore, edukative dhe turistike. Sh.V.: infrastrukturë interpretimi dhe vizitash. Sh.N.: ndërhyrje që cenojnë integritetin, autenticitetin dhe vlerat historike të zonës.
Zona e Veçantë e Mbrojtur e Manastirit të Deçanit	Mbrojtje sipas Ligjit për Zonat e Veçanta të Mbrojtura; zhvillimet dhe aktivitetet duhet të jenë në përputhje me regjimin e mbrojtjes. Zona mbishtesore e Manastirit të Deçanit paraqet një regjim të	Sh.L.: funksione fetare, kulturore, edukative dhe turistike të kontrolluara. Sh.D.: aktivitete tradicionale të përputhshme me karakterin e zonës. Sh.V.: infrastrukturë mbështetëse dhe objekte në funksion të menaxhimit të zonës. Sh.N.: zhvillime që cenojnë integritetin, peizazhin, qetësinë dhe funksionimin e zonës së mbrojtur.

Zona / Nënzona	Kushtet zhvillimore dhe ndërtimore	Shfrytëzimet
	<p>veçantë planifikimi që mbivendoset mbi zonimet bazë të territorit dhe imponon kufizime shtesë zhvillimore.</p> <p>Mbron kontekstin historik dhe vizual të Manastirit të Deçanit; Ruan autenticitetin e peizazhit kulturor; Kufizon zhvillimet që mund të cenojnë vlerat monumentale dhe simbolike të zonës.</p> <p>Aspekti Natyror dhe Peizazhor</p> <p>Mbron Grykën e Deçanit dhe Luginën e Lumëbardhit; Ruan formacionet gjeologjike karakteristike;</p> <p>Mbron pyjet e pishës së zezë, gështenjat dhe habitatet natyrore me biodiversitet të lartë.</p> <p>Aspekti Hidrologjik</p> <p>Mbron rrjedhat e përhershme ujore të Lumëbardhit; Kufizon ndërhyrjet që mund të ndikojnë në ekosistemin lumor dhe cilësinë e ujit.</p> <p>Aspekti i Menaxhimit të Rrezikut</p> <p>Kërkon masa shtesë për parandalimin e rrëshqitjeve të tokës; Kufizon prerjen e pakontrolluar të pyjeve dhe ndërhyrjet infrastrukturore që destabilizojnë terrenin</p>	
ZONAT MBISHTRESORE		
ZmSH-S - Zonë Sizmike	<p>Projektimi, ndërtimi dhe rehabilitimi i objekteve duhet të realizohen sipas standardeve dhe normave antisizmike në fuqi; studimet gjeoteknike dhe sizmike kërkohen sipas rastit.</p>	<p>Sh.L.: të gjitha shfrytëzimet e lejuara në zonën bazë. Sh.D.: sipas zonës bazë. Sh.V.: sipas zonës bazë. Sh.N.: sipas kufizimeve të përcaktuara nga rreziku sismik dhe legjislacioni përkatës.</p>

Zona / Nënzona	Kushtet zhvillimore dhe ndërtimore	Shfrytëzimet
ZmSH-V - Zonë e Vërshimeve	Zhvillimi kushtëzohet me masa mbrojtëse nga përmytjet, ruajtjen e brezave mbrojtës, drenazhimin dhe respektimin e nivelit të rrezikut.	Sh.L.: shfrytëzimet e lejuara në zonën bazë kur nuk rrezikohet siguria nga përmytjet. Sh.D.: sipas zonës bazë dhe nivelit të rrezikut. Sh.V.: objekte mbrojtëse dhe infrastrukturore. Sh.N.: zhvillime që rrisin ekspozimin ndaj rrezikut nga vërshimet.
ZmSH-A - Zonë e Akuiferëve	Mbrojtja e rezervave ujore nëntokësore; kufizime për aktivitetet që mund të shkaktojnë ndotje të ujërave; zbatohen zonat sanitare mbrojtëse.	Sh.L.: shfrytëzimet e lejuara në zonën bazë që nuk ndikojnë në cilësinë e ujërave nëntokësore. Sh.D.: aktivitete me ndikim të kontrolluar. Sh.V.: infrastrukturë për furnizim me ujë. Sh.N.: aktivitete që mund të ndotin akuiferët dhe burimet ujore.
ZmSH-PM - Zonë e Pasurive Minerare	Ruajtja dhe shfrytëzimi racional i resurseve minerare; zhvillimet e tjera lejohen vetëm nëse nuk pengojnë shfrytëzimin e tyre potencial.	Sh.L.: shfrytëzimet e lejuara në zonën bazë dhe aktivitetet minerare të autorizuar. Sh.D.: aktivitete mbështetëse të shfrytëzimit mineral. Sh.V.: objekte teknike dhe infrastrukturore. Sh.N.: zhvillime që pamundësojnë shfrytëzimin e resurseve minerare.
ZmSH-Rr - Zonë me Rrëshqitje të Dheut	Zhvillimi kushtëzohet me studime gjeologjike dhe gjeoteknike; kërkohen masa stabilizuese dhe kufizime ndërtimore në zonat me rrezik të lartë.	Sh.L.: shfrytëzimet e lejuara në zonën bazë kur sigurohet stabiliteti i terrenit. Sh.D.: aktivitete me ndikim të kufizuar. Sh.V.: masa stabilizuese dhe infrastrukturore. Sh.N.: zhvillime që rrisin rrezikun e rrëshqitjeve.
ZmSH-E - Zonë me Erozion	Zbatohen masa për kontrollin e erozionit, pyllëzimin, stabilizimin e shpateve dhe menaxhimin e ujërave sipërfaqësore.	Sh.L.: shfrytëzimet e lejuara në zonën bazë që nuk përkeqësojnë proceset erozive. Sh.D.: aktivitete me ndikim të kontrolluar. Sh.V.: masa mbrojtëse, pyllëzim dhe rehabilitim. Sh.N.: aktivitete që përshpejtojnë degradimin dhe humbjen e tokës.

Legjenda: Sh.L. - Shfrytëzime të Lejuara; Sh.D. - Shfrytëzime Dytësore; Sh.V. - Shfrytëzime të Veçanta; Sh.P. Shfrytëzime të Përkohshme, Sh.N. - Shfrytëzime të Ndaluar

ISN - Indeksi i Sipërfaqes së Ndërtuar; ISHPKZh - Indeksi i Shfrytëzimit të Parcelës Kadastrale për Zhvillim; SNP - Sipërfaqja Natyrore e Parcelës; SGJP - Sipërfaqja e Gjellbëruar e Parcelës; P - Përdhesa; K - Kat; Nk - Nënkulm; D - Dendësia e banimit (banorë/ha).

Tabela 6. paraqet në mënyrë të përmbledhur zonat, nënzonat dhe zonat mbishtresore të Hartës Zonale të Komunës së Deçanit. Parametrat e paraqitur janë të sintetizuar për qëllime informuese. Për kushtet e detajuara zhvillimore dhe ndërtimore, përfshirë ISN, ISHPKZh, SNP, SGJP, madhësinë minimale të parcelës, ballin e parcelës, etazhitetin, vijat ndërtimore, largësitë nga kufijtë e parcelës dhe kushtet specifike sipas tipologjive, duhet t'i referoheni dispozitave përkatëse të HZK-së.

2.3.5 Trajtimi Vendbanimeve joformale

Në Komunën e Deçanit janë identifikuar 8 vendbanime joformale që pritet të formalizohen, në varësi të kornizës ligjore dhe proceseve gjyqësore, duke e bërë këtë një proces afatgjatë.

Këto vendbanime kanë shërbime bazike, por përballen me probleme pronësore dhe me shfrytëzimin e ndërtesave, si në rastin e Baballoqit 1 dhe 2, të ndërtuara në pronë komunale në kuadër të programeve të mëhershme “Ju Program” dhe “Solidaritet”.

Në total përfshijnë 247 ndërtesa në 64.81 ha, me rreth 247 familje dhe afro 1137 banorë.




Figura 2. Harta për propozimet për hartimin e Planeve të Hollësishme Rregullues

2.3.6 Përcaktimi i zonave për të cilat hartohet Plani Rregullues i Hollësishëm

Zonat urbane, Zonën III zhvillimore në kuadër të Parkut Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”, në të cilën parashihen të hartohen **16 Plane Rregulluese të Hollësishme** si dhe për vendbanimet joformale.

2.3.7 Plani i veprimit për zbatim të Hartës Zonale të Komunës

Bazuar në Planin e Veprimit për zbatimin e Hartës Zonale të Komunës së Deçanit, projektet tematike me ndikim potencial në mjedis paraqesin një spektër të gjerë ndërhyrjesh, të cilat lidhen drejtpërdrejt me transformimin hapësinor, zhvillimin ekonomik dhe menaxhimin e burimeve natyrore. Analiza e tyre kërkon kontekstualizim sipas sektorëve dhe lokalizimit territorial, duke identifikuar jo vetëm natyrën e projekteve, por edhe mënyrën se si ato ndërveprojnë me sistemet mjedisore ekzistuese.

Në sektorin e infrastrukturës së transportit, projektet për ndërtimin dhe zgjerimin e rrugëve në zona si Pleqe, Belle, Strelc, Llukë dhe drejt Bjeshkës së Madhe, si dhe zgjerimi i rrugëve në qendrën e qytetit të Deçanit, përfaqësojnë ndërhyrje me ndikim të drejtpërdrejtë në përdorimin e tokës dhe në strukturën hapësinore. Këto projekte shoqërohen me rrezik të fragmentimit të peizazhit, rritje të sipërfaqeve të impermeabilizuara dhe potencial për rritje të ndotjes së ajrit dhe zhurmës. Veçanërisht problematike mund të jenë ndërhyrjet në drejtim të zonave malore dhe të Parkut Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”, ku hapja dhe asfaltimi i rrugëve mund të ndikojë në stabilitetin e terrenit, në erozion dhe në habitatet natyrore. Ndërtimi i parkingjeve dhe garazhave publike në hyrje të qytetit kontribuon në riorganizimin e trafikut, por njëkohësisht rrit presionin mbi hapësirat urbane dhe kërkon menaxhim të kujdesshëm të ujërave sipërfaqësore.

Në sektorin e zhvillimit ekonomik dhe turizmit, projektet janë të përqendruara kryesisht në zonat me vlera të larta natyrore dhe peizazhore, si Gryka e Lloqanit, Strellci i Epërm dhe hapësirat brenda Parkut Kombëtar. Ndërtimi i fshatrave turistike si “Laku i Kryqes” dhe “Podi i Gështenjave”, rezidencave turistike, vilave dhe shtëpive alpine, si dhe zhvillimi i shtigjeve për ecje dhe aktiviteteve aventureske, krijojnë potencial për zhvillim ekonomik, por njëkohësisht paraqesin rrezik për mbingarkesë të ekosistemeve. Ndërtimi i tri pendave akumuluese në Grykën e Lloqanit është një ndër projektet me ndikimin më të madh potencial, pasi ndërhyrjet drejtpërdrejt në regjimin hidrologjik, në rrjedhën natyrore të ujërave dhe në biodiversitetin ujor dhe riparian. Gjithashtu, ndërtimi i qendrave për përpunimin e produkteve natyrore dhe komplekseve gastronomike mund të sjellë presion mbi burimet ujore dhe të kërkojë sisteme efikase të menaxhimit të mbeturinave dhe ujërave të ndotura.

Projektet në sektorin e ujësjellësit dhe kanalizimit përbëjnë ndër ndërhyrjet më kritike nga pikëpamja mjedisore. Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit në zona si Hulaj dhe Bjeshkët e Deçanit, si dhe ndërtimi i sistemeve të reja të furnizimit me ujë në zona malore, lidhen me shfrytëzimin e burimeve ujore dhe kërkojnë balancim të qëndrueshëm ndërmjet furnizimit dhe ruajtjes së ekosistemeve. Ndërtimi i rrjeteve të kanalizimit në 18 fshatra dhe i impianteve të trajtimit të ujërave të zeza në disa lokalitete (Strellci i Ulët, Dubovik, Isniq, Prapaqan) paraqet një hap pozitiv drejt përmirësimit të cilësisë së ujit, por gjatë fazës së ndërtimit mund të shkaktojë ndikime në tokë, ujëra nëntokësore dhe në habitatet lokale. Po ashtu, ndërtimi i kanalizimit për ujërat atmosferik në pjesën e vjetër të qytetit dhe në vendbanime të ndryshme ndikon në ndryshimin e regjimit të drenazhimit dhe kërkon integrim me masa të infrastrukturës së gjelbër për të shmangur rrezikun e përmytjeve.

Në sektorin e bujqësisë, projektet për ndërtimin e një rrjeti të gjerë të kanaleve të ujitjes në zona si Irzniq, Carrabreg, Llukë, Glllogjan dhe Baballoq, si dhe ndërhyrjet në lumin Lumëbardh për ndërtimin e pendave të ujitjes, ndikojnë drejtpërdrejt në sistemet hidrologjike dhe në përdorimin e tokës bujqësore. Këto ndërhyrje mund të kontribuojnë në rritjen e produktivitetit bujqësor, por njëkohësisht rrisin rrezikun e erozionit, ndryshimit të rrjedhës natyrore të ujërave dhe degradimit të habitateve ujore nëse nuk planifikohen me kujdes.

Projektet në fushën e energjisë dhe infrastrukturës teknike, si elektrifikimi i zonave malore (Bjeshka e Belegut, Pleqe, Belle), zgjerimi i rrjetit elektrik dhe ndriçimi publik në zonat rurale, ndikojnë në përmirësimin e kushteve të jetesës, por gjithashtu mund të kenë ndikime vizuale në peizazh dhe të kontribuojnë në fragmentimin e habitateve, veçanërisht në zonat e ndjeshme natyrore.

Në sektorin e menaxhimit të mbeturinave, projektet për ndërtimin e deponisë inerte, qendrave grumbulluese për mbeturinat nga ndërtimi dhe demolimi, si dhe krijimi i ishujve ekologjikë dhe shpërndarja e kontejnerëve, paraqesin masa të rëndësishme për përmirësimin e menaxhimit të mbeturinave. Megjithatë, vendndodhja dhe menaxhimi i këtyre infrastrukturave janë kritike për të shmangur ndotjen e tokës dhe ujërave nëntokësore.

Projektet në sektorin e hapësirave publike dhe zhvillimit urban, si ndërtimi i sheshit të qytetit, rregullimi i hapësirave publike dhe ndërtimi i objekteve memoriale, ndikojnë në transformimin e strukturës urbane dhe në cilësinë e mjedisit të ndërtuar. Këto ndërhyrje, megjithëse me ndikim më të kufizuar krahasuar me projektet infrastrukturore, kërkojnë integrim

të elementeve të gjelbërimit dhe menaxhimit të ujërave për të shmangur efektet negative mikroklimatike.

Ndërsa, projektet në kuadër të mbrojtjes së mjedisit përfaqësojnë ndërhyrje me ndikim pozitiv, të cilat synojnë adresimin e problemeve ekzistuese. Këto përfshijnë hartimin e planeve për biodiversitetin dhe cilësinë e ajrit, projekte për mbrojtjen nga përmbytjet në zona si Strellc, Isniq dhe Prilep, mbjelljen e fidaneve në zonat e degraduara, si dhe ndërtimin e strukturave mbrojtëse kundër erozionit në përrrenj. Po ashtu, pastrimi i shtratit të Lumëbardhit dhe promovimi i praktikave të qëndrueshme në bujqësi dhe peshkim kontribuojnë në ruajtjen e ekosistemeve dhe në reduktimin e presioneve mjedisore.

Në përfundim, projektet me ndikimin më të madh potencial në mjedis janë ato që lidhen me infrastrukturën fizike (rrugët, kanalizimi, ujësjellësi), zhvillimin turistik në zonat e mbrojtura dhe ndërhyrjet në sistemet ujore (penda, kanale, akumulime). Ndërkohë, projektet e menaxhimit të mbeturinave dhe mbrojtjes së mjedisit luajnë rol balancues, duke kontribuar në reduktimin e ndikimeve negative dhe në rritjen e qëndrueshmërisë së zhvillimit territorial të Komunës së Deçanit.

Tabela 7 - Masat zbutëse që duhet me i ndërmarrë për minimizimin apo eliminimin e ndikimit negativ në mjedis

Projekti / Grupi i projekteve	Masat zbutëse
Ndërtimi dhe zgjerimi i rrugëve, parkingjeve dhe garazhave publike	Kufizimi i ndërhyrjeve jashtë korridorit të planifikuar; rehabilitimi dhe gjelbërimi i sipërfaqeve të dëmtuara; instalimi i sistemeve për drenazhimin dhe trajtimin e ujërave sipërfaqësore; përdorimi i masave kundër pluhurit dhe zhurmës gjatë ndërtimit; ndërtimi i kalimeve ekologjike në zonat e ndjeshme; shmangia e ndërhyrjeve në habitatet me vlerë të lartë natyrore.
Rrugët në drejtim të Bjeshkëve të Nemuna dhe zonave malore	Hartimi i studimeve gjeoteknike dhe të biodiversitetit para ndërtimit; minimizimi i prerjeve të terrenit; stabilizimi i shpateve kundër erozionit; kufizimi i gjerësisë së rrugëve; rehabilitimi me specie autoktone; monitorimi i ndikimeve në habitatet e mbrojtura.
Fshatra turistike, vila, rezidenca turistike dhe infrastruktura turistike	Kufizimi i kapacitetit ndërtimor sipas kapacitetit mbajtës të zonës; trajtimi i ujërave të ndotura me sisteme individuale ose kolektive; menaxhimi i mbeturinave; ruajtja e korridoreve ekologjike dhe vegjetacionit ekzistues; përdorimi i materialeve tradicionale dhe integrimi në peizazh.
Penda akumuluese dhe akumulimet ujore në Grykën e Lloqanit	Realizimi i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM); ruajtja e prurjes minimale ekologjike; monitorimi i cilësisë së ujit; masa për migrimin e faunës ujore; rehabilitimi i habitateve të prekura; menaxhimi i sedimentimit dhe erozionit.
Qendrat për përpunimin e produkteve natyrore dhe komplekset gastronomike	Instalimi i impianteve për trajtimin e ujërave të ndotura; menaxhimi i mbetjeve organike; përdorimi racional i ujit dhe energjisë; monitorimi i shkarkimeve dhe emetimeve; zbatimi i standardeve mjedisore për bizneset.
Sistemet e ujësjellësit dhe furnizimit me ujë	Përcaktimi i zonave mbrojtëse të burimeve ujore; monitorimi i sasisë dhe cilësisë së ujit; kufizimi i ndërhyrjeve në burime; rehabilitimi i zonave të prekura gjatë ndërtimit; reduktimi i humbjeve në rrjet.
Kanalizimi dhe impiantet e trajtimit të ujërave të zeza	Ndërtimi sipas standardeve teknike dhe mjedisore; kontrolli i rrjedhjeve dhe infiltrimeve; trajtimi i plotë i ujërave para

	shkarkimit; rehabilitimi i sipërfaqeve të gërmuara; monitorimi i cilësisë së ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore.
Kanalet e ujitjes dhe ndërhyrjet në Lumëbardh	Ruajtja e rrjedhës ekologjike; shmangia e betonizimit të panevojshëm; përdorimi i zgjidhjeve të bazuara në natyrë; stabilizimi biologjik i brigjeve; monitorimi i habitateve ujore dhe i proceseve erozive.
Elektrifikimi dhe rrjetet energjetike në zonat malore	Përdorimi i korridoreve ekzistuese infrastrukturore; shmangia e habitateve prioritare; minimizimi i prerjes së pyjeve; vendosja e linjave në mënyrë që të reduktohet rreziku për shpendët; rehabilitimi i zonave të prekura.
Deponia inerte, qendrat grumbulluese dhe ishujt ekologjikë	Përzgjedhja e lokacioneve jashtë zonave të ndjeshme ujore; izolimi i bazamentit; sistemi për grumbullimin e lixivateve; monitorimi i ujërave nëntokësore; mbulimi periodik dhe gjelbërimi i zonave përreth.
Sheshet, hapësirat publike dhe projektet urbane	Rritja e sipërfaqeve të gjelbra; përdorimi i materialeve të depërtueshme për ujërat atmosferike; mbjellja e drunjve hijezues; integrimi i infrastrukturës së gjelbër dhe blu; minimizimi i efektit të ishullit të nxehtësisë urbane.

Në këtë kontekst masat e përgjithshme për të gjitha projektet duhen të jenë:

- Realizimi i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) për projektet që kërkohen me ligj;
- Respektimi i kufizimeve në zonat e mbrojtura dhe në Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”;
- Monitorimi periodik i cilësisë së ajrit, ujit, tokës dhe zhurmës;
- Hartimi dhe zbatimi i planeve të menaxhimit të mbetjeve gjatë ndërtimit dhe operimit;
- Rehabilitimi dhe rikultivimi i sipërfaqeve të degraduara pas përfundimit të punimeve;
- Prioritizimi i zgjidhjeve të bazuara në natyrë për menaxhimin e ujërave, erozionit dhe biodiversitetit.

2.3.8 Proceset për ndryshime, përjashtime, jokonformitete dhe bonuset e zonimit

Ndryshimet dhe plotësimet e HZK-së paraqesin modifikime në përmbajtjen tekstuale dhe hartografike të dokumentit, me qëllim përshtatjen ndaj kushteve të reja zhvillimore dhe interesit publik. Ky proces zhvillohet vetëm pas miratimit nga Kuvendi Komunal dhe pëlqimit nga MMPHI, duke respektuar procedurat e UA 24/2015 dhe duke përfshirë konsultim publik. Gjatë shqyrtimit vlerësohet ndikimi në strukturën urbane, kapacitetet infrastrukturore dhe aspektet mjedisore, duke mos lejuar uljen e standardeve për sipërfaqet e gjelbra, qarkullimin apo cilësinë e hapësirës urbane.

Përjashtimet

kushtet zhvillimore lejohen vetëm në raste të veçanta kur karakteristikat specifike të parcelës e bëjnë të pamundur respektimin e plotë të parametrave të HZK-së. Ato nuk mund të bazohen në interesa personale dhe nuk duhet të krijojnë ndikime negative në mjedis, siguri publike, qarkullim, ndriçim natyror apo në pronat përreth. Përjashtimet shqyrtohen përmes procedurave publike dhe mund të aplikohen edhe për përmirësimin e qasshmërisë për persona me aftësi të kufizuara, duke siguruar një zhvillim më gjithëpërfshirës dhe funksional të hapësirës.

Jokonformitetet

Jokonformiteti nënkupton një ndërtesë, parcelë ose shfrytëzim ekzistues që nuk përputhet me kërkesat aktuale të zonimit të HZK-së. Këto raste mund të vazhdojnë të ekzistojnë vetëm pasi të legalizohen dhe deri në ndryshimin e funksionit ose përdorimit të tokës. Në rast dëmtimi nga fatkeqësi

natyrore, objekti mund të rindërtohet vetëm duke ruajtur parametrat ekzistues pa rritje të intensitetit të zhvillimit, me qëllim shmangien e ndikimeve shtesë në mjedis dhe infrastrukturë. Identifikimi i rasteve jokonforme në Deçan synon gjithashtu reduktimin e rrezikut urban, përmirësimin e sigurisë strukturore dhe harmonizimin gradual me standardet mjedisore dhe hapësinore të HZK-së.

Bonuset e zonimit

Bonuset e zonimit janë stimuj zhvillimorë që komuna mund t'u ofrojë zhvilluesve në këmbim të krijimit të përfitimeve publike dhe mjedisore. Këto masa mund të përfshijnë rritje të dendësisë apo lartësisë së ndërtesave, ulje të kërkesave për parcelë ose lehtësime financiare, në rastet kur sigurohen hapësira të gjelbra, përmirësim i lëvizjes së këmbësorëve, ruajtje e trashëgimisë kulturore apo integrim i vendbanimeve joformale. Zbatimi i bonuseve bëhet përmes marrëveshjeve ndërmjet komunës dhe zhvilluesit, duke garantuar transparencë, shqyrtim publik dhe vlerësim të ndikimit në mjedis, me qëllim zhvillimin më të qëndrueshëm dhe funksional të territorit urban.

2.3.9 Dispozitat për interpretimin, ankesat, zbatimin dhe monitorimin e zbatimit të Hartës Zonale të Komunës

Harta Zonale e Komunës së Deçanit është hartuar si dokument i detajuar dhe gjithëpërfshirës për menaxhimin dhe zhvillimin e territorit, interpretimi i dispozitave të saj bëhet nga autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor perkatesisht Dejtoria për Urbanizëm , Planifikim Hapësinorë dhe Mbrojtje të Mjedisit. Interpretimi përfshin sqarimin e kushteve zhvillimore dhe ndërtimore, si vijat rregulluese dhe ndërtimore, lartësinë e objekteve, përqindjen e gjelbërimit, qasjen në infrastrukturë, kufizimet e ndotjes dhe zhurmës, si dhe masat për mbrojtjen e vlerave natyrore, historike dhe kulturore. Çdo interpretim duhet të jetë në përputhje me dispozitat e HZK-së dhe legjislacionin përkatës në fuqi.

Zbatimi i HZK-së realizohet përmes procedurave të dhënies së kushteve dhe lejeve ndërtimore, bonusit të zonimit, trajtimit të jokonformiteteve dhe përjashtimeve, si dhe përmes hartimit të Planeve Rregulluese të Hollësishme në rastet kur komuna e sheh të nevojshëm dhe kur nevojiten detajime shtesë. Në rastet kur infrastruktura rrugore, teknike apo publike nuk i plotëson kushtet e nevojshme, komuna mund të përdorë instrumente si bonuset e zonimit, eksproprijimi ose zgjidhje teknike inxhinierike për realizimin e projekteve dhe përmirësimin e funksionalitetit urban dhe mjedisor.

Monitorimi i zbatimit të HZK-së realizohet përmes përditësimit të vazhdueshëm të bazës së të dhënave hapësinore në GIS, evidentimit të lejeve ndërtimore, ndryshimeve, plotësimeve dhe përjashtimeve të miratuara nga komuna. Autoriteti komunal është i obliguar të shqyrtojë kërkesat për interpretim dhe të japë vendim me shkrim brenda afatit prej 30 ditësh, ndërsa për çdo pakënaqësi subjektet fizike dhe juridike kanë të drejtë ankese sipas Ligjit për Procedurën Administrative dhe mund të kërkojnë interpretim edhe nga niveli qendror për planifikim hapësinor.

2.4 Marrëdhënia me planet dhe programet tjera

Hartimi i HZK-së së Komunës së Deçanit është bazuar në dokumentet kryesore të planifikimit hapësinor dhe strategjik në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal, me qëllim të sigurimit të koherencës zhvillimore dhe harmonizimit të politikave sektoriale. Dokumenti kryesor referues për zhvillimin hapësinor të rajonit mbetet Plani Hapësinor i Kosovës 2010–2020+, i cili përcakton orientimet strategjike për zhvillimin territorial të Kosovës. Gjithashtu, gjatë procesit të hartimit të HZK-së janë marrë parasysh edhe projekt-Harta Zonale e Kosovës, dokumentet zhvillimore sektoriale, strategjitë rajonale dhe zhvillimet e planifikuara në komunat fqinje.

Sipas PHK-së, Komuna e Deçanit, së bashku me komunat e Gjakovës, Rahovecit dhe Malishevës, bën pjesë në rajonin funksional të njohur si “Urat e Kosovës”, respektivisht në “Hapësirën e Verdhë”, e karakterizuar nga zhvillimi i aktiviteteve tregtare, turistike, agro-industriale dhe industrisë së lehtë. Në këtë kontekst, Komuna e Gjakovës paraqitet si qendra kryesore rajonale, ndërsa Deçani luan rol të rëndësishëm në zhvillimin e turizmit malor, bujqësisë dhe lidhjeve ndërkufitare.

PHK gjithashtu parasheh forcimin e lidhjeve infrastrukturore dhe ekonomike ndërmjet Rrafshit të Dukagjinit dhe pjesës veriore të Shqipërisë, përmes korridoreve zhvillimore dhe qasjes drejt portit të Shëngjinit. Këto orientime strategjike kanë ndikuar drejtpërdrejt në përcaktimin e zonave zhvillimore, korridoreve infrastrukturore, zonave turistike dhe ekonomike në HZK të Deçanit.

Në nivel lokal, HZK është hartuar në përputhje me Plani Zhvillimor Komunal i Deçanit, duke integruar prioritetet strategjike të komunës lidhur me zhvillimin e turizmit, infrastrukturës, bujqësisë, mbrojtjes së mjedisit, trashëgimisë kulturore dhe zhvillimit socio-ekonomik. Gjithashtu janë marrë në konsideratë dokumentet sektoriale për mbrojtjen e mjedisit, menaxhimin e ujërave, pyjeve, trashëgimisë kulturore dhe zonave të mbrojtura, veçanërisht ato që lidhen me Bjeshkët e Nemuna dhe zonat me ndjeshmëri të lartë ekologjike.

Kjo qasje ka mundësuar që HZK-ja të sigurojë koordinim ndërmjet zhvillimit urban, mbrojtjes së resurseve natyrore dhe orientimeve strategjike rajonale, duke krijuar bazë për zhvillim më të qëndrueshëm dhe integrim më të mirë territorial të Komunës së Deçanit.

III. ÇËSHTJET KYÇE MJEDISORE DHE OBJEKTIVAT E VSM-së

3.1. Analiza e apekteve mjedisore

Ligji për Vlerësimin Strategjik Mjedisor (VSM) kërkon që Raporti i VSM-së të përfshijë një përshkrim të gjendjes aktuale të mjedisit dhe zhvillimit të mundshëm të tij në rast të moszbatimit të planit apo programit, si dhe një përmbledhje të çështjeve ekzistuese mjedisore. Nënkapitulli i parë jep një përmbledhje të karakteristikave kyçe gjeografike, sociale dhe ekonomike të Komunës së Deçanit, duke ofruar një kontekst më të qartë. Nënkapitulli i dytë përmbush kërkesën ligjore për të përshkruar aspektet mjedisore të përcaktuara në Ligjin për VSM. Studimi i gjendjes fillestare të mjedisit bazohet në analizën e burimeve të informacionit të referuara në Hyrjen e raportit.

3.2 Karakteristikat gjeografike

Komuna e Deçanit shtrihet në pjesën perëndimore të Kosovës, në Rrafshin e Dukagjinit, dhe karakterizohet nga një pasuri e theksuar natyrore dhe diversiteti i madh gjeografik, duke përfshirë ultësirën pjellore të Rrafshit të Dukagjinit dhe zonat malore të Bjeshkëve të Nemuna. Kjo strukturë krijon kushte të favorshme për bujqësi, por edhe për zhvillimin e turizmit malor dhe rekreativ. Territori përshkohet nga burime të rëndësishme ujore, si Lumëbardhi i Deçanit dhe Lumëbardhi i Lloqanit, ndërsa një pjesë e konsiderueshme mbulohet nga pyje dhe zona të mbrojtura me biodiversitet të pasur. Klima është kontinentale me ndikim mesdhetar, me reshje të bollshme dhe kushte të mira për zhvillim natyror. Në tërësi, Deçani paraqet një hapësirë me potencial të lartë ekologjik dhe peizazhor, që përbën bazë të rëndësishme për zhvillim të qëndrueshëm.

3.2.1 Gjeologjia

Territori i Deçanit është formuar nga procese gjeologjike që shtrihen në miliona vite dhe karakterizohet nga një ndërtim i larmishëm litologjik, ku dominojnë formacionet sedimentare dhe shkëmbinjtë metamorfikë. Gjatë epokës alpine, lëvizjet tektonike ngritën Bjeshkët e Nemuna, ndërsa Rrafshi i Dukagjinit u ul dhe u mbush me sedimente. Territori përbëhet nga gurë ranorë, filit, reshpe klorite dhe gëlqerorë, si dhe sedimente liqenore dhe lumore, që janë veçanërisht të përhapura në

zonat e ultësirës. Në zonat malore hasen edhe shkëmbinj më kompaktë si metagranitë dhe ortoskistë. Kjo përbërje gjeologjike ndikon drejtpërdrejt në formimin e tokave, në stabilitetin e terrenit dhe në proceset natyrore si erozioni dhe rrëshqitjet, duke e bërë territorin njëkohësisht të pasur me resurse natyrore, por edhe të ndjeshëm ndaj degradimit. Gjeologjia e pasur e Deçanit përcakton jo vetëm relievin e tij, por edhe burimet natyrore, si tokat pjellore dhe potencialet minerare.




Figura 3. Harta gjeologjike e komunës së Deçanit(Burimi:Plani Zhvillimor Komunal 2024-2932)

3.2.2 Seizmika

Deçani nuk bën pjesë në zonat me aktivitet të lartë sizmik, megjithatë prania e strukturave tektonike e bën territorin relativisht të ndjeshëm ndaj lëkundjeve të moderuara, si dhe ndaj proceseve natyrore si erozioni dhe rrëshqitjet. Kjo e bën tektonikën një faktor të rëndësishëm në planifikimin hapësinor dhe në vlerësimin e qëndrueshmërisë së terrenit.

Struktura tektonike e zonës karakterizohet nga prania e palosjeve dhe dislokimeve (çarjeve), të cilat kanë ndikuar në fragmentimin e terrenit dhe në orientimin e luginave lumore. Si pasojë e këtyre proceseve, janë formuar basene sedimentare në ultësirë, të cilat në fazat më të vona gjeologjike janë mbushur me materiale aluviale.Në tërësi, tektonika ka luajtur rol përcaktues në formësimin e relievit aktual të Deçanit, në shpërndarjen e resurseve natyrore dhe në krijimin e kushteve për zhvillim urban dhe rural brenda territorit komunal.

3.2.3 Relievi

Relievi i Deçanit paraqet një strukturë të diferencuar dhe dinamike, të formuar nga ndërveprimi i proceseve tektonike dhe erozive, duke u ndarë qartë në dy njësi kryesore: ultësira e Rrafshit të Dukagjinit dhe zona malore e Bjeshkëve të Nemuna. Kjo ndarje krijon kontrast të theksuar në formën e terrenit, përdorimin e hapësirës dhe karakteristikat natyrore.

Pjesa lindore dhe qendrore dominohet nga reliev i rrafshët ose lehtësisht i valëzuar me sipërfaqe aluviale, toka pjellore dhe kushte të favorshme për zhvillim bujqësor dhe urban, ku janë përqendruar shumica e vendbanimeve.Ndërsa, pjesa perëndimore përfshin reliev malor të ashpër me shpate të pjerrëta, luginat të thella dhe maja mbi 2500 m, më pak i përshtatshëm për ndërtim, por me potencial për pylltari, kullota dhe turizëm.

Rrjeti hidrografik, veçanërisht Lumëbardhi i Deçanit dhe ai i Lloqanit, ka ndikuar në formësimin e relievit përmes proceseve erozive dhe depozituese. Ky reliev shoqërohet edhe me ndjeshmëri ndaj rreziqeve natyrore: erozion dhe rrëshqitje në zonat malore, si dhe përmbytje në ultësi.

Në tërësi, relievi i Deçanit përfaqëson një kombinim të hapësirave të përshtatshme për zhvillim dhe zonave me vlera të larta natyrore, duke kërkuar një qasje të kujdesshme në planifikimin hapësinor dhe menaxhimin e rreziqeve.

3.2.4 Erozioni

Në Komunën e Deçanit janë evidentuar zona të theksuara erozive si tokat bujqësore, pyjore, livadhet, shtretërit e lumenjve dhe hapësirat përreth tyre, duke shkaktuar dëme në bujqësi, pylltari dhe infrastrukturë.




Figura 4. Harta e erozionit (burimi: Plani Zhvillimor Komunal 2024-20032)

Zonat më të prekura janë Bjeshkët në pjesën perëndimore të komunës, rrënza e Lumëbardhit dhe Lloqanit, ku rreth 53% e sipërfaqes së pellgut konsiderohet nën ndikim eroziv. Shkaqet kryesore lidhen me faktorët natyrorë, si reshjet intensive, pjerrësia e terrenit dhe mungesa e mbulesës bimore, por edhe me aktivitetet njerëzore, përfshirë nxjerrjen e zavorrit nga lumenjtë, mosmirëmbajtjen e shtretërve të lumenjve, prerjen e pyjeve, mbikullotjen dhe ndërtimet e pakontrolluara. Masat kryesore kundër erozionit përfshijnë ndërtimin e pendave dhe mbrojtësve në brigjet e lumenjve, pyllëzimin e zonave të degraduara dhe krijimin e brezave gjelbërues përgjatë lumenjve kryesorë.

3.3 Karakteristika socio-ekonomike të Komunës së Deçanit

3.3.1 Popullsia dhe shëndeti publik

Sipas regjistrimit të vitit 2024 komuna e Deçanit ka 27 775 mijë banorësh dhe 5,909 ekonomi familjare dhe shkallë të urbanizimit <20%, me dendësi relativisht të ulët, nën 100 banorë për km², që reflekton një karakter kryesisht rural, ku aktivitetet ekonomike mbështeten kryesisht në bujqësi, ndërmarrje të vogla dhe në turizëm. Në këtë drejtim, dokumentet strategjike e pozicionojnë Deçanin si një zonë me potencial të lartë për zhvillim turistik, bazuar në trashëgiminë natyrore dhe kulturore. Në Komunën e Deçanit, shëndeti publik organizohet kryesisht përmes kujdesit parësor shëndetësor, me 1 QKMF në Deçan, 3 QMF dhe 7 AMF, prej të cilave tri nuk janë funksionale. Sistemi

ofron shërbime bazë shëndetësore, emergjente dhe dentare, me rreth 120 punëtorë shëndetësorë të angazhuar. Megjithëse ekziston mbulim relativisht i mirë territorial, mungesa e disa shërbimeve specialistike dhe mosfunksionalizimi i disa ambulancave mbeten sfida për cilësinë dhe qasjen në kujdesin shëndetësor.

3.4 Përshkrimi i gjendjes ekzistuese të mjedisit dhe zhvillimit të tij të mundshëm

Gjendja ekzistuese e mjedisit në Komunën e Deçanit reflekton një ndërthurje të qartë ndërmjet potencialeve të larta natyrore dhe presioneve në rritje nga zhvillimi socio-ekonomik dhe urban. Pozita gjeografike, në kufi me zonat malore të Alpeve Shqiptare dhe brenda Parkut Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”, e bën këtë territor me rëndësi të veçantë ekologjike, por njëkohësisht kërkon menaxhim të kujdesshëm dhe të qëndrueshëm të resurseve. Gjendja aktuale mjedisore pasqyron ndikimet mbi komponentët kryesorë – tokën, ujin, ajrin dhe biodiversitetin të cilët janë prekur në shkallë të ndryshme nga aktivitetet njerëzore. Ndryshimet janë të dukshme në fondin pyjor, tokën bujqësore dhe hapësirat e gjelbëruara, ndërsa në disa zona evidentohet presion i shtuar për shkak të shfrytëzimit të pakontrolluar dhe zhvillimeve të pa planifikuara. Në aspektin e ujërave, ndikimet lidhen kryesisht me shkarkimet e ujërave të ndotura, të cilat cenojnë cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore. Paralelisht, në sektorin bujqësor, përdorimi i preparateve kimike ndikon në degradimin e tokës dhe në ekosistemet përreth. Të gjitha këto procese, të ndërthurura me zhvillimet në sektorë si ekonomia, industria e lehtë, energjetika, transporti dhe bujqësia, krijojnë një gjendje mjedisore dinamike, të karakterizuar nga balanca e brishtë ndërmjet zhvillimit dhe ruajtjes së burimeve natyrore.

3.4.1 Cilësia e ajrit

Cilësia e ajrit në Komunën e Deçanit paraqitet përgjithësisht në nivele të moderuara krahasuar me qytetet tjera të Kosovës, megjithëse mbetet e ndikuar nga burime të ndryshme ndotjeje dhe nga mungesa e një sistemi të avancuar lokal të monitorimit. Monitorimi i cilësisë së ajrit realizohet kryesisht përmes rrjetit të stacioneve të menaxhuara nga AMMK/IHMK, me stacion referues në Pejë dhe pika matëse në zonat urbane dhe përgjatë korridoreve kryesore të trafikut në Deçan. Burimet kryesore të ndotjes së ajrit lidhen me djegiet në ekonomitë familjare dhe sektorin e transportit. Emetimet e grimcave PM10 dhe PM2.5 burojnë kryesisht nga përdorimi i biomasës dhe lëndëve fosile për ngrohje, ndërsa emetimet e NOx lidhen me qarkullimin e automjeteve, veçanërisht përgjatë aksit Pejë–Deçan–Gjakovë. Vjetërsia e flotës së automjeteve, intensiteti i trafikut dhe mungesa e alternativave të qëndrueshme të mobilitetit kontribuojnë në rritjen e ndotjes atmosferike në zonën urbane. Burime shtesë të ndotjes janë edhe djegia e pakontrolluar e mbeturinave, aktivitetet e gurëthyesve, beton-asfalteve dhe bizneset me ndikim në mjedis. Megjithëse mungesa e industrisë së rëndë aktive pas luftës e redukton presionin industrial, faktorë të tjerë si mungesa e hapësirave të gjelbëruara, mungesa e ngrohjes qendrore dhe dominimi i burimeve difuze të ndotjes kufizojnë përmirësimin e cilësisë së ajrit. Ndotja e ajrit ndikon jo vetëm në atmosferë, por edhe në cilësinë e tokës dhe ujërave përmes depozitimit të grimcave ndotëse, me pasoja të drejtpërdrejta për shëndetin e popullsisë.

Tabela 8.- Emetimet në ajër -Deçan, 2021-2022

Parametri	Djegjet e vogla	Transporti rrugor	Industria	Bujqësia	Guroret	Pyjet	Total
PM 10	514.82	48.78	0	33.45	0,35	0	607.40
PM 2.5	511.19	21.85	0	5.73	0,03	0	538.81
Nox	46,59	168,49	0	66,83	0	0	281,90
SO ₂	16,67	0.08	0	0,04	0	0	16,79
CO ₂	2 832,69	84,75	0	4,97	0	0	2 922,41

Në aspektin strategjik, komuna ka përfshirë mbrojtjen e mjedisit si prioritet përmes konceptit “Deçani ekologjik”, duke synuar kontrollin e ndotjes dhe përmirësimin e kushteve mjedisore. Për më shumë kërkohet koordinim institucional për kontrollin e emetimeve nga trafiku, djegiet, gurëthyesit dhe aktivitetet ekonomike, si dhe vendosja e matësve të ndotjes në zonat me frekuencë të lartë të komunikacionit dhe pranë bizneseve me ndikim mjedisor. Gjithashtu, konsiderohet e nevojshme hartimi i Planit Lokal për Mbrojtjen e Ajrit dhe mobilitetit, krijimi i brezave të gjelbërimit përgjatë rrugëve, promovimi i mobilitetit të qëndrueshëm dhe përdorimi i formave më efikase të energjisë konsiderohen masa të rëndësishme për përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe rritjen e reziliencës klimatike të komunës shtu këtu edhe marrjen e masave ndëshkuese ndaj ndotësve që tejkalojnë normat e lejuara të ndotjes dhe zhurmës.

3.4.2 Faktorët klimatik

Klima e Komunës së Deçanit është kryesisht kontinentale me ndikime të theksuara mesdhetare dhe malore, të ngjashme me pjesën më të madhe të Rrafshit të Dukagjinit. Në formësimin e saj rol të rëndësishëm luan relievi, veçanërisht afërsia me Bjeshkët e Nemuna, që kushtëzon kushte më të ashpra klimatike dhe diferencime të dukshme ndërmjet zonave të ulëta dhe atyre malore. Viset e ulëta karakterizohen me temperatura mesatare vjetore mbi 11°C, me verëra të nxehta dhe relativisht të thata (korriku dhe gushti rreth 21–22°C) dhe dimra të ftohtë (janari rreth -0.5°C), ndërsa lagështia mesatare vjetore arrin rreth 70%.

Klima ndikohet nga qarkullimet atmosferike sezonale, ku gjatë verës dominojnë masat ajrore me presion të lartë nga zonat subtropikale, ndërsa gjatë dimrit ndikojnë anticiklonet kontinentale dhe aktiviteti ciklonik nga Atlantiku dhe Mesdheu. Reshjet janë ndër më të lartat në Kosovë, me rreth 724 mm në viset e ulëta dhe mbi 1300 mm në zonat malore, me kulm në pranverë dhe vjeshtë. Numri i orëve me diell është rreth 1900–1970 orë në vit, ndërsa vranësira mesatare është rreth 58%. Në zonat malore, trashësia e borës mund të arrijë deri mbi 1 m dhe të qëndrojë për periudha më të gjata, duke krijuar kushte të favorshme për aktivitete dimërore. Në tërësi, këto karakteristika klimatike ndikojnë ndjeshëm në regjimin hidrologjik, biodiversitetin dhe përdorimin e territorit në komunë.

3.4.3 Biodiversiteti, flora, fauna dhe peizazhi

Komuna e Deçanit karakterizohet nga një pasuri e konsiderueshme biologjike dhe një trashëgimi natyrore me vlera të larta, e formësuar nga ndërveprimi i faktorëve gjeografikë, gjeologjikë, klimatikë dhe relievit, veçanërisht në zonën e Bjeshkët e Nemuna. Ky territor përfaqëson një nga zonat më të rëndësishme të biodiversitetit në Kosovë, me një shumëllojshmëri të lartë speciejsh dhe ekosistemesh. Në aspektin e florës, janë identifikuar rreth 795 lloje bimësh, përfshirë specie endemike, subendemike dhe relikte, të cilat dëshmojnë për vlerat e larta ekologjike të këtij territori. Dominimin e kanë bimët barishtore shumëvjeçare (rreth 70%), ndërsa bimët drunore dhe shkurret përbëjnë një pjesë më të vogël (rreth 7%). Flora përfshin një spektër të gjerë grupesh si algat, likenet, kërpudhat, fiernat dhe bimët me farë, të cilat luajnë rol thelbësor në ruajtjen e ekuilibrave natyrorë dhe ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e ajrit, ujit dhe tokës. Njëkohësisht, rajoni është i pasur me bimë mjekësore dhe aromatike, si boronica, kamomili dhe specie të tjera të rëndësishme për përdorim tradicional dhe ekonomik.

Fauna e Deçanit është po ashtu e larmishme dhe përfshin një numër të madh speciejsh të rëndësishme, disa prej të cilave janë pjesë e Listës së Kuqe. Në këtë territor janë evidentuar 8 lloje peshqish, 13 lloje ujëtokësorësh, 12 lloje zvarranikësh, 154 lloje shpendësh, 37 lloje gjitarësh dhe 147 lloje fluturash ditore. Ndër gjitarët veçohen specie si ariu i murrmë, ndërsa nga fauna e shpendëve dallohen specie karakteristike malore dhe pyjore si fëllëza e gurëve, korbi dhe qyqja, që tregojnë për një habitat relativisht të ruajtur dhe funksional.

Peizazhi natyror i Deçanit karakterizohet nga kontrasti ndërmjet viseve të ulëta dhe zonave malore alpine, duke krijuar një mozaik ekosistemesh që mbështesin biodiversitetin e lartë. Ky diversitet peizazhor kontribuon jo vetëm në vlerat ekologjike, por edhe në potencialin për zhvillim të aktiviteteve rekreative dhe turizmit natyror.

Megjithatë, biodiversiteti përballet me një sërë presionesh, kryesisht nga prerjet dhe degradimi i pyjeve, mungesa e menaxhimit adekuat dhe investimeve në zonat e mbrojtura, si dhe niveli i ulët i vetëdijesimit të popullsisë dhe vizitorëve për rëndësinë e ruajtjes së këtyre vlerave. Këto sfida kufizojnë shfrytëzimin e qëndrueshëm të potencialit natyror dhe kërkojnë një qasje më të integruar në mbrojtjen dhe menaxhimin e biodiversitetit si një resurs me rëndësi ekologjike dhe ekonomike.

3.4.4 Aspekti arkitekturor dhe visual

Komuna e Deçanit karakterizohet nga një trashëgimi e pasur arkitekturore dhe peizazhore, e përbërë nga monumente të kategorive të ndryshme si kulla, shtëpi tradicionale, objekte fetare, mullinj dhe një numër i madh lokalitetesh arkeologjike të shpërndara në gjithë territorin (Belle, Pleqe, Glllogjan, Strellc, Rastavicë, Irzniq, Baballoq etj.). Kjo krijon një peizazh kulturor me vlera të larta historike dhe estetike.

Elementi më përfaqësues janë kullat tradicionale, të ndërtuara me gurë dhe të organizuara në disa kate, të cilat përfaqësojnë një tipologji autentike arkitekturore dhe një dëshmi të mënyrës tradicionale të jetesës. Së bashku me monumentet fetare dhe lokalitetet arkeologjike, ato kontribuojnë në identitetin vizual të veçantë të Deçanit. Ky identitet plotësohet edhe nga trashëgimia shpirtërore, si muzika, vallet dhe traditat, të cilat janë të lidhura ngushtë me këto hapësira.

Megjithatë, gjendja ekzistuese përballet me sfida si degradimi i monumenteve për shkak të mungesës së investimeve, mungesa e zonave të qarta mbrojtëse dhe ndërhyrjet e pakontrolluara në afërsi të tyre. Po ashtu, ndërtimet e reja shpesh nuk respektojnë arkitekturën autoktone dhe materialet tradicionale, duke krijuar mos-harmoni vizuale dhe duke dobësuar identitetin arkitekturor të zonës.

3.4.5 Toka

Struktura pedologjike e Komunës së Deçanit karakterizohet nga një larmi e konsiderueshme e llojeve të tokave, të cilat lidhen drejtpërdrejt me përbërjen gjeologjike, relievin dhe proceset hidrologjike të territorit. Në zonat e ultësirës dominojnë tokat aluviale të formuara nga depozitimet lumore përgjatë rrjedhave të Lumëbardhit të Deçanit dhe Lumëbardhit të Lloqanit. Këto toka karakterizohen nga pjellori e lartë dhe përbëjnë bazën kryesore të zhvillimit bujqësor në komunë. Krahas tyre, janë të përhapura edhe tokat pseudoglej me nivel më të lartë lagështie dhe kullim më të dobët, si dhe tokat e kuqërremta, të pasura me minerale dhe të përshtatshme për aktivitete bujqësore. Në zonat kodrinore dhe malore hasen tokat ranker dhe litosole, të cilat janë më të cekëta dhe me pjellori më të ulët, duke u lidhur kryesisht me kullota dhe sipërfaqe pyjore. Gjithashtu, janë të pranishme edhe tokat deluviale dhe tokat e livadheve, të krijuara nga transporti i materialeve nga shpatet, të rëndësishme për aktivitete bujqësore dhe blegtorale.

Në aspektin funksional, kjo strukturë pedologjike krijon një ndarje natyrore të përdorimit të territorit, ku ultësirat shfrytëzohen kryesisht për bujqësi intensive, ndërsa zonat kodrinore dhe malore për pylltari, kullota dhe ruajtje të ekosistemeve natyrore, veçanërisht brenda territorit të Parkut Kombëtar Bjeshkët e Nemuna. Territori i komunës shtrihet në rreth 293.94 km² dhe përfshin sipërfaqe të konsiderueshme bujqësore dhe pyjore, të cilat përfaqësojnë një potencial të rëndësishëm zhvillimor dhe ekologjik.

Tabela 9- Lloji i tokës

Nr.	Lloji I tokës	Sipërfaqja(ha)
1	Tokë pseudoglej	9,066.44
2	Tokë e kuqërremtë	5,590.00
3	Tokë aluviale	5,305.82
4	Tokë ranker	5,170.00
5	Tokë e murme në shtresa kompakte	2,160.20
6	Tokë e kuqe	678.79
7	Tokë deluviale	636.81
8	Tokë livadhe	632.58
9	Tokë litosole	156.38

Tabela 10 - Shfrytëzimi i tokës

Nr	Shfrytëzimi I tokës	Sip. (ha)
1	sipërfaqe e shfrytëzuar e tokës bujqësore	5504.53
2	tokë e punueshme /arë sipërfaqe	4302.07
3	kopshte	198.6
4	Livadhe	1873
5	tokë bujqësore e papërdorur	150.4
6	tokë pyjore ,Park kombëtar Bjeshket e Nemura	15995.4
7	Zona e vecantë e mbrojtur rreth manastirit të Deçanit	790.7
8	Tokë jo bujqësore	378.6
9	tokë e degraduar (depone, ndërtime)	200.75

Megjithatë, gjendja e tokës në komunë përballet me sfida të shumta që lidhen me degradimin gradual të fondit tokësor dhe mungesën e mekanizmave efektivë të monitorimit dhe menaxhimit. Në Komunën e Deçanit mungon një sistem i mirëfilltë për monitorimin e cilësisë së dheut, ndërsa edhe operatorët ekonomikë që potencialisht ndikojnë në ndotje apo degradim, nuk kryejnë monitorim të rregullt. Për këtë arsye, vlerësimi i gjendjes reale të tokës mbështetet kryesisht në të dhëna dytësore nga dokumentet planifikuese dhe institucionale.

Të dhënat ekzistuese tregojnë se degradimi i tokës lidhet kryesisht me zhvillimet e pa planifikuara dhe shfrytëzimin joracional të territorit. Ndërtimet përgjatë akseve rrugore kanë sjellë zvogëlim të sipërfaqeve bujqësore dhe gjelbërimit, duke kontribuar në humbjen graduale të fondit tokësor, e cila vlerësohet rreth 15–25 ha në vit. Gjithashtu, problematikë të theksuar paraqesin mbeturinat komunale dhe deponitë ilegale, ku janë identifikuar rreth 9 lokacione të tilla që kanë degraduar afërsisht 10.2 ha tokë bujqësore. Ndikime negative shkaktojnë edhe aktivitetet si grumbullimi i hekurishteve, varrezat e automjeteve dhe funksionimi i pakontrolluar i stacioneve të karburanteve.

Një tjetër problem i rëndësishëm lidhet me shfrytëzimin e pakontrolluar të burimeve natyrore. Prerja ilegale e pyjeve ka ndikuar në rritjen e proceseve erozive, veçanërisht në zonat kodrinore dhe malore, ndërsa nxjerrja e pakontrolluar e zhavorrit përgjatë lumenjve ka rritur ndjeshëm rrezikun nga përmytjet dhe destabilizimin e brigjeve lumore. Në sektorin bujqësor evidentohet përdorimi i plehrave kimike dhe pesticideve, megjithëse jo në nivele intensive që të shkaktojnë ndotje të theksuar, por që paraqesin potencial për degradim gradual të cilësisë së dheut në mungesë të praktikave të kontrolluara bujqësore.

Në tërësi, sistemi tokësor në Komunën e Deçanit karakterizohet nga potencial i lartë prodhues dhe ekologjik, por njëkohësisht mbetet i ndjeshëm ndaj degradimit për shkak të urbanizimit të

pakontrolluar, menaxhimit jo të qëndrueshëm të burimeve natyrore, mungesës së monitorimit institucional dhe zbatimit të pamjaftueshëm të legjislacionit për mbrojtjen e tokës. Këto zhvillime kërkojnë ndërhyrje të strukturuar në nivel planifikimi hapësinor, mbrojtjeje mjedisore dhe menaxhimi të qëndrueshëm të territorit.

3.4.6 Uji

Komuna e Deçanit posedon resurse të rëndësishme ujore, të cilat burojnë kryesisht nga Bjeshkët e Nemuna dhe derdhen në Drinin e Bardhë. Burimet kryesore ujore lidhen me rrjedhat e Lumëbardhit të Deçanit dhe Lumëbardhit të Lloqanit, si dhe me burimet natyrore Qafa e Gjipsit, Te Guri, Rrjeti i Goqit, Fusha e Firzit, Bele dhe Mrizet. Cilësia e ujit në burim konsiderohet e pastër, veçanërisht brenda territorit të Parkut Kombëtar, por përgjatë rrjedhës ndikohet nga shkarkimi i ujërave të zeza, mbeturinat dhe aktivitetet bujqësore.

Sistemi i furnizimit me ujë ka shtrirje të gjerë dhe sipas të dhënave komunale mbulon pothuajse të gjitha ekonomitë familjare, institucionet publike dhe bizneset. Furnizimi realizohet përmes disa sistemeve ujësjellëse, përfshirë sistemin e qytetit të Deçanit, sistemet e Isniqit, Strellcit, CDF-it dhe sistemin e 10 fshatrave që furnizohen nga "Gurrat e Hasan Agës". I gjithë sistemi funksionon me gravitet dhe përfshin gjashtë depo/rezervuarë, ndërsa të gjitha pikat janë të pajisura me klorinatorë. Megjithatë, rrjeti përballet me mungesë të të dhënave mbi kapacitetet furnizuese dhe humbjet në rrjet, si dhe me dëmtime infrastrukturore të shkaktuara nga reshjet atmosferike dhe gërryerjet.




Figura 5. Harta e rrjetit të Ujësjellësit

Në aspektin e ujitjes, shfrytëzohen lumenjtë dhe pusët natyrore, ndërsa zhvillimi i sistemit të ujitjes konsiderohet i rëndësishëm për rritjen e prodhimtarisë bujqësore. Parashihet rehabilitimi i kanaleve të ujitjes, ndërtimi i pendës akumuluese në Lumëbardhin e Lloqanit dhe zhvillimi i sistemit të ujitjes pikë-pikë, me qëllim rritjen e rendimenteve dhe përmirësimin e kushteve për sektorin bujqësor.

Cilësia e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore ndikohet kryesisht nga shkarkimi i ujërave të zeza, mungesa e kanalizimit në pjesën më të madhe të zonave rurale, përdorimi i plehrave dhe pesticideve, si dhe nga mbeturinat e ngurta.

Rrjeti i kanalizimit aktualisht mbulon vetëm një pjesë të territorit të komunës, kryesisht qytetin dhe disa fshatra, ndërsa zonat tjera vazhdojnë të përdorin gropa septike ose shkarkime të drejtpërdrejta në mjedis, duke rritur rrezikun për ndotjen e ujërave nëntokësore, sidomos në

zonat rurale që furnizohen me ujë nga puset. Komuna ende nuk posedon sistem funksional për trajtimin e ujërave të ndotura, megjithëse planifikohet ndërtimi i impianteve për trajtimin e ujërave të zeza në afërsi të Lumëbardhit dhe fshatit Gramaqel.

Gjendja e Lumëbardhit të Deçanit dhe Lumëbardhit të Lloqanit paraqitet relativisht stabile sa i përket mbeturinave, por përgjatë rrjedhës së tyre evidentohen probleme të vazhdueshme të erozionit dhe vërshimeve, të cilat shkaktojnë degradim të tokave bujqësore dhe rrezik për infrastrukturën, veçanërisht në zonat e Rastavicës, Baballoqit dhe Gramaqelit. Ndryshimet në rrjedhat e lumenjve, eksploatimi i zhavorrit dhe përdorimi i ujit për hidrocentrale ndikojnë gjithashtu në disponueshmërinë dhe cilësinë e burimeve ujore.

Mund të konstatohet se komuna ka potencial të lartë ujore falë burimeve nga Bjeshkët e Nemuna, por mungojnë të dhënat e sakta teknike mbi kapacitetin furnizues, rezervat operative dhe humbjet në rrjet, gjë që paraqet një sfidë për menaxhimin afatgjatë të resurseve ujore.




Figura 6. Harta e Rrjeti i kanalizimit

3.4.7. Trashëgimia kulturore

Gjendja ekzistuese e trashëgimisë kulturore në Komunën e Deçanit karakterizohet nga një pasuri e konsiderueshme dhe një vazhdimësi e thellë historike, që dëshkohet nga prania e lokaliteteve arkeologjike, objekteve fetare, kullave tradicionale dhe elementeve të arkitekturës folklorike të shpërndara në të gjithë territorin. Gjetjet arkeologjike në zona si Kërshi i Qelisë, Muret e Kalasë në Belle dhe tumat ilire në Carrabreg, së bashku me monumentet në fshatra si Belegu, Lëbushë, Prapaqan, Lumbardh dhe Irzniq, konfirmojnë rëndësinë historike të këtij territori. Një vlerë e veçantë është Manastiri i Deçanit, si monument i mbrojtur ndërkombëtarisht, që përfaqëson një nga asetet më të rëndësishme kulturore të komunës. Po ashtu, komplekset e kullave në Isnig dhe Drenoc, si dhe kullat individuale të ndërtuara kryesisht në fund të shek. XIX, përbëjnë një tipologji të veçantë të trashëgimisë së ndërtuar, që reflekton organizimin social dhe mënyrën tradicionale të jetesës.

Përveç dimensionit material, trashëgimia përfshin edhe vlera jomateriale që lidhen me traditat, praktikatat sociale dhe identitetin lokal, duke e bërë atë një komponent kyç të strukturës kulturore dhe

potencial të rëndësishëm për zhvillim të qëndrueshëm, veçanërisht në funksion të turizmit kulturor. Ekziston Lista e gjatë trashëgimisë kulturore për mbrojtje të përkohshme të aprovuar dhe publikuar nga Ministria për Kulturë Rini dhe Sport për vitin 2018 e paraqitur në tabelën vijuese në formë të kategorive të trashëgimisë.

Tabela 11 - Lista e kategorive të trashëgimisë kulturore

Kategoritë	Numri	Sipërfaqja ha
Trashëgimia Arkitekturore	64	9.8702
Trashëgimia arkeologjike	10	0
Peisazhet kulturore	3	0
Zonat e vecanta të mbrojtura	1	839,6
Gjithsejt	78	849,4702

Megjithatë, gjendja aktuale paraqet një sërë sfidash strukturore. Një pjesë e konsiderueshme e aseteve është në gjendje degradimi për shkak të mungesës së mirëmbajtjes sistematike, ndërhyrjeve të pakontrolluara, mbindërtimit dhe ndryshimeve të destinimit, si dhe dëmtimit të mjedisit përreth. Në zonat rurale evidentohet braktisja graduale e kullave dhe strukturave tradicionale, ndërsa në zonat urbane presioni nga zhvillimet e reja rrezikon integritetin dhe autenticitetin e trashëgimisë.

Gjendja është ndikuar edhe nga faktorë historikë dhe politikë, ku trashëgimia kulturore ka pësuar dëmtime të konsiderueshme si nga faktorët natyrorë ashtu edhe nga shkatërrimet e qëllimshme. Veçanërisht gjatë konfliktit të viteve 1998–1999 janë dëmtuar dhe shkatërruar një numër i madh objektivësh, duke fragmentuar strukturat tradicionale dhe duke reduktuar vlerën e tyre tërësore. Po ashtu, në shumë raste ndërhyrjet në të kaluarën janë realizuar pa konsideruar vlerat kulturore, duke çuar në humbje të pjesshme të identitetit hapësinor.

Në këtë kontekst, sfidat kryesore lidhen me mungesën e mekanizmave efektivë të mbrojtjes dhe menaxhimit, mungesën e projekteve konkrete për restaurim dhe konservim, si dhe me nevojën për integrimin e trashëgimisë kulturore në proceset e planifikimit hapësinor, në mënyrë që të ruhet autenticiteti dhe të shfrytëzohet potenciali i saj zhvillimor.

3.4.8 Mbeturinat

Menaxhimi i mbeturinave në Komunën e Deçanit realizohet nga Ndërmarrja Publike Lokale “Higjiena”, e cila është përgjegjëse për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave komunale përmes sistemit “derë më derë” dhe rrjetit të kontejnerëve publikë. Megjithëse në vitet e fundit janë shënuar përmirësime në organizimin e shërbimit, mbulueshmëria mbetet e pabarabartë, me përqendrim më të madh në zonën urbane dhe me nivel më të ulët të shërbimit në vendbanimet rurale. Në disa lokalitete rurale shërbimi është i kufizuar ose mungon plotësisht, gjë që ndikon drejtpërdrejt në krijimin e deponive ilegale dhe ndotjen e mjedisit.

Gjendja aktuale e sistemit të menaxhimit të mbeturinave vazhdon të karakterizohet nga mungesa e një sistemi të zhvilluar për ndarjen, riciklimin dhe trajtimin e mbeturinave. Aktualisht, mbeturinat grumbullohen në mënyrë të përzier dhe transportohen drejt deponisë rajonale, ndërsa aktivitetet e riciklimit zhvillohen kryesisht nga operatorë informalë. Edhe pse një pjesë e konsiderueshme e mbeturinave ka potencial për riciklim dhe kompostim, këto procese mbeten ende të pazhvilluara në nivel institucional. Po ashtu, mungon infrastruktura e nevojshme për trajtimin e mbeturinave të veçanta, si mbeturinat medicinale, elektronike, shtazore, si dhe mbeturinat nga ndërtimi dhe demolimi.

Një sfidë e rëndësishme mbetet prania e deponive ilegale. Megjithëse numri i tyre është zvogëluar ndjeshëm krahasuar me vitet e kaluara, ato vazhdojnë të paraqesin problem mjedisor, veçanërisht në zonat që nuk mbulohen rregullisht me shërbim. Hedhja e pakontrolluar e mbeturinave në hapësira publike, brigje lumenjsh dhe toka bujqësore shkakton ndotje të tokës dhe ujërave sipërfaqësore, si dhe degradim të peizazhit natyror.

Tabela 12- Deponit ilegale komunale nder vite¹

Komuna	Numri I deponive ilegale			
	2017	2019	2021	2024*
Pejë	19	73	21	21
Istog	22	22	16	16
Klinë	9	46	31	19
Deçan	31	21	2	8
Junik	22	0	0	0
Total	103	162	70	64

Të dhënat tregojnë se në Komunën e Deçanit numri i deponive ilegale është reduktuar ndjeshëm gjatë periudhës 2017–2021, megjithëse në vitin 2024 evidentohet një rritje e lehtë. Kjo tregon se, përkundër progresit të arritur, nevojiten masa të vazhdueshme për eliminimin e plotë të deponive ilegale dhe zgjerimin e mbulimit të shërbimit në të gjithë territorin komunal

Tabela 13-.Numri i ekonomive familjare dhe projeksioni i mbeturinave të gjeneruara

Komuna	Numri I banorëve	Numri ekonomive familjare *	Shkalla e urbanizimit* %	Parashikimi I sasisë së mbeturinave /ek.familjare/t**				
				Viti bazë	Parashikimi			
					2023	2024	2030	2035
Deçan	27 775	5,909	<20%	7,115	7,169	7,170	7,091	6,959
Istog	33 008	7,591	>20-38.3	11,569	11,656	11,658	11,530	11,316
Junik	3 943	895	<20%	860	866	867	857	841
Klinë	30 503	6,753	>20-38.3	7,738	7,796	7,798	7,712	7,569
Pejë	82 745	19,639	>50	37,300	37,581	37,588	37,174	36,484
Total	177,974	40,787		6,455	65,068	65,080	64,364	63,170

Sipas Planit të Menaxhimit të Integruar të Mbeturinave për Rajonin e Dukagjinit, sasi të mbeturinave të gjeneruara në komunë pritet të mbeten relativisht stabile deri në vitin 2040, me tendencë të lehtë rënieje si rezultat i masave për reduktimin, riciklimin dhe kompostimin e mbeturinave.

Në aspektin institucional dhe financiar, menaxhimi i mbeturinave përballet me kufizime në kapacitetet teknike dhe organizative të ndërmarrjes publike, nivel të ulët investimesh dhe nevojë për përmirësimin e mekanizmave të inkasimit dhe qëndrueshmërisë financiare të sistemit. Po ashtu, niveli i ulët i ndërgjegjësimit të qytetarëve dhe mungesa e praktikave të ndarjes së mbeturinave në burim ndikojnë negativisht në efikasitetin e menaxhimit të tyre.

Në kuadër të Planit të Menaxhimit të Integruar të Mbeturinave për Rajonin e Dukagjinit, Komuna e Deçanit ka obligime të qarta për zhvillimin e sistemit modern të menaxhimit të mbeturinave. Këto

¹ PNMIM per Rajonin e Dugagjinit

përfshijnë krijimin e sistemeve për grumbullimin e ndarë të mbeturinave të riciklueshme, ngritjen e oborreve të riciklimit, funksionalizimin e stacioneve të transferimit, zhvillimin e kompostimit të mbeturinave të gjelbra, organizimin e pikave për pranimin e mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi, si dhe zbatimin e skemave të Përgjegjësisë së Zgjieruar të Prodhuesit për mbeturinat elektrike dhe elektronike, bateritë, vajrat e përdorura, gomat dhe automjetet jashtë përdorimit. Gjithashtu, kërkohet organizimi i fushatave të vazhdueshme të edukimit dhe ndërgjegjësimit publik për të rritur pjesëmarrjen e qytetarëve në programet e riciklimit dhe kompostimit.




Figura 7. Vendndodhja e objekteve të trashëguara për menaxhimin e mbeturinave në ZMM²

Në përgjithësi, sektori i menaxhimit të mbeturinave në Komunën e Deçanit ka shënuar progres në reduktimin e deponive ilegale dhe organizimin e shërbimeve bazë, por vazhdon të përballë me sfida të rëndësishme që lidhen me mbulueshmërinë territoriale, riciklimin, trajtimin e mbeturinave të veçanta dhe forcimin e kapaciteteve institucionale. Përmbushja e objektivave të përcaktuara në Planin e Menaxhimit të Integruar të Mbeturinave do të jetë thelbësore për kalimin drejt një sistemi më të qëndrueshëm dhe më efikas të menaxhimit të mbeturinave në komunë. Së fundmi HZK përcakton disa norma për ndërtimin e deponive të mbeturinave. Këto propozime kanë të bëjnë me përmbajtjen e Komunës së Deçanit sa i përket zonës së mbrojtur, zonës arkeologjike, shpërndarjes së vendbanimeve, zonave kulturore etj.

Tabela 14 . Normativat e ndërtimit të deponive të mbeturinave

Lejohet	Nuk lejohet
<p>Afër zonave të banimit urbane dhe rurale largësia minimale e ndërtimit të deponive të mbeturinave nuk lejohet të jetë më e vogël se 1 km.</p> <p>Në rast të zonave rurale ku vendbanimi është i shpërndarë atëherë lejohet të ndërtohet deponia e mbeturinave deri minimum 1 km nga shtëpia e fundit në perimetrin e depos.</p> <p>Në këtë rast duhet të analizohet mirë lëvizja e erërave, topografia e terrenit etj. në mënyrë që mos ta cenon jetesën e banorëve.</p>	<p>Në asnjë rrethanë nuk lejohet të ndërtohen deponitë e mbeturinave afër shkollave apo spitaleve edhe në qoftë se është perimetri maksimal 500 m.</p>

² PNMIM per rajonin e Dugagjinit)

N/A	Në parqe kombëtare, rezervate natyrore ose zona me biodiversitet të lartë.
Të krijohet qasje e lehtë e mjeteve transportuese të mbeturinave deri në deponi	Lëvizjes se mjeteve të transportit të cilat nuk e cenojnë natyrën, biodiversitetin dhe lagjet e banuara.
Të analizohet detalisht lëvizja e erërave	Nuk lejohet të vendosen deponitë në pikat ku lëvizja e erërave është drejt vendbanimeve urbane dhe rurale.
Lejohet ndërtimi i deponive në tokat bujqësore te kualiteti 5 deri 8	Nuk lejohet ndërtimi i deponive në tokat e nivelit nga 1 deri 4.

3.4.9 Zhurma

Gjendja e ndotjes nga zhurma në Komunën e Deçanit paraqet një shqetësim të vazhdueshëm, i cili lidhet ngushtë me shpërndarjen hapësinore të aktiviteteve dhe mungesën e një sistemi të strukturuar për menaxhim. Aktualisht, komuna nuk disponon Plan të Veprimit dhe Hartë të Zhurmës, as pajisje profesionale për matjen dhe monitorimin e vazhdueshëm të niveleve të zhurmës, pavarësisht obligimeve që dalin nga Ligji për Mbrojtje nga Zhurma Nr.02/L-102 . Kjo situatë e kufizon vlerësimin e saktë të ekspozimit akustik dhe planifikimin e ndërhyrjeve efektive. Nivelet e zhurmës ndryshojnë sipas zonave, duke qenë më të larta në qendrën urbane dhe përgjatë aksit kryesor rrugor R107, i cili përbën burimin kryesor të ndotjes akustike. Matjet orientuese tregojnë se në orët e pikut, niveli i zhurmës në qendër arrin deri në 76.8 dB, rreth 16.8 dB mbi normën e lejuar prej 60 dB, ndërsa përgjatë R107 tejkalimi arrin deri në 25% mbi kufijtë ditorë. Edhe në mbrëmje, nivelet përgjatë këtij aksi mbeten mbi normën e lejuar (rreth 54.2 dB). Ndërsa zonat rezidenciale periferike paraqesin nivele më të ulëta (rreth 42 dB), megjithatë ndikimi i trafikut mbetet i pranishëm.

Shkaktari dominues i zhurmës është komunikacioni rrugor, i përforcuar nga mungesa e elementeve amortizuese si brezat e gjelbër, materialet akustike dhe zgjidhjet teknike në infrastrukturë. Si rezultat, rruga R107 funksionon si një korridor me presion të lartë akustik që ndikon në cilësinë e jetesës dhe krijon një fragmentim funksional të hapësirës urbane.

Pasojat e ndotjes nga zhurma reflektohen në uljen e cilësisë së jetesës dhe ndikimet në shëndetin e popullatës, veçanërisht në aspektin e stresit dhe shëndetit mendor, siç theksohet edhe nga organizatat ndërkombëtare shëndetësore. Edhe pse perceptimi lokal nuk e konsideron gjithmonë si problem kritik, ekspozimi i vazhdueshëm ndaj niveleve të larta përbën rrezik afatgjatë.

Në këtë kontekst, sfidat kryesore lidhen me mungesën e monitorimit sistematik, mungesën e dokumenteve strategjike (Plani i Veprimit dhe Harta e Zhurmës) dhe mungesën e masave konkrete për zbutjen e zhurmës në zonat më të ekspozuara. Krijimi i një sistemi të integruar monitorimi dhe planifikimi, që do të mundësojë identifikimin e zonave kritike dhe ndërmarrjen e masave për reduktimin e ndotjes akustike dhe përmirësimin e cilësisë së jetesës në komunë mbetet i domosdoshëm.

3.4.10 Faktorët socio-ekonomik

Struktura socio-ekonomike e Komunës së Deçanit reflekton një kombinim të potencialeve zhvillimore dhe sfidave të theksuara sociale. Komuna ka 27,775 banorë dhe 5,909 ekonomi familjare, me një shkallë të ulët urbanizimi (<20%) (ASK, 2024), çka tregon një karakter dominues rural dhe varësi të lartë nga sektori bujqësor.

Bujqësia mbetet baza kryesore ekonomike, duke shfrytëzuar 38% të territorit dhe duke siguruar të ardhura për mbi 65% të popullsisë, ndërsa prodhimi mbetet kryesisht tradicional dhe me vlerë të shtuar të ulët.

Blegtoaria mbulon rreth 60% të nevojave lokale, por përpunimi realizohet kryesisht në nivel familjar. Paralelisht, në komunë operojnë 2,212 biznese aktive, kryesisht mikro-ndërmarrje në tregti dhe shërbime, ndërsa sektori industrial mbetet i dobët dhe me kapacitete të kufizuara.

Turizmi paraqet një sektor me potencial, me 15 hotele, 48 restorante dhe 5 agjenci turistike, por ende i pazhvilluar plotësisht.

Tregu i punës paraqet një ndër sfidat kryesore ekonomike. Shkalla e punësimit në nivel vendi është 29.8%, me ndarje sektoriale sipas gjinisë: gratë të përqendruara në arsim, shëndetësi dhe tregti (48.4%), ndërsa meshkujt në ndërtimtari, tregti dhe prodhim. Papunësia mbetet e lartë (30.5% në nivel vendi), ndërsa në nivel komunal mungojnë të dhëna të sakta; në vitin 2018 janë regjistruar 1,986 punëkërkues, kryesisht meshkuj (~70%), duke sugjeruar një nivel real më të lartë për shkak të informalitetit në tregun e punës. Kjo strukturë tregon një treg pune të segmentuar dhe me mundësi të kufizuara për diversifikim ekonomik.

Nga aspekti i mirëqenies sociale, rreth 3–4% e popullsisë (311 ekonomi familjare, 1,213 persona) janë të përfshirë në asistencë sociale, ndërsa 616 persona përfitojnë nga skemat për familjet e dëshmorëve dhe invalidëve të luftës, duke reflektuar praninë e grupeve të cenushme dhe varësi nga mbështetja institucionale. Në të njëjtën kohë, mbi 30% e popullsisë vlerësohet të jetojë në kushte varfërie. Struktura e shpenzimeve familjare tregon gjithashtu kufizime në mirëqenie, ku vetëm rreth 3% e konsumit dedikohet për shëndetësi, duke reflektuar qasje të kufizuara në shërbime dhe prioritet të ulët të këtij sektori.

Në këtë kontekst, ekonomia e Deçanit mbetet e brishtë dhe e varur nga sektorë tradicionalë, ndërsa papunësia, varfëria dhe mungesa e diversifikimit ekonomik krijojnë presion të vazhdueshëm social dhe ekonomik. Megjithatë, potencialet në bujqësi dhe turizëm, të mbështetura nga resurset natyrore dhe Parku Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”, përfaqësojnë baza të rëndësishme për zhvillim të qëndrueshëm dhe për përmirësimin e kushteve socio-ekonomike në të ardhmen.

3.5 Analizë e problemeve dhe mundësive të aspekteve mjedisore

Tabela 15 - Analiza e problemeve dhe mundësive mjedisore në Komunën e Deçanit

Komponenti mjedisor	Problemet kryesore	Mundësitë / potencialet
Ajri dhe klima	<ul style="list-style-type: none"> • Ndotja nga djegiet në ekonomitë familjare dhe përdorimi i lëndëve fosile për ngrohje. • Ndotja nga trafiku dhe vjetërsia e flotës së automjeteve. • Djegia e pakontrolluar e mbeturinave dhe aktivitetet industriale me ndikim lokal. • Mungesa e monitorimit të avancuar lokal të cilësisë së ajrit. • Mungesa e hapësirave të gjelbëruara dhe sistemeve alternative të ngrohjes. 	<ul style="list-style-type: none"> • Hartimi i Planit Lokal për Mbrojtjen e Ajrit dhe mobilitetit të qëndrueshëm. • Vendosja e sistemit lokal të monitorimit të ndotjes së ajrit. • Krijimi i brezave të gjelbërimit përgjatë korridoreve rrugore dhe zonave urbane krijojnë potencial për përmirësim gradual të cilësisë së ajrit dhe mikroklimës urbane. • Promovimi i sistemeve alternative dhe më efikase të ngrohjes. • Forcimi i kontrollit institucional dhe zbatimit të masave kundër ndotjes.
Uji	<ul style="list-style-type: none"> • Shkarkimi i ujërave të zeza dhe mungesa e trajtimit të tyre. • Mbulim i pamjaftueshëm i rrjetit të kanalizimit në zonat rurale. • Ndotja e ujërave nga mbeturinat, pesticidet dhe aktivitetet bujqësore. • Erozioni dhe vërshimet përgjatë Lumëbardhit të Deçanit dhe Lumëbardhit të Lloqanit. • Humbjet dhe dëmtimet në rrjetin e ujësjellësit. 	<ul style="list-style-type: none"> • Ndërtimi i impianteve për trajtimin e ujërave të zeza. • Rehabilitimi dhe zgjerimi i rrjetit të kanalizimit dhe ujësjellësit. • Ndërtimi i pendëve akumuluese dhe zhvillimi i sistemit modern të ujitjes. • Mbrojtja dhe rehabilitimi i brigjeve lumore nga erozioni. • Përmirësimi i menaxhimit të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore.

	<ul style="list-style-type: none"> • Presioni mbi burimet ujore nga eksploatimi i zhavorrit dhe hidrocentralet. 	<ul style="list-style-type: none"> • Shfrytëzimi i potencialit të lartë të burimeve ujore për zhvillim të qëndrueshëm.
Toka (dheu)	<ul style="list-style-type: none"> • Mungesa e sistemit të monitorimit të cilësisë së dheut dhe kontrollit institucional. • Humbja graduale e tokës bujqësore nga ndërtimet e pa planifikuara dhe urbanizimi linear përgjatë rrugëve. • Degradimi i tokës nga deponitë ilegale, mbeturinat komunale dhe aktivitetet ekonomike të pakontrolluara. • Prerja ilegale e pyjeve dhe nxjerrja e pakontrolluar e zhavorrit, të cilat nxisin erozionin dhe rrezikun nga përmbytjet. • Shfrytëzimi joracional i tokës dhe mungesa e strategjive të qëndrueshme të menaxhimit territorial. • Potenciali për degradim gradual të cilësisë së tokës nga përdorimi i plehrave kimike dhe pesticideve. 	<ul style="list-style-type: none"> • Potencial i lartë bujqësor falë pranisë së tokave aluviale pjellore në ultësira. • Zhvillimi i praktikave të qëndrueshme bujqësore dhe menaxhimit të integruar të tokës. • Rehabilitimi i zonave të degraduara dhe rikthimi i tyre në përdorim funksional. • Forcimi i mbrojtjes së pyjeve dhe brigjeve lumore përmes masave kundër erozionit dhe përmbytjeve. • Integrimi i mbrojtjes së tokës në HZK dhe dokumentet sektoriale të planifikimit. • Potencial për ruajtjen dhe valorizimin e ekosistemeve natyrore dhe pyjore në kuadër të Parkut Kombëtar Bjeshkët e Nemuna
Zhurma	<ul style="list-style-type: none"> • Mungesa e Planit të Veprimit dhe Hartës së Zhurmës në përputhje me Ligjin Nr. 02/L-102. • Mungesa e pajisjeve dhe sistemit të vazhdueshëm për monitorimin e zhurmës. • Nivele të larta të zhurmës në qendrën urbane dhe përgjatë aksit rrugor R107. • Dominimi i trafikut rrugor si burim kryesor i ndotjes akustike. • Mungesa e brezave të gjelbër, barrierave akustike dhe zgjidhjeve teknike për amortizimin e zhurmës. • Ndikimi negativ në cilësinë e jetesës dhe shëndetin e popullsisë, veçanërisht stresin dhe mirëqenien mendore. • Fragmentimi funksional i hapësirës urbane përgjatë korridoreve me presion të lartë akustik. 	<ul style="list-style-type: none"> • Hartimi i Planit Lokal të Veprimit dhe Hartës së Zhurmës për komunën. • Vendosja e sistemit të monitorimit dhe matjes së vazhdueshme të zhurmës. • Krijimi i brezave të gjelbër dhe barrierave akustike përgjatë rrugëve kryesore. • Përmirësimi i infrastrukturës rrugore me materiale dhe zgjidhje teknike që reduktojnë zhurmën. • Menaxhimi më i mirë i trafikut dhe promovimi i mobilitetit të qëndrueshëm. • Integrimi i masave për mbrojtje akustike në planifikimin urban dhe transportues. • Rritja e vetëdijesimit institucional dhe qytetar për ndikimet e ndotjes akustike.

<p>Biodiversiteti, flora, fauna dhe peizazhi</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Prerja dhe degradimi i pyjeve, veçanërisht në zonat malore dhe të mbrojtura. • Mungesa e menaxhimit adekuat dhe investimeve në zonat me vlera të larta natyrore. • Presioni mbi habitatet natyrore dhe fragmentimi i ekosistemeve. • Niveli i ulët i vetëdijesimit për mbrojtjen e biodiversitetit dhe peizazhit. • Rrezikimi i specieve të rëndësishme dhe habitateve të ndjeshme. • Shfrytëzimi jo i qëndrueshëm i resurseve natyrore dhe pyjore 	<ul style="list-style-type: none"> • Mbrojtja dhe menaxhimi i integruar i zonës së Bjeshtë e Nemuna si zonë me vlera të larta biodiversiteti. • Zhvillimi i ekoturizmit dhe turizmit natyror. • Valorizimi i bimëve mjekësore dhe aromatike për zhvillim ekonomik lokal. • Forcimi i masave për mbrojtjen e habitateve dhe specieve të rralla. • Rritja e investimeve në ruajtjen dhe rehabilitimin e peizazhit natyror. • Edukimi dhe vetëdijesimi i komunitetit për rëndësinë e biodiversitetit. • Zhvillimi i aktiviteteve rekreative dhe kërkimore në natyrë.
<p>Trashëgimia kulturore dhe aspekti vizual</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Degradimi i monumenteve nga mungesa e mirëmbajtjes, ndërhyrjet e pakontrolluara dhe mosrespektimi i arkitekturës tradicionale po dëmtojnë identitetin vizual dhe kulturor . 	<ul style="list-style-type: none"> • Restaurimi dhe integrimi i trashëgimisë në zhvillimin turistik dhe urban mund të forcojnë identitetin lokal dhe të krijojnë vlerë ekonomike.
<p>Mbeturinat</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Mbulim i pabarabartë i shërbimit të grumbullimit të mbeturinave, veçanërisht në zonat rurale. • Mungesa e sistemit të organizuar për ndarjen, riciklimin dhe kompostimin e mbeturinave. • Mungesa e infrastrukturës për trajtimin e mbeturinave të veçanta (medicinale, elektronike, shtazore, ndërtimore etj.). • Prania e deponive ilegale dhe hedhja e pakontrolluar e mbeturinave në hapësira publike, lumenj dhe toka bujqësore. • Kapacitete të kufizuara teknike, financiare dhe organizative të sistemit të menaxhimit. • Nivel i ulët i ndërgjegjësimit qytetar për ndarjen në burim dhe riciklimin. • Varësi nga deponimi rajonal dhe mungesa e trajtimit lokal të mbeturinave. 	<ul style="list-style-type: none"> • Zhvillimi i sistemit të grumbullimit të ndarë dhe riciklimit të mbeturinave. • Krijimi i oborreve të riciklimit dhe stacioneve të transferimit. • Zhvillimi i kompostimit të decentralizuar dhe kompostimit shtëpiak në zonat rurale. • Krijimi i pikave për menaxhimin e mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi. • Zbatimi i skemave të Përgjegjësisë së Zgjeruar të Prodhuarit (PZP). • Rritja e mbulueshmërisë së shërbimit dhe modernizimi i sistemit të menaxhimit. • Edukimi dhe ndërgjegjësimi i qytetarëve për praktika të qëndrueshme të menaxhimit të mbeturinave.
<p>Faktoret socio-ekonomik</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Varësi e lartë nga bujqësia tradicionale dhe mungesë e diversifikimit ekonomik • Papunësi e lartë, treg pune i brishtë dhe informalitet ekonomik; • Nivel i lartë i varfërisë dhe varësi nga asistenca sociale. • Sektor turistik dhe industrial ende i pazhvilluar plotësisht 	<ul style="list-style-type: none"> • Modernizimi i bujqësisë dhe zhvillimi i agro-përpunimit me vlerë të shtuar • Krijimi i vendeve të reja të punës përmes zhvillimit të sektorit privat, turizmit dhe shërbimeve; • Përmirësimi i mirëqenies sociale përmes zhvillimit ekonomik lokal dhe investimeve në kapital njerëzor • Zhvillimi i turizmit malor dhe ekologjik bazuar në resurset natyrore dhe Parku Kombëtar “Bjeshtë e Nemuna”

3.6. Objektivat e VSM-së

Tabela 16 - Objektivat e VSM-së

Faktori mjedisor	Kodi i objektivit	Objektivi i VSM-së
A: Cilësia e dheut dhe shfrytëzimi i tokës	A01 A02	Parandalimi i degradimit të tokës. Mbrojtja e tokave pjellore
B: Cilësia e ujërave	BO1 BO2	Ruajtja e pastërtisë së ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore. Përdorim racional i burimeve ujore për të shmangur mbipërdorimin dhe ruajtjen e ekuilibrit hidrologjik
C: Cilësia e ajrit	CO1	Zvogëlimi i emisioneve nga ndërtimet, transporti dhe lëndët djegëse për ngrohje
D: Zhurma dhe vibrimi	DO1	Reduktimi i niveleve të zhurmës
E: Biodiversiteti dhe zonat natyrore të mbrojtura	EO1 EO2	Ruajtja e habitateve natyrore dhe specieve të rrezikuara. Menaxhim i qëndrueshëm i zonave të mbrojtura.
F: Faktorët e ndryshimeve klimatike	FO1 FO2 FO3	Ulja e emisioneve të gazrave serë. Rritja e sipërfaqeve të gjelbra dhe pyllëzimi. Përshtatja ndaj efekteve të rreziqeve nga ndryshimet klimatike.
G: Mirëqenia e popullsisë dhe ekonomia lokale	GO1 GO2	Sigurimi i zhvillimit ekonomik lokal të qëndrueshëm. Krijimi i vendeve të punës pa dëmtuar mjedisin.
H. Shëndeti publik	HO1	Ulja e ekspozimit ndaj ndikimeve mbi shëndetin e popullsisë.
I: Trashëgimia kulturore	IO1	Ruajtja e monumenteve dhe zonave historike.
J: Peizazhi dhe vlerat vizuale estetike	JO1	Ruajtja e peizazheve natyrore dhe panoramave kulturore.
K: Menaxhimi i mbeturinave	KO1 KO2	Reduktimi i të gjitha llojeve të mbeturinave Trajtim i sigurt i mbeturinave të rrezikshme
L: Trafiku dhe transporti	LO1 LO2	Ulja e trafikut privat për të reduktuar ndotjen. Promovimi i transportit publik dhe alternativave të transportit të pa-motorizuar.

IV. VLERËSIMI I PËRPUTHSHMËRISË SË ZHVILLIMEVE TË ZONAVE TË PËRCAKTUARA ME HZK-së me OBJEKTIVAT E VSM-së

4.1. Metodologjia e vlerësimit

Në realizimin e vlerësimit të draftit të HZK-së në raport me objektivat e VSM-së, është marrë parasysh:

- Informacioni bazë, përfshirë problemet ekzistuese mjedisore dhe rritja e tyre në komunën e Decanit
- Aktivitetet e mundshme dhe burimet e potenciale të efekteve që lidhen me zbatimin e HZK-së;
- Kuadri ligjor i Kosovës, veçanërisht Ligji Nr. 03/L-230 për Vlerësimin Strategjik Mjedisor dhe shtojcat e tij (Shtojca 1: Kriteret për përcaktimin e rëndësisë së efekteve të mundhme në mjedis dhe Shtojca 2: Informacioni që duhet të sigurohet në raportet e VSM-së).

Efektet janë përshkruar (kur është e mundur) në terma të shkallës së tyre gjeografike, periudhës kohore gjatë së cilës mund të ndodhin, nëse efektet do të jenë të përkohshme apo të përhershme, pozitive apo negative, të mundshme apo të pamundura, të shpeshta apo të rralla.

Tabela 17 : Kriteret për vlerësim

Efekti		Përshkrimi
++	Pozitiv i rëndësishëm	HZK-ja ka të ngjarë të ketë një ndikim pozitiv të konsiderueshëm mbi qëllimet e VSM-së.
+	Pozitiv	HZK-ja ka të ngjarë të ketë një efekt të vogël pozitiv në objektivat e VSM-së.
0	Neutral	HZK-ja M ka të ngjarë të ketë një efekt neutral në objektivat e VSM-së.
-	Negativ	HZK-ja ka të ngjarë të ketë një efekt të vogël negativ në objektivat e VSM-së.
--	Negativ i rëndësishëm	HZK-ja ka të ngjarë të ketë një efekt negativ të rëndësishëm në objektivat e VSM-së.
?	I pasigurt	Efektet e PNKMIM-it në objektivat e VSM janë të pasigurta në këtë fazë.

4.2. Vlerësimi i përputhshmërisë së zhvillimeve të parapara në kuadër të HZK-së dhe efekteve të tyre me objektivat e VSM-së

HZK-ja si instrument rregullativ I planifikimit hapësinor, prezantohet përmes këtyre zonave zhvillimore të cilat mund të përmbliken në këto kategori: a) Zona funksionale (banimi, shfrytëzim i përzier, industriale, komerciale, komunikacion–transport, shërbime), zona bujqësore, pyjore, sipërfaqe ujore, zonë e mbrojtur, zonë e mbrojtur arkeologjike–historike si dhe zona mbishtresore (Zonë sizmike, vërshimeve, akuiferëve, pasurive minerare, zonë me rrëshqitje të dheut dhe me erosion).

4.2.1. Faktori mjedisor A: Cilësia e dheut dhe shfrytëzimi i tokës

Analizon gjendjen e tokës, pjellorinë, erozionin dhe ndikimet nga përdorimi bujqësor, industrial apo urban.

i. Përshkrim i përmbledhur i zhvillimeve të planifikuara nga HZK-ja

HZK parasheh që në fshatra, tokat më pjellore të kategorisë I-IV të ruhen me kujdes dhe shfrytëzohen kryesisht për bujqësi. Ndërtimet janë të kufizuara, duke u lejuar vetëm aty ku cilësia e tokës është më e ulët, në mënyrë që të mos cenohet prodhimi bujqësor. Këtu theksohet zhvillimi i qëndrueshëm dhe bujqësia organike, si një mënyrë për të ruajtur tokat cilësore për brezat e ardhshëm.

Në zonat sub-urbane, jeta është e kombinuar: njerëzit jetojnë në shtëpi individuale, merren me bujqësi të vogël, industri të lehtë dhe tregti. Parcelat e mëdha u japin mundësi banorëve të ndërthurin jetën familjare me aktivitete ekonomike, shpesh për nevoja vetjake.

Në qytet, dendësia e banimit është e lartë dhe tokat përdoren kryesisht për banesa, shërbime komerciale dhe ndërtesa publike. Megjithatë, hapësirat e gjelbra dhe ato sportive janë të pakta, gjë që e kufizon cilësinë e jetës për rekreacion.

Tokat bujqësore ndahen sipas klasave të cilësisë: ato më të mirat përdoren për bujqësi intensive, ndërsa tokat më pak cilësore për aktivitete më të lehta. Synimi është mbrojtja e tokës përmes kontrollit të parcelimit dhe dendësisë, duke shmangur ndarjet e pakontrolluara.

Pyjet menaxhohen me kujdes për të siguruar rigjenerim natyror dhe për të ruajtur pjellorinë e tokës. Ndërsa zonat turistike shërbejnë për rekreacion, sport dhe gjelbërim, duke ruajtur karakterin natyror dhe kufizuar ndërtimet intensive.

Industria vendoset në toka me cilësi të ulët, për të mos dëmtuar tokat bujqësore pjellore, ndërsa sipërfaqet ujore mbrohen me breza mbrojtës për të parandaluar ndotjen. Minierat sipërfaqësore, edhe pse degradojnë tokën, janë të lokalizuara në zona specifike.

Në zonat mbishtresore, ndërhyrjet kufizohen për të parandaluar erozionin dhe degradimin. Masat përfshijnë pyllëzimin, tarracimin dhe ruajtjen e mbulesës vegetative. Në zonat me ndotje

të lartë, krijohen hapësira tampon për të parandaluar përhapjen e ndotjes në ajër, ujë dhe nëntokë.

ii. Ndikimet (N):

A. Faktori mjedisor: Cilësia e dheut dhe shfrytëzimi i tokës			AO1	AO2
Zonë banimi rurale			+	++
Zonë banimi urbane			-	-
Zonë banimi sub-urbane			0	-
Zonë e shfrytëzimit të përzier			0	+
Zonë bujqësore			++	++
Zonë pyjore			++	++
Zonë industriale			-	-
Zonë komerciale			0	0
Zonë e komunikacionit – transportit			0	0
Zonë mbrojtur			++	++
Zonë e mbrojtur arkeologjike – historike			+	+
Sipërfaqe ujore			+	-
Zonë minierë sipërfaqësore – gurthyes			-	-
Zonë e shërbimeve			0	+
Zonat mbishtresore				
Zonë sizmike			?	?
Zonë e vërshimeve			-	-
Zonë e akuiferëve			++	++
Zonë e pasurive minerare			-	-
Zonë me rrëshqitje të dheut			-	-
Zonë me erozion			-	-
AO1. Parandalimi i degradimit të tokës; AO2. Mbrojtja e tokave pjellore				
++	Pozitiv i rëndësishëm	HZK-ja ka të ngjarë të ketë një ndikim pozitiv të konsiderueshëm mbi qëllimet e VSM-së.		
+	Pozitiv	HZK-ja ka të ngjarë të ketë një efekt të vogël pozitiv në objektivat e VSM-së.		
0	Neutral	HZK-ja ka të ngjarë të ketë një efekt neutral në objektivat e VSM-së.		
-	Negativ	HZK-ja ka të ngjarë të ketë një efekt të vogël negativ në objektivat e VSM-së.		
--	Negativ i rëndësishëm	HZK-ja ka të ngjarë të ketë një efekt negativ të rëndësishëm në objektivat e VSM-së.		
?	I pasigurt	Efektet e PNKMIM-it në objektivat e VSM janë të pasigurta në këtë fazë.		

Zonat bujqësore, pyjore kanë rol mbrojtës, sepse ruajnë pjellorinë e tokës, parandalojnë erozionin dhe kufizojnë ndotjen. Pyjet dhe sipërfaqet ujore veprojnë si filtra natyrorë, ndërsa bujqësia organike redukton përdorimin e kimikateve. Nëse menaxhohen pa kujdes, bujqësia intensive mund të çojë në degradim të tokës dhe humbje të ekosistemeve, por meqenëse HZK referohet përdorimit të qëndrueshëm dhe kontrollit të parcelimit, këto e kthejnë këtë zonë në një faktor pozitiv.

Zona urbane për shkak të dendësisë së lartë të banimit do rrisin presionin mbi tokën. Sipërfaqet ujore sidomos ato që janë të ndotura nga ujërat e zeza, kanë të ngjarë të kenë efekte negative mbi tokën sidomos atë bujqësore. Zona industriale, minierat kontribuojnë drejtpërdrejt në ndotje kimike dhe degradim të tokës, duke rritur rrezikun e humbjes së pjellorisë. Mirëpo meqenëse nuk ka ndonjë shfrytëzim intensiv i tokës dhe janë të lokalizuara në zona specifike, ndotja dhe degradimi i tokës nuk ka efekt të rëndësishëm negativ.

Në zonat sizmike ndikimi është i paqartë, pasi degradimi varet nga lëvizjet natyrore të tokës dhe masat e menaxhimit.

iii. Receptorët (R) e afektuar

Receptorët e afektuar nga faktori cilësia e dheut dhe shfrytëzimi i tokës janë kryesisht elementët që lidhen me ekosistemet bujqësore, mjedisin natyror dhe shëndetin e komunitetit lokal.

AR1. Tokat bujqësore – humbja e pjellorisë, degradimi nga përdorimi intensiv, ndotja nga kimikatet.

AR2. Ekosistemet natyrore – erozioni dhe zhdukja e habitateve të bimësisë dhe faunës.

AR3. Burimet ujore – ndotja e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore nga përdorimi i plehrave kimike dhe pesticideve.

AR4. Komunitetet lokale – ndikimi në cilësinë e jetës, sigurinë ushqimore dhe shëndetin publik.

AR5. Peizazhi rural dhe urban

4.2.2. Faktori mjedisor B: Cilësia e ujërave

Vlerëson burimet ujore sipërfaqësore dhe nëntokësore, ndotjen, përdorimin dhe ndikimet nga aktivitetet njerëzore.

i. Përshkrim i përmbledhur i zhvillimeve të planifikuara nga HZK-ja

Historia e ujërave në Deçan dhe zonat përreth paraqitet si një përpyetje e vazhdueshme për të balancuar zhvillimin me mbrojtjen e ekosistemeve. Lumbardhi i Deçanit, një burim i rëndësishëm ujqor me rrjedhje të vazhdueshme, është dëmtuar nga ndërtimi i një hidrocentrali të lejuar kundër ligjit, duke rrezikuar ekosistemet përreth. Për këtë arsye, HZK ka vendosur masa të qarta për ndalimin e ndotjes dhe devijimit të rrjedhave natyrore, me synimin për të ruajtur cilësinë e ujit dhe ekuilibrin ekologjik.

Në zonat rurale, sfida kryesore mbetet mungesa e kanalizimit, e cila rrit rrezikun e ndotjes. Megjithatë, parashikohet ndërtimi i impianteve për pastrimin e ujërave të zeza dhe ndalimi i plehrave kimike, duke sjellë një ndikim pozitiv të pjesshëm. Ndërhyrjet në rrjedhat ujore lejohen vetëm për qëllime bujqësore dhe në harmoni me institucionet përgjegjëse, ndërsa prodhimet industriale ndalohen për të shmangur ndotjen.

Në zonat sub-urbane dhe urbane, menaxhimi i ujit është i lidhur ngushtë me rekreacionin, bujqësinë urbane dhe mbrojtjen nga vërshimet, duke e bërë cilësinë e ujit pjesë të planifikimit urban dhe periferik. Në zonat bujqësore, sistemi i ujitjes rrit produktivitetin, por përdorimi i pesticideve mbetet një kërcënim për cilësinë e ujit. Pyjet, nga ana tjetër, luajnë rol të rëndësishëm në parandalimin e erozionit dhe rregullimin e rrjedhave, duke ndikuar indirekt në mbrojtjen e ujërave.

Në zonat industriale, HZK kërkon respektimin e standardeve mjedisore dhe ndërtimin e sistemeve për trajtimin e ujërave të ndotura, por rreziku i ndotjes mbetet prezent. Veprimtaritë minerare kufizohen rreptësisht, duke mos lejuar ndërtime pranë burimeve ujore. Zonat mbishtresore (sidomos ato të vërshimeve kërkojnë masa për drenazh dhe tampon zona për filtrimin natyror, ndërsa në Grykën e Deçanit dhe Lloqanit, aktivitetet rekreative lejohen, por industria dhe hidrocentralet ndalohen.

ii. Ndikimet (N):

Tabela 19: Cilësia e ujërave

Faktori mjedisor B: Cilësia e ujërave	BO1	BO2
Zonë banimi rurale	-	+
Zonë banimi urbane	-	0
Zonë banimi sub-urbane	+	+
Zonë e shfrytëzimit të përzier	?	?
Zonë bujqësore	0	+
Zonë pyjore	+	+
Zonë industriale	0	0
Zonë komerciale	?	?
Zonë e komunikacionit – transportit	?	?
Zonë mbrojtur	++	++
Zonë e mbrojtur arkeologjike – historike	?	?
Sipërfaqe ujore	++	++

Zonë minierë sipërfaqësore - gurthyes	0	0
Zonë e shërbimeve	0	0
Zonat mbishtresore		
Zonë sizmike	0	0
Zonë e vërshimeve	+	+
Zonë e akuiferëve	++	++
Zonë me rrëshqitje të dheut	?	?
Zonë me erozion	+	+
B01. Ruajtja e pastërtisë së ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore; B02. Përdorim racional i burimeve ujore për të shmangur mbipërdorimin dhe ruajtjen e ekuilibrit hidrologjik		
++	Pozitiv i rëndësishëm	HZK-ja ka të ngjarë të ketë një ndikim pozitiv të konsiderueshëm mbi qëllimet e VSM-së.
+	Pozitiv	HZK-ja ka të ngjarë të ketë një efekt të vogël pozitiv në objektivat e VSM-së.
0	Neutral	HZK-ja M ka të ngjarë të ketë një efekt neutral në objektivat e VSM-së.
-	Negativ	HZK-ja ka të ngjarë të ketë një efekt të vogël negativ në objektivat e VSM-së.
--	Negativ i rëndësishëm	HZK-ja ka të ngjarë të ketë një efekt negativ të rëndësishëm në objektivat e VSM-së.
?	I pasigurt	Efektet e PNKMIM-it në objektivat e VSM janë të pasigurta në këtë fazë.

Zonat e mbrojtura, sipërfaqet ujore dhe akuiferët kanë ndikim pozitiv të rëndësishëm, sepse kanë masa të qarta ligjore dhe ekologjike për mbrojtje.

Masat e planifikuara me HZK për mbrojtjen e ujërave në raport me zhvillimet në zonat rurale, industriale, bujqësore dhe zonën e gurthyesit kanë ndikim të vogël pozitiv në objektivat e VSM-së, por ky ndikim është i kufizuar për shkak të rreziqeve që mbeten (mungesa e kanalizimit në zonat e banimit rrit rrezikun e ndotjes, edhe pse ndërtimi i impianteve dhe ndalimi i plehrave kimike sjellin përmirësim të pjesshëm; impiantet e trajtimit të ujërave janë një hap i mirë, por ndotja mund të mbetet prezente për shkak të vetë natyrës së industrisë, ujitja rrit produktivitetin dhe furnizimin me ujë, por përdorimi i pesticideve vazhdon të kërcënojë cilësinë e ujit.

iii. Receptorët (R) e afektuar

Receptorët e afektuar nga zbatimi i Hartës zonale të Deçanit janë të lidhur ngushtë me burimet ujore, ekosistemet dhe shëndetin e komunitetit.

BR1. Burimet ujore sipërfaqësore (lumenj, liqene) të cilat ndoten nga mbeturinat urbane, industriale dhe bujqësore dhe ujërat e zeza të fshatrave.

BR2. Burimet ujore nëntokësore të rrezikuara nga infiltrimi i kimikateve, pesticideve, mungesa e rrjetit të kanalizimit.

BR3. Humbja e biodiversitetit në ekosistemet ujore për shkak të ndotjes dhe ndryshimeve në rrjedhën e ujit.

BR4. Ekuilibri hidrologjik rrezikon të ndikohet nga mbipërdorimi dhe ndryshimet në rrjedhën natyrore të ujërave.

4.2.3. Faktori mjedisor C: Cilësia e ajrit

Përshkruan burimet e ndotjes atmosferike, emisionet e gazrave serë dhe ndikimet në mjedis e shëndet.

i. Përshkrim i përmblendhur i zhvillimeve të planifikuara nga HZK-ja

Cilësia e ajrit ndikohet nga zhvillimet infrastrukturore, bujqësore dhe industriale, por edhe nga masat mbrojtëse të parashikuara.

Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugëve sjell rritje të trafikut dhe emisioneve, por kjo balancohet nga modernizimi i transportit publik dhe nxitja e mjeteve jomotorike, të cilat synojnë të reduktojnë ndotjen. Në zonat rurale, elektrifikimi dhe ndriçimi efikas publik ndihmojnë në uljen e konsumit joefikas, duke ruajtur ajrin më të pastër. Pyjet dhe bimësia e pasur luajnë një rol të madh në

përmirësimin e cilësisë së ajrit, ndërsa ndalohet shfrytëzimi i pakontrolluar i resurseve natyrore. Megjithatë, prerja e gjelbërimit për ndërtim ka ndikim negativ, duke rritur erozionin dhe ndotjen. Në zonën urbane, ndërtimet mund të shtojnë ngarkesën mjedisore. Ndalohet industria e rëndë, duke lejuar vetëm aktivitete të lehta që nuk ndotin ajrin. Në zonat bujqësore, bujqësia tradicionale sugjeron ajër më të pastër, por përdorimi i pesticideve mbetet një rrezik. Pyjet, zonat turistike dhe sipërfaqet e gjelbra kontribuojnë dukshëm në thithjen e ndotjes.

Industria e lehtë është e planifikuar të jetë miqësore ndaj mjedisit, por kërkohet kontroll i emisioneve, ndërsa minierat sipërfaqësore mund të gjenerojnë pluhur, prandaj vendosen distanca mbrojtëse. Në zonat mbishtresore, hot-spotet e ndotjes trajtohen si zona mbrojtëse për të parandaluar përhapjen e ndotësve kimikë dhe industrialë.

ii. Ndikimet (N):

Tabela 20 : Cilësia e ajrit

Faktori mjedisor C: Cilësia e ajrit		CO1	
Zonë banimi rurale		-	
Zonë banimi urbane		-	
Zonë banimi sub-urbane		-	
Zonë e shfrytëzimit të përzier		0	
Zonë bujqësore		0	
Zonë pyjore		++	
Zonë industriale		-	+
Zonë komerciale		-	+
Zonë e komunikacionit – transportit		-	
Zonë turistike		-	+
Zonë mbrojtur		+	
Zonë e mbrojtur arkeologjike – historike		+	
Sipërfaqe ujore		+	
Zonë minierë sipërfaqësore – gurthyes		0	
Zonë e shërbimeve		+	
Zonat mbishtresore		0	
CO1. Zvogëlimi i emisioneve nga ndërtimet, transporti dhe lëndët djegëse fosile për ngrohje			
++	Pozitiv i rëndësishëm	HZK-ja ka të ngjarë të ketë një ndikim pozitiv të konsiderueshëm mbi qëllimet e VSM-së.	
+	Pozitiv	HZK-ja ka të ngjarë të ketë një efekt të vogël pozitiv në objektivat e VSM-së.	
0	Neutral	HZK-ja M ka të ngjarë të ketë një efekt neutral në objektivat e VSM-së.	
-	Negativ	HZK-ja ka të ngjarë të ketë një efekt të vogël negativ në objektivat e VSM-së.	
--	Negativ i rëndësishëm	HZK-ja ka të ngjarë të ketë një efekt negativ të rëndësishëm në objektivat e VSM-së.	
?	I pasigurt	Efektet e PNKMIM-it në objektivat e VSM janë të pasigurta në këtë fazë.	

Zonat e banimit për shkak të ndërtimeve të larta (zona urbane qendrore), trafikut dhe ngrohjes me lëndë djegëse fosile, rrisin ngarkesën mjedisore. Arkitektura miqësore ndaj mjedisit dhe gjelbërimit i planifikuar dhe monitorimi i ajrit është i nevojshëm.

Pyjet dallohen si faktor shumë pozitiv duke kontribuar fuqishëm në cilësinë e ajrit përmes fotosintezës, megjithatë nuk ka sisteme monitorimi të dedikuara.

Zonat turistike, industriale dhe ato komerciale kanë ndikim të përzier: industria e lehtë me standarde mjedisore redukton ndotjen, por emisionet nga përpunimi i drurit, metaleve dhe plastikës mbeten problem. Aktivitetet e caktuara turistike dhe komerciale mund të gjenerojnë ndotje të ajrit por që ato janë kryesisht të lokalizuara dhe jo me efekt të shtrirë. Zonat e transportit dhe komunikacioni shfaqin ndikim negativ për shkak të trafikut dhe asfaltimit.

Ndërkohë zona e gurthyesit për shkak se është e lokalizuar, zonat sizmike, të vërshimeve apo akuiferëve mbeten neutrale, pasi ndikimi në ajër është i kufizuar ose i paqartë.

iii. Receptorët (R) e afektuar

Receptorët e afektuar nga zbatimi i Hartës zonale të Deçanit lidhen me mjedisin urban, shëndetin e popullsisë dhe ekuilibrin ekologjik.

CR1. Popullsia lokale – ekspozimi ndaj smogut, gazrave serë dhe grimcave të imëta (PM2.5/PM10) që ndikojnë në shëndetin respirator dhe kardiovaskular.

CR2. Ekosistemet natyrore – ndotja e ajrit ndikon në bimësi, faunë dhe cilësinë e tokës.

CR3. Mjedisi urban – rritja e smogut dhe ulja e cilësisë së jetës në zonat e banuara.

CR4. Klima globale – emisionet e gazrave serë kontribuojnë në ndryshimet klimatike.

4.2.4. Faktori mjedisor D: Zhurma dhe vibrimi

Analizon burimet e zhurmës (trafiku, industria, ndërtimet) dhe efektet mbi popullsinë.

i. Përshkrim i përmbledhur i zhvillimeve të planifikuara nga HZK-ja

Dokumenti nuk trajton drejtpërdrejt zhurmën, por zonat urbane dhe qendrore ku dendësia e popullsisë dhe aktivitetet tregtare janë më të larta, rreziku për zhurmë është më i madh. Për këtë arsye, ndërtesat që gjenerojnë zhurmë janë të ndaluara. Në zonat sub-urbane, industria e lehtë dhe shërbimet lejohen vetëm nëse respektojnë normat akustike, ndërsa objektet argëtuese si diskotekat duhet të jenë në distanca të caktuara për të mos shqetësuar banorët. Zhvillimet e reja, si ndërtimi i rrugëve, garazheve publike dhe parkingjeve, sjellin rritje të trafikut dhe për pasojë edhe të niveleve të zhurmës. Për këtë arsye, ligjet e vendit dhe direktivat e Bashkimit Europian kanë vendosur kufij të qartë për zhurmën e lejuar në zona të ndryshme: në zonat urbane 50–55 dB, në zonat industriale 60–70 dB dhe në zonat rekreative 45–50 dB. Për të mbajtur zhurmën nën kontroll, parashikohen masa si ndërtimi i mureve mbrojtëse, korridoreve të gjelbërta, shtresave të lëmuara të rrugëve dhe izolimit akustik të ndërtesave.

Aktivitetet bujqësore zakonisht kanë ndikim të ulët në zhurmë, përveç përdorimit të makinerive bujqësore sezonale. Distancat e përcaktuara për fermat nga zonat urbane dhe rurale synojnë të minimizojnë ndikimin e zhurmës dhe erërave të kafshëve mbi banorët. Për shembull, fermat e mëdha duhet të jenë minimumi 500 m larg zonave urbane. Ndërsa zonat pyjore mbeten hapësira të qeta me ndikim minimal. Ndërtimet e lejuara janë të integruara në mjedis dhe nuk pritet të gjenerojnë vibrime apo zhurmë të lartë. Në zonat turistike, aktivitete si koncerte, festivale dhe ngjarje sportive mund të gjenerojnë zhurmë, por janë të lejuara vetëm si aktivitete të përkohshme dhe të kontrolluara. Kjo ndihmon në balancimin e rekreacionit me qetësinë e zonës.

Aktivitetet industriale si përpunimi mekanik dhe elektrik mund të gjenerojnë zhurmë. Distanca e respektuar nga zonat e banimit është kriter i rëndësishëm për të minimizuar ndikimin akustik.

Aktivitete si gara motorike në sipërfaqet ujore ndalohen, për të shmangur ndikimet akustike dhe vibrimet që cenojnë mjedisin e ujërave.

Zonat mbishtresore parashikojnë masa kundër ndotjes akustike, sidomos pranë zonave urbane dhe rrugëve me trafik të lartë, duke krijuar korridore gjelbërimi dhe barriera akustike.

ii. Ndikimet (N):

Tabela 21: Zhurma dhe vibrimi

Faktori mjedisor D: Zhurma dhe vibrimi	D01
Zonë banimi rurale	0
Zonë banimi urbane	-
Zonë banimi sub-urbane	0
Zonë e shfrytëzimit të përzier	0
Zonë bujqësore	0
Zonë pyjore	++

Zonë industriale	-
Zonë komerciale	-
Zonë e komunikacionit – transportit	-
Zonë turistike	0
Zonë mbrojtur	++
Zonë e mbrojtur arkeologjike – historike	+
Sipërfaqe ujore	0
Zonë minierë sipërfaqësore - gurthyes	0
Zonë e shërbimeve	0
Zonat mbishtresore	+

D01. Reduktimi i niveleve të zhurmës		
++	Pozitiv i rëndësishëm	HZK-ja ka të ngjarë të ketë një ndikim pozitiv të konsiderueshëm mbi qëllimet e VSM-së.
+	Pozitiv	HZK-ja ka të ngjarë të ketë një efekt të vogël pozitiv në objektivat e VSM-së.
0	Neutral	HZK-ja M ka të ngjarë të ketë një efekt neutral në objektivat e VSM-së.
-	Negativ	HZK-ja ka të ngjarë të ketë një efekt të vogël negativ në objektivat e VSM-së.
--	Negativ i rëndësishëm	HZK-ja ka të ngjarë të ketë një efekt negativ të rëndësishëm në objektivat e VSM-së.
?	I pasigurt	Efektet e PNKMIM-it në objektivat e VSM janë të pasigurta në këtë fazë.

Zonat pyjore dhe zonat mbishtresore kontribuojnë drejtpërdrejt në arritjen e objektivave, sepse ruhen si hapësira të qeta dhe parashikojnë masa kundër ndotjes akustike. Këto zhvillime e mbështesin fuqishëm reduktimin e zhurmës dhe kufizimin e aktiviteteve ndërtimore të papërshtatshme.

Zonat rurale, bujqësore dhe turistike kanë ndikim kryesisht neutral. Rrugët e reja në zonat rurale rrisin pak trafikun, makineritë bujqësore sjellin zhurmë të lokalizuar dhe sezonale, ndërsa eventet turistike gjenerojnë zhurmë të përkohshme. Megjithatë, këto nuk e pengojnë në mënyrë të qëndrueshme arritjen e objektivave.

Zonat urbane, industriale, komerciale dhe ato të transportit gjenerojnë zhurmë nga trafiku, aktivitetet mekanike dhe dendësia e lartë e ndërtimeve. Ndikimi i tyre është negativ i vogël, pasi masat mbrojtëse e zbusin disi efektin.

iii. Receptorët (R) e afektuar

Receptorët e afektuar nga zbatimi i Hartës zonale të Deçanit lidhen kryesisht me cilësinë e jetës së banorëve dhe mjedisin urban

DR1. Popullsia lokale – ekspozimi ndaj niveleve të larta të zhurmës dhe vibrimeve, që ndikon në shëndetin mendor dhe fizik (lodhje, stres, probleme të gjumit).

DR2. Institucionet publike (shkolla, spitale) – ndjeshmëri më e lartë ndaj zhurmës për shkak të funksioneve të tyre.

DR3. Mjedi urban – ulja e cilësisë së jetës në zonat e dendura dhe të banuara.

DR4. Ekosistemet – fauna urbane dhe rurale mund të preket nga zhurma e vazhdueshme.

4.2.5. Faktori mjedisor E: Biodiversiteti dhe zonat natyrore të mbrojtura

Vlerëson gjendjen e habitateve, specieve të mbrojtura dhe zonave të veçanta ekologjike. Ky faktor është veçanërisht i ndjeshëm sepse biodiversiteti është një pasuri kombëtare dhe ruajtja e tij kërkon bashkëpunim ndërsektorial nga institucionet shtetërore, komuna, deri tek komunitetet lokale.

i. Përshkrim i përmbledhur i zhvillimeve të planifikuara nga HZK-ja

HZK-ja ka paraparë zhvillime të ndryshme në zona të veçanta, duke i trajtuar sipas vlerave të tyre natyrore dhe kulturore. Në Strelc është parashikuar ndërtimi i qendrës për gështenjën, si ekosistem specifik që kontribuon në ruajtjen e biodiversitetit. Zona sub-urbane përfshin hapësira pyjore dhe Manastirin e Deçanit, duke ruajtur trashëgiminë natyrore e kulturore. Në zonat urbane, megjithëse biodiversiteti është i ulët, hapësirat gjelbëruese dhe monumentet kulturore janë planifikuar për

të ruajtur balancën ekologjike. Zonat bujqësore, me livadhe, kullota dhe vreshta, mbështesin biodiversitetin rural, ndërsa zonat pyjore, veçanërisht pylli i pishës së zezë, janë të mbrojtura ligjërisht dhe kanë rëndësi të madhe ekologjike. Zona industriale është vendosur larg zonave me vlera natyrore për të shmangur dëmtimet, ndërsa zonat turistike si Bjeshka e Belegut dhe Laku i Kryqës janë pjesë e Parkut Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”, ku turizmi i kontrolluar synon të ruajë biodiversitetin, por mbetet i pasigurt nëse nuk menaxhohet mirë. Parku Kombëtar dhe rezervatet natyrore janë trajtuar me plane rregulluese dhe kufizime të rrepta për ndërtim, duke mbrojtur speciet e rrezikuara si *Gentiana lutea*. Sipërfaqet ujore janë të mbrojtura nga peshkimi komercial, ndërsa minierat sipërfaqësore ndalohen pranë zonave të mbrojtura për të shmangur fragmentimin e ekosistemeve. Zonat mbishtresore si Pishat e Deçanit dhe peizazhet natyrore lejojnë turizmin e qëndrueshëm dhe edukimin mjedisor, duke ndaluar aktivitetet industriale që cenojnë mjedisin.

ii. Ndikimet (N)

Tabela 22: Biodiversiteti dhe zonat natyrore të mbrojtura

Faktori mjedisor E: Biodiversiteti dhe zonat natyrore të mbrojtura			E01	E02
Zonë banimi rurale			+	+
Zonë banimi urbane			-	+
Zonë banimi sub-urbane			0	0
Zonë e shfrytëzimit të përzier			0	0
Zonë bujqësore			+	+
Zonë pyjore			++	++
Zonë industriale			0	0
Zonë komerciale			0	0
Zonë e komunikacionit – transportit			0	0
Zonë turistike			-	?
Zonë mbrojtur			++	++
Zonë e mbrojtur arkeologjike – historike			++	++
Sipërfaqe ujore			++	+
Zonë minierë sipërfaqësore - gurthyes			-	?
Zonë e shërbimeve			0	0
Zonat mbishtresore			+	+
E01. Ruajtja e habitateve natyrore dhe specieve të rrezikuara. E02. Menaxhim i qëndrueshëm i zonave të mbrojtura.				
++	Pozitiv i rëndësishëm	HZK-ja ka të ngjarë të ketë një ndikim pozitiv të konsiderueshëm mbi qëllimet e VSM-së.		
+	Pozitiv	HZK-ja ka të ngjarë të ketë një efekt të vogël pozitiv në objektivat e VSM-së.		
0	Neutral	HZK-ja ka të ngjarë të ketë një efekt neutral në objektivat e VSM-së.		
-	Negativ	HZK-ja ka të ngjarë të ketë një efekt të vogël negativ në objektivat e VSM-së.		
--	Negativ i rëndësishëm	HZK-ja ka të ngjarë të ketë një efekt negativ të rëndësishëm në objektivat e VSM-së.		
?	I pasigurt	Efektet e PNKMIM-it në objektivat e VSM janë të pasigurta në këtë fazë.		

Zonat pyjore, zonat e mbrojtura, sipërfaqet ujore dhe zonat arkeologjike-historike kanë rol kyç (pra ndikim pozitiv të rëndësishëm) në ruajtjen e biodiversitetit dhe trashëgimisë natyrore. Kufizimet e rrepta dhe menaxhimi i kontrolluar sigurojnë mbrojtje të specieve të rrezikuara dhe parandalojnë fragmentimin e ekosistemeve.

Zonat rurale, bujqësore dhe mbishtresore kanë ndikim të vogël pozitiv pasi kontribuojnë në ruajtjen e biodiversitetit përmes praktikave tradicionale dhe ekosistemeve specifike.

Zona sub-urbane, zonat e shfrytëzimit të përzier, industriale, komerciale, transporti dhe shërbimet kanë ndikim të kufizuar ose neutral. Ato nuk cenojnë drejtpërdrejt biodiversitetin, por as nuk e përforcojnë ndjeshëm.

Zona urbane për shkak të densifikimit me ndërtime të larta ka të ngjarë të ketë ndikim negative mbi habitatet natyrore pasi që pritet që tokë e konsiderueshme me gjelbërim të shndërrohet në tokë ndërtimore. Minierat sipërfaqësore paraqesin rrezik për biodiversitetin dhe ekosistemet, pasi aktivitetet minerare rrezikojnë fragmentimin e ekosistemeve. Ndërtimet turistike brenda zonave të mbrojtura mund të shkaktojnë presion mbi habitate, nëse ato nuk menaxhohen mire. Ndikimi negativ mund të jetë i konsiderueshëm, duke çuar në degradim të habitateve dhe humbje të biodiversitetit. Nëse menaxhohen me kujdes dhe sipas planeve hapësinore, mund të kenë efekt pozitiv duke kontribuar në zhvillim të qëndrueshëm.

iii. Receptorët (R) e afektuar

Receptorët e afektuar lidhen me ekuilibrin ekologjik, speciet e mbrojtura dhe cilësinë e habitateve.

ER1. Speciet e egra dhe të mbrojtura – rreziku nga fragmentimi i habitateve dhe ndotja.

ER2. Habitatet natyrore – pyjet, livadhet, zonat ujore që mund të humbasin integritetin ekologjik.

ER3. Zonat e mbrojtura – parqet kombëtare dhe rezervatet natyrore që kërkojnë menaxhim të kujdesshëm.

ER4. Komunitetet lokale – humbja e shërbimeve ekosistemike (ujë i pastër, ajër i pastër, tokë pjellore).

ER5. Ekuilibri ekologjik – fragmentimi i ekosistemeve ndikon në zinxhirin ushqimor dhe stabilitetin biologjik.

4.2.6. Faktori mjedisor F: Faktorët e ndryshimeve klimatike

Analizon emisionet e CO₂ dhe efektet e rreziqeve klimatike (thatësia, përmblytjet, erërat e forta dhe stuhitë, ...). Ky faktor është i lidhur ngushtë me të gjithë faktorët e tjerë (dheu, ujërat, ajri, biodiversiteti, zhurma), sepse ndryshimet klimatike i përkeqësojnë ndikimet e tyre.

i. Përshkrim i përmbledhur i zhvillimeve të planifikuara nga HZK-ja

HZK-ja ka parapare masa të ndryshme që lidhen me ndikimet klimatike në zonat e planifikimit. Në zonat rurale, edhe pse nuk ka përmendje të drejtpërdrejtë, migrimi dhe kthimi i mërgimtarëve lidhen me faktorë socio-ekonomikë të ndikuar nga bujqësia e varur nga kushtet klimatike. Në zonat sub-urbane, lejimi i prodhimit të energjisë së ripërtëritshme dhe krijimi i brezave të gjelbër përgjatë rrugëve e lumenjve ndihmojnë në adaptim dhe reduktim të ndikimeve klimatike. Zonat urbane parashohin dendësim të lartë por me planifikim kompakt, përdorim të paneleve diellore dhe gjelbërim përgjatë rrugëve e ujërave, duke kontribuar në uljen e emisioneve dhe përshtatjen ndaj klimës.

Në zonat bujqësore, përdorimi i tokave pjellore, sistemet e ujitjes dhe promovimi i fermave moderne me ndikim më të ulët mjedisor ndihmojnë në përshtatje, ndërsa kullotat dhe pyjet kontribuojnë në ruajtjen e karbonit. Zonat pyjore janë faktor kyç për reduktimin e ndikimeve klimatike, përmes absorbimit të CO₂, menaxhimit të qëndrueshëm dhe pyllëzimit të parashikuar. Zonat turistike mbështeten në gjelbërim dhe pyje për ruajtjen e klimës, duke vendosur norma për sipërfaqe gjelbërimi për banorë.

Industria e lehtë e planifikuar përfshin riciklimin dhe energjinë e ripërtëritshme, ndërsa sipërfaqet ujore sigurojnë mbrojtje ndaj përmblytjeve e thatësirave. Në zonën e gurthyesit, aktivitetet e gërryerjes mund të rrisin erozionin, prandaj parashikohet ndalimi i tij. Zonat e shërbimeve përfshijnë investime në energji efikase dhe ndriçim publik, duke ulur konsumin.

Zonat mbishtresore dhe ato të përmblytjeve trajtojnë rrezikun nga reshjet e dendura, rrëshqitjet e dheut dhe përmblytjet, përmes masave të drenazhimit, pyllëzimit dhe ndërtimit të pendave akumuluese. Ndërsa zona e veçantë e mbrojtur e Manastirit të Deçanit kufizon ndërtimet dhe aktivitetet që mund të dëmtojnë tokën, duke ruajtur stabilitetin e terrenit dhe gjelbërimin.

HZK nuk përmban asnjë përcaktim në lidhje me rreziqet nga thatësitrat.

ii. Ndikimet (N):

Tabela 23: Faktorët e ndryshimeve

Faktori mjedisor F: Faktorët e ndryshimeve klimatike	FO1		FO2		FO3	
Zonë banimi rurale	0		0		0	
Zonë banimi sub-urbane	0		-		-	+
Zonë banimi urbane	-		-		-	+
Zonë e shfrytëzimit të përzier	-		-		-	
Zonë bujqësore	+		+		++	
Zonë pyjore	++		++		++	
Zonë industriale	-		-		-	
Zonë komerciale	-		-		-	
Zonë e komunikacionit – transportit	-	+	0		-	+
Zonë turistike	-	+	-	+	-	+
Zonë mbrojtur	+		+		+	
Zonë e mbrojtur arkeologjike – historike	+		+		+	
Sipërfaqe ujore	0		0		+	
Zonë minierë sipërfaqësore - gurthyes	-		-		0	
Zonë e shërbimeve	0		0		0	
Zonat mbishtresore	+		+		+	
FO1. Ulja e emisioneve të gazrave serë. FO2. Rritja e sipërfaqeve të gjelbra dhe pyllëzimi. FO3. Përshtatja ndaj efekteve të rreziqeve nga ndryshimet klimatike						
++	Pozitiv i rëndësishëm		HZK-ja ka të ngjarë të ketë një ndikim pozitiv të konsiderueshëm mbi qëllimet e VSM-së.			
+	Pozitiv		HZK-ja ka të ngjarë të ketë një efekt të vogël pozitiv në objektivat e VSM-së.			
0	Neutral		HZK-ja M ka të ngjarë të ketë një efekt neutral në objektivat e VSM-së.			
-	Negativ		HZK-ja ka të ngjarë të ketë një efekt të vogël negativ në objektivat e VSM-së.			
--	Negativ i rëndësishëm		HZK-ja ka të ngjarë të ketë një efekt negativ të rëndësishëm në objektivat e VSM-së.			
?	I pasigurt		Efektet e PNKMIM-it në objektivat e VSM janë të pasigurta në këtë fazë.			

Zonat bujqësore, pyjore, mbishtresore, zonat e mbrojtura dhe arkeologjike/historike kanë vlerësime pozitive (+ deri ++), duke kontribuar dukshëm në uljen e emisioneve, rritjen e gjelbërimit dhe përshtatjen ndaj klimës. Pyjet veçanërisht shfaqen si faktor kyç me ndikim shumë të rëndësishëm. Zonat urbane të banimit, komerciale, transportit dhe turistike, tregojnë kombinim të efekteve pozitive dhe negative. Për shembull, urbanizimi kompakt dhe gjelbërimi ndihmojnë në adaptim, por dendësi i lartë dhe aktivitetet e caktuara komerciale sjellin edhe rritje të emisioneve. Ndërtimet e larta dhe betonizimi i tepruar mund të kenë ndikime negative, duke rritur temperaturat lokale dhe duke krijuar efektin e 'urban heat island', i cili përkeqëson kushtet e jetesës dhe shton presionin mbi mjedisin. Sipërfaqe ujore vlerësohen me ndikim neutral për FO1 dhe FO2, por pozitiv për FO3, duke ndihmuar në përshtatjen ndaj përmbytjeve dhe thatësirave. Zonat ku zhvillohen aktivitete industriale dhe minerare shfaqin efekte negative për shkak të emisioneve dhe shpyllëzimit por meqë janë të izoluar në zona specifike, ndikimi i tyre nuk pritet të jetë i rëndësishëm.

iii. Receptorët (R) e afektuar

Receptorët e afektuar nga zbatimi i Hartës zonale të Deçanit lidhen me ekuilibrin ekologjik, shëndetin e komunitetit dhe qëndrueshmërinë afatgjatë të mjedisit.

FR1. Popullsia lokale – rreziku nga thatësira, përmbytjet dhe stuhitë që ndikojnë në sigurinë dhe cilësinë e jetës.

FR2. Ekosistemet natyrore – humbja e habitateve për shkak të shpyllëzimit dhe ndryshimeve klimatike.

FR3. Tokat bujqësore – ndikimi nga thatësira dhe përmytjet që dëmtojnë prodhimin bujqësor.

FR4. Burimet ujore – reduktimi i sasisë së ujit dhe ndotja e tij nga ndryshimet klimatike.

FR5. Infrastruktura urbane – rreziku nga përmytjet dhe erërat e forta.

4.2.7. Faktori mjedisor G: Mirëqenia e popullsisë dhe ekonomia lokale

Përshkruan ndikimet sociale dhe ekonomike, si punësimi, zhvillimi lokal dhe cilësia e jetës. Ky faktor është veçanërisht i rëndësishëm sepse lidh mjedisin me zhvillimin ekonomik dhe social.

i. Përshkrim i përmbledhur i zhvillimeve të planifikuara nga HZK-ja

HZK-ja ka planifikuar ose ka përcaktuar zhvillime të ndryshme që lidhen me mirëqenien e popullsisë dhe ekonominë lokale. Në zonat rurale, baza e ekonomisë është bujqësia, turizmi rural dhe shërbimet e vogla tregtare, të cilat ruajnë traditat dhe sigurojnë ushqim e të ardhura për komunitetin. Fermat e vogla dhe të mesme mbështesin ekonominë vendore dhe rrisin sigurinë ushqimore.

Zona sub-urbane kombinon banimin me shërbime tregtare, industri të lehtë dhe bujqësi, duke gjeneruar të ardhura dhe duke përmirësuar cilësinë e jetesës, ndërsa lidhjet me zonën urbane sigurojnë akses më të shpejtë në shërbime. Zona urbane është qendra e zhvillimit ekonomik, me administratë, biznese dhe shërbime që gjenerojnë të ardhura dhe ofrojnë kushte më të mira jetese, duke balancuar zhvillimin mes zonave urbane e rurale.

Zona bujqësore mbështetet në prodhime kryesore si patatja, gruri dhe misri, si dhe në përpunimin e frutave e bimëve mjekësore, duke siguruar të ardhura dhe ushqim për komunitetin. Pyjet ofrojnë resurse drusore, kullota dhe hapësira rekreative, ndërsa bujtinat prej druri nxisin turizmin rural. Zonat turistike gjenerojnë të ardhura përmes turizmit dhe gastronomisë, sportit, rekreacionit, duke rritur cilësinë e jetës së banorëve me projekte si fshatra turistike, qendra sportive dhe vila rekreative.

Zona industriale synon krijimin e vendeve të reja të punës dhe gjenerimin e të hyrave për komunën, duke ulur migrimin dhe forcuar ekonominë vendore. Sipërfaqet ujore sigurojnë furnizim me ujë dhe hapësira recreative. Minierat sipërfaqësore mund të gjenerojnë punësim dhe të ardhura, por kërkojnë masa mbrojtëse për të shmangur dëmtimet mjedisore.

Zonat mbishtresore ofrojnë mbrojtje nga vërshimet dhe erozioni, duke ruajtur stabilitetin e bujqësisë dhe infrastrukturës, si dhe duke lejuar aktivitete rekreative e bujqësi të lehtë.

ii. Ndikimet (N)

Tabela 24: : Mirëqenia e popullsisë dhe ekonomia lokale

Faktori mjedisor G: Mirëqenia e popullsisë dhe ekonomia lokale	G01	G02
Zonë banimi rurale	+	+
Zonë banimi sub-urbane	+	+
Zonë banimi urbane	++	+
Zonë e shfrytëzimit të përzier	+	?
Zonë bujqësore	++	+
Zonë pyjore	+	+
Zonë industriale	+	-
Zonë komerciale	+	?
Zonë e komunikacionit – transportit	0	0
Zonë turistike	++	+
Zonë mbrojtur	0	0
Zonë e mbrojtur arkeologjike – historike	0	0
Sipërfaqe ujore	+	+
Zonë minierë sipërfaqësore - gurthyes	+	-
Zonë e shërbimeve	0	0
Zonat mbishtresore	0	0
G01. Sigurimi i zhvillimit ekonomik lokal të qëndrueshëm. G02. Krijimi i vendeve të punës pa dëmtuar mjedisin.		

++	Pozitiv i rëndësishëm	HZK-ja ka të ngjarë të ketë një ndikim pozitiv të konsiderueshëm mbi qëllimet e VSM-së.
+	Pozitiv	HZK-ja ka të ngjarë të ketë një efekt të vogël pozitiv në objektivat e VSM-së.
0	Neutral	HZK-ja M ka të ngjarë të ketë një efekt neutral në objektivat e VSM-së.
-	Negativ	HZK-ja ka të ngjarë të ketë një efekt të vogël negativ në objektivat e VSM-së.
--	Negativ i rëndësishëm	HZK-ja ka të ngjarë të ketë një efekt negativ të rëndësishëm në objektivat e VSM-së.
?	I pasigurt	Efektet e PNKMIM-it në objektivat e VSM janë të pasigurta në këtë fazë.

Zonat urbane, bujqësore dhe turistike shfaqen si shtylla kryesore të zhvillimit ekonomik lokal të qëndrueshëm. Ato gjenerojnë të ardhura të konsiderueshme, sigurojnë kushte më të mira jetese dhe krijojnë vende pune duke ruajtur ekuilibrin me mjedisin. Këto zona kanë ndikim të rëndësishëm në realizimin e objektivave GO1 dhe GO2.

Zonat rurale, sub-urbane, pyjore, komerciale, sipërfaqet ujore dhe disa zona të shfrytëzimit të përzier kontribuojnë në mënyrë të vogël, por të qëndrueshme, në zhvillimin ekonomik dhe punësimin. Ato mbështeten kryesisht në bujqësi, turizëm rural, shërbime të vogla dhe aktivitete tradicionale, duke gjeneruar të ardhura pa dëmtuar ndjeshëm mjedisin.

Zonat e komunikacionit/transportit, zonat e mbrojtura, zonat arkeologjike-historike, shërbimet dhe mbishtresoret kanë ndikim neutral. Ato nuk gjenerojnë zhvillim ekonomik të drejtpërdrejtë, por sigurojnë stabilitet dhe mbrojtje të ekosistemeve, duke ruajtur mirëqenien e komunitetit.

Zona industriale dhe minierat sipërfaqësore paraqesin rrezik për mjedisin, edhe pse gjenerojnë vende pune dhe të ardhura. Ndikimi i tyre mbi GO2 është negativ, pasi krijimi i punësimit shoqërohet me dëmtim të ekosistemeve dhe kërkon masa të forta mbrojtëse e ligjore për të balancuar efektet.

Zonat e shfrytëzimit të përzier dhe komerciale kanë vlerësime të paqarta për GO2, pasi ndikimet e tyre varen nga mënyra e menaxhimit të aktiviteteve ekonomike dhe balancimit me mbrojtjen e mjedisit.

iii. Receptorët (R) e afektuar

Receptorët e afektuar nga zbatimi i Hartës zonale të Deçanit lidhen me zhvillimin social, ekonomik dhe cilësinë e jetës së komuniteteve.

GR1. Komunitetet lokale – ndikimi në cilësinë e jetës, punësim dhe shërbime sociale.

GR2. Ekonomia lokale – bizneset e vogla, turizmi, bujqësia dhe industria.

GR3. Grupet e ndjeshme – familjet me të ardhura të ulëta, të rinjtë dhe gratë që mund të përfitojnë ose të preken nga pabarazitë sociale.

GR4. Burimet natyrore – presioni mbi tokën, ujërat dhe biodiversitetin nga aktivitetet ekonomike.

4.2.8. Faktori mjedisor H: Shëndeti publik

Vlerëson efektet e ndotjes dhe faktorëve mjedisorë mbi shëndetin e komunitetit. Ky faktor është ndër më kritikët, sepse lidh drejtpërdrejt mjedisin me shëndetin e njerëzve. Ai përmbledh ndikimet e të gjithë faktorëve të tjerë (ajri, ujërat, zhurma, biodiversiteti, ndryshimet klimatike) në jetën e përditshme të komunitetit.

i. Përshkrim i përmbledhur i zhvillimeve të planifikuara nga HZK-ja

HZK-ja ka planifikuar masa të ndryshme që lidhen me shëndetin publik në zonat e ndryshme. Në zonat rurale dhe sub-urbane, ndërtimi i ambulancave, shkollave siguron qasje në shërbime bazike. Zonat urbane ofrojnë shërbime shëndetësore të përqendruara, hapësira sportive dhe gjelbërim, duke përmirësuar mirëqenien e banorëve. Bujqësia siguron ushqim të freskët dhe të shëndetshëm, me masa mbrojtëse kundër ndotjes, ndërsa pyjet ofrojnë ajër të pastër, rekreacion dhe bimë mjekësore

me përdorim shërues. Zonat turistike kontribuojnë përmes parqeve dhe hapësirave rekreative, duke nxitur aktivitetin fizik dhe relaksimin.

Industria e lehtë dhe minierat paraqesin rrezik për shëndetin, por ato janë të lokalizuara: distancat mbrojtëse synojnë të reduktojnë ekspozimin. Sipërfaqet ujore janë të mbrojtura për të garantuar furnizim me ujë të sigurt, ndërsa zona e shërbimeve përfshin kanalizime, impiante të ujërave të zeza dhe monitorim të ujësjellësit, duke ulur rrezikun e ndotjes. Për zonat mbishtresore nuk ka masa të detajuara, por efektet e përmytjeve, zjarreve dhe thatësirave janë të mëdha për shëndetin e popullsisë.

ii. Ndikimet (N)

Tabela 25: Shëndeti publik

Faktori mjedisor H: Shëndeti publik		H01	
Zonë banimi rurale		+	
Zonë banimi urbane		+	-
Zonë banimi sub-urbane		+	
Zonë e shfrytëzimit të përzier		+	-
Zonë bujqësore		+	
Zonë pyjore		+	
Zonë industriale		-	0
Zonë komerciale		+	-
Zonë e komunikacionit – transportit		-	+
Zonë turistike		0	
Zonë mbrojtur		+	
Zonë e mbrojtur arkeologjike – historike		0	
Sipërfaqe ujore		+	-
Zonë minierë sipërfaqësore – gurthyes		-	0
Zonë e shërbimeve		+	
Zonat mbishtresore		?	
H01. Ulja e ekspozimit ndaj ndikimeve mbi shëndetin e popullsisë.			
++	Pozitiv i rëndësishëm	HZK-ja ka të ngjarë të ketë një ndikim pozitiv të konsiderueshëm mbi qëllimet e VSM-së.	
+	Pozitiv	HZK-ja ka të ngjarë të ketë një efekt të vogël pozitiv në objektivat e VSM-së.	
0	Neutral	HZK-ja M ka të ngjarë të ketë një efekt neutral në objektivat e VSM-së.	
-	Negativ	HZK-ja ka të ngjarë të ketë një efekt të vogël negativ në objektivat e VSM-së.	
--	Negativ i rëndësishëm	HZK-ja ka të ngjarë të ketë një efekt negativ të rëndësishëm në objektivat e VSM-së.	
?	I pasigurt	Efektet e PNKMIM-it në objektivat e VSM janë të pasigurta në këtë fazë.	

Zonat e shërbimeve kanë ndikim pozitiv, pasi ofrimi i institucioneve shëndetësore, lidhet drejtpërdrejt me mbrojtjen e shëndetit publik. Zonat rurale, urbane, sub-urbane, bujqësore, pyjore dhe zonat e mbrojtura kanë ndikim pozitiv, duke siguruar ushqim të freskët, ajër të pastër, hapësira rekreative dhe masa mbrojtëse kundër ndotjes.

Zona e banimit urbane, shfrytëzim të përzier, komerciale, sipërfaqet ujore dhe transporti ka një ndikim të përzier mbi shëndetin publik. Zonat e banimit mund të jetë pozitive meqë ofron mundësi për strehim, kurse negative kur dominohet nga ndërtimet e larta që si rrjedhojë mund të paraqes zvogëlim të sipërfaqeve gjelbëruese dhe dobësim të jetës cilësore të banimit. Sipërfaqet ujore kanë efekt pozitiv për shkak se sasia e bollshme e tyre mundëson furnizim me ujë të pijshëm, ujitje por nëse ato ndoten nga derdhjet e ujërave të zeza dhe kimikatet kjo paraqet rrezik për shëndetin e popullsisë dhe habitateve tjera. Transporti nëse dominohet nga automjetet motorike që ndotin ajrin do krijojnë stres urban, por mund të jetë pozitiv kur promovohet transporti i pastër, publik dhe jo-motorik, duke ulur ekspozimin ndaj ndotjes dhe duke rritur aktivitetin fizik të popullsisë.

Zonat industriale dhe minierat sipërfaqësore janë kryesisht të lokalizuara dhe paraqesin ndikim negativ vetëm për popullsinë dhe habitatet që jetojnë në afërsi të tyre. Megjithatë, masa si distancat mbrojtëse synojnë të reduktojnë ekspozimin e popullsisë.

Zonat turistike, arkeologjike-historike dhe zonat mbrojtura kanë ndikim neutral, pasi nuk ka masa të drejtpërdrejta për shëndetin publik, por as rreziqe të mëdha të evidentuara.

Zonat mbishtresore mbeten të paqarta, pasi nuk ka masa të specifikuara, por efektet e përmytjeve, zjarreve dhe thatësirave mund të kenë ndikim të madh mbi shëndetin e popullsisë.

iii. Receptorët (R) e afektuar

Receptorët e afektuar nga zbatimi i Hartës zonale të Deçanit lidhen drejtpërdrejt me cilësinë e jetës së komunitetit dhe ndikimet e ndotjes mjedisore mbi shëndetin.

HR1. Popullsia lokale – ekspozimi ndaj ndotjes së ajrit, ujit dhe zhurmës që shkakton probleme respiratore, kardiovaskulare dhe stres.

HR2. Grupet e ndjeshme – fëmijët, të moshuarit dhe personat me sëmundje kronike janë më të rrezikuar.

HR3. Personeli shëndetësor dhe institucionet shëndetësore – rritja e ngarkesës në spitale dhe qendra mjekësore për shkak të sëmundjeve të lidhura me mjedisin.

4.2.9. Faktori mjedisor I: Trashëgimia kulturore

Identifikon monumentet, lokalitetet arkeologjike dhe vlerat kulturore që mund të preken.

i. Përshkrim i përmbledhur i zhvillimeve të planifikuara nga HZK-ja

HZK-ja parashikon ruajtjen e trashëgimisë kulturore në zona të ndryshme të Deçanit, duke vendosur rregulla për zhvillimin dhe restaurimin.

Në zonat rurale, Plani nuk përmend drejtpërdrejt trashëgiminë, por ajo lidhet me jetesën bujqësore dhe zakonet e komunitetit. Në zonat sub-urbane dhe urbane gjenden ndërtesa me vlera historike e shpirtërore, si kullat, xhamitë, manastiret dhe monumentet, ku restaurimet lejohen vetëm sipas rregullave të përcaktuara nga Ministria e Kulturës të zbatuara nga QKRT-ja. Qendra urbane përfshin qytetin e vjetër të Deçanit, me arkitekturë të ruajtur.

Në zonat bujqësore, tradita e punës së tokës është pjesë e identitetit kulturor, ndërsa në zonat pyjore trashëgimia lidhet me ndërtimin e shtëpive malore dhe bujtinave tradicionale prej druri. Turizmi kulturor parashihet të zhvillohet përmes festivaleve, koncerteve dhe aktiviteteve që promovojnë traditat lokale. Në zonat e mbrojtura, si Parku Kombëtar, gjenden elemente tradicionale si mulliri, ndërsa në zonat industriale kërkohet balancë mes zhvillimit dhe ruajtjes së vlerave historike.

Sipërfaqet ujore lidhen me përdorime tradicionale, edhe pse nuk përmenden drejtpërdrejt. Zonat arkeologjike dhe historike lejojnë vetëm aktivitete që ruajnë harmoninë vizuale, si shërbime kulturore dhe bujqësi vetjake, ndërsa restaurimi i kullave dhe mullinjve ruan identitetin historik. Për zonën e veçantë të Mbrojtur-Manastiri i Deçanit i mbrojtur nga UNESCO, Plani parasheh mbrojtje të rreptë për trashëgiminë kulturore dhe natyrore, duke ndaluar ndërtimet e larta dhe industrinë e rëndë pranë monumenteve.

ii. Ndikimet (N)

Tabela 26: Trashëgimia kulturore

Faktori mjedisor I: Trashëgimia kulturore	IO1	
Zonë banimi rurale	+	-
Zonë banimi urbane	+	-
Zonë banimi sub-urbane	+	-
Zonë e shfrytëzimit të përzier	+	-

Zonë bujqësore	+	
Zonë pyjore	+	
Zonë industriale	0	
Zonë komerciale	+	-
Zonë e komunikacionit – transportit	0	
Zonë turistike	+	-
Zonë mbrojtur	++	
Zonë e mbrojtur arkeologjike – historike	++	
Sipërfaqe ujore	0	
Zonë minierë sipërfaqësore – gurthyes	0	
Zonë e shërbimeve	+	
Zonat mbishtresore	+	-

IO1. Ruajtja e monumenteve dhe zonave historike.

++	Pozitiv i rëndësishëm	HZK-ja ka të ngjarë të ketë një ndikim pozitiv të konsiderueshëm mbi qëllimet e VSM-së.
+	Pozitiv	HZK-ja ka të ngjarë të ketë një efekt të vogël pozitiv në objektivat e VSM-së.
0	Neutral	HZK-ja M ka të ngjarë të ketë një efekt neutral në objektivat e VSM-së.
-	Negativ	HZK-ja ka të ngjarë të ketë një efekt të vogël negativ në objektivat e VSM-së.
--	Negativ i rëndësishëm	HZK-ja ka të ngjarë të ketë një efekt negativ të rëndësishëm në objektivat e VSM-së.
?	I pasigurt	Efektet e PNKMIM-it në objektivat e VSM janë të pasigurta në këtë fazë.

Zonat e mbrojtura dhe ato arkeologjike-historike kanë një ndikim shumë të rëndësishëm pozitiv mbi objektivin e VSM-së. Këto zona përfshijnë qytetin e vjetër të Deçanit, monumentet historike, manastiret dhe zonat e mbrojtura nga UNESCO. Kufizimet e ndërtimit, procedurat e restaurimit dhe mbrojtja ligjore sigurojnë ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe integrimin e saj në planifikimin urban pa dëmtuar vlerat ekzistuese.

Zonat e banimit, ato të shfrytëzimit të përzier, komerciale, turistike dhe zonat mbishtresore vlerësohen me ndikim të përzier. Zonat urbane me funksione të përziera, si banimi, komercialja dhe turizmi, shpesh krijojnë gjallëri dhe dinamizëm që ndikon pozitivisht në trashëgiminë kulturore. Zhvillimi ekonomik dhe turizmi i gjeneruar nga këto zona rrit interesin e publikut dhe institucioneve për ruajtjen e monumenteve historike. Përzierja e funksioneve urbane nxit investime në restaurim dhe promovim, duke i dhënë objekteve kulturore një rol më aktiv në jetën e qytetit. Kjo gjallëri urbane e bën trashëgiminë kulturore pjesë të përditshmërisë së komunitetit, duke e integruar atë në hapësirat ku njerëzit jetojnë, punojnë dhe argëtohen. Megjithëse zonat urbane me funksione të përziera mund të sjellin gjallëri dhe zhvillim, ato shpesh bartin edhe pasoja të padëshiruara për trashëgiminë kulturore. Ndërtimet e reja dhe betonizimi i tepruar prishin harmoninë vizuale të qytetit, duke zbehur vlerën historike të monumenteve. Presioni i turizmit dhe komercializimit shpesh e shndërron trashëgiminë kulturore në një produkt tregtar, gjë që mund të çojë në degradim fizik dhe humbje të autenticitetit.

Zonat bujqësore, pyjore, zonat e shërbimeve kanë një efekt pozitiv, por më të moderuar, pasi që këto hapësira shpesh ndihmojnë në ruajtjen e peizazhit natyror dhe të ekuilibrit ekologjik, duke krijuar një mjedis të qëndrueshëm ku trashëgimia kulturore mund të mbrohet më lehtë. Përmes gjelbërimit dhe përdorimit të kujdesshëm të tokës, ato kontribuojnë në ruajtjen e harmonisë vizuale dhe në mbështetjen e identitetit historik të zonave, pa ushtruar presion të madh urban mbi monumentet dhe hapësirat tradicionale

Zonat tjera kanë një efekt neutral, pasi që ato janë të lokalizuara në zona jashtë atyre me vlerë të trashëgimisë.

iii. Receptorët (R) e afektuar

Receptorët e afektuar nga zbatimi i Hartës zonale të Deçanit prek receptorë të ndjeshëm që lidhen me identitetin historik dhe kulturor të zonës.

IR1. Monumentet historike – kisha, xhami, ura dhe objekte të trashëgimisë arkitektonike që mund të dëmtohen nga ndërtimet e reja.

IR2. Lokalitetet arkeologjike – vendbanime të lashta dhe sitet që kanë vlera shkencore e kulturore.

IR3. Panoramat kulturore – peizazhet që lidhen me trashëgiminë historike dhe identitetin lokal.

IR4. Komunitetet lokale – humbja e trashëgimisë ndikon në identitetin kulturor dhe në atraktivitetin turistik.

IR5. Turizmi kulturor – zhvillimi ekonomik i lidhur me vizitorët që kërkojnë përvoja autentike.

4.2.10. Faktori mjedisor J: Peizazhi dhe vlerat vizuale estetike

Analizon ndikimet vizuale të projekteve mbi peizazhet natyrore dhe urbane. Ky faktor është i lidhur ngushtë me turizmin, ekonominë lokale dhe mirëqenien e popullsisë, sepse peizazhi dhe estetika vizuale janë elementë që ndikojnë drejtpërdrejt në perceptimin e cilësisë së jetës dhe atraktivitetin e zonës.

i. Përshkrim i përbledhur i zhvillimeve të planifikuara nga HZK-ja

HZK-ja parashikon që çdo zonë të zhvillohet duke ruajtur peizazhin natyror dhe estetikën vizuale.

Në zonat rurale, arkitektura duhet të jetë tradicionale për të ruajtur karakterin e peizazhit, ndërsa serat dhe fermat lejohen vetëm me kufizime që sigurojnë harmoninë vizuale. Zonat sub-urbane parashikohen me arkitekturë bashkëkohore miqësore ndaj mjedisit, duke ndaluar stilet klasike e neoklasike për të mos prishur harmoninë. Zonat urbane duhet të kenë planifikim të përshtatur me relievin natyror dhe arkitekturë moderne që ruan estetikën, sidomos në qendrën historike.

HZK-ja parashikon që zonat bujqësore, pyjore dhe turistike të kontribuojnë në peizazhe të pasura e të integruara, ku ndërtimet duhet të jenë të lidhura me mjedisin, si bujtinat prej druri në pyje apo gjelbërimi dekorativ në zonat turistike. Zonat e mbrojtura si Parku Kombëtar, Gryka e Deçanit dhe Manastiri i Deçanit kanë mbrojtje të rreptë, duke ndaluar çdo ndërtim që cenon panoramat kulturore dhe vizuale.

Në zonat industriale ndikimi vizual është i kufizuar, pasi ato parashikohen larg banimit dhe me arkitekturë funksionale, ndërsa sipërfaqet ujore ruajnë vlera estetike përmes brezave të gjelbër. Minierat sipërfaqësore parashikohen si problematike, me ndikim negativ të madh vizual, edhe pse brezat mbrojtës e zbusin disi. Zonat mbishtresore parashikohen me masa kundër erozionit dhe pyllëzim për të përmirësuar estetikën e mjedisit

ii. Ndikimet (N)

Tabela 27 : Peizazhi dhe vlerat vizuale estetike

Faktori mjedisor J: Peizazhi dhe vlerat vizuale estetike	J01	
Zonë banimi rurale	+	
Zonë banimi urbane	+	-
Zonë banimi sub-urbane	+	-
Zonë e shfrytëzimit të përzier	+	-
Zonë bujqësore	++	
Zonë pyjore	++	
Zonë industriale	0	
Zonë komerciale	+	-
Zonë e komunikacionit – transportit	0	
Zonë turistike	+	-
Zonë mbrojtur	++	
Zonë e mbrojtur arkeologjike – historike	++	
Sipërfaqe ujore	++	
Zonë minierë sipërfaqësore – gurthyes	--	
Zonë e shërbimeve	0	

Zonat mbishtresore		+
J01. Ruajtja e peizazheve natyrore dhe panoramave kulturore.		
++	Pozitiv i rëndësishëm	HZK-ja ka të ngjarë të ketë një ndikim pozitiv të konsiderueshëm mbi qëllimet e VSM-së.
+	Pozitiv	HZK-ja ka të ngjarë të ketë një efekt të vogël pozitiv në objektivat e VSM-së.
0	Neutral	HZK-ja M ka të ngjarë të ketë një efekt neutral në objektivat e VSM-së.
-	Negativ	HZK-ja ka të ngjarë të ketë një efekt të vogël negativ në objektivat e VSM-së.
--	Negativ i rëndësishëm	HZK-ja ka të ngjarë të ketë një efekt negativ të rëndësishëm në objektivat e VSM-së.
?	I pasigurt	Efektet e PNKMIM-it në objektivat e VSM janë të pasigurta në këtë fazë.

Zonat bujqësore, pyjore, të mbrojtura, arkeologjike-historike, sipërfaqet ujore kanë ndikim të rëndësishëm pozitiv. Këto zona ruajnë peizazhe natyrore unike, panoramat kulturore dhe estetikën vizuale duke integruar arkitekturën tradicionale me mjedisin. Zonat rurale japin një efekt pozitiv mbi objektivat. Arkitektura tradicionale ose bashkëkohore miqësore ndaj mjedisit, gjelbërimi dekorativ dhe kufizimet për ndërtimet moderne ndihmojnë në ruajtjen e harmonisë vizuale, edhe pse ka raste me ndikime të vogla (si serat plastike apo ndërtimet alpine).

Për zonat urbane dhe sub-urbane, ato me shfrytëzim të përzier, zonat turistike si dhe komerciale, HZK-ja ofron një potencial të madh pozitiv, por ky rezultat është i varur nga zbatimi i rreptë i rregullave të planifikimit dhe arkitekturës. Në mungesë të respektimit, ndikimi mund të kthehet në negativ dhe të dëmtojë qëllimet e ruajtjes së peizazhit dhe estetikës vizuale.

Zonat industriale dhe të komunikacionit-transportit kanë ndikim neutral. Këto zona nuk kontribuojnë drejtpërdrejt në ruajtjen e peizazheve natyrore, por as nuk i dëmtojnë ndjeshëm, pasi janë të vendosura në mënyrë të kontrolluar dhe me funksione kryesisht praktike.

Zona e minierave sipërfaqësore-gurthyesit ka ndikim negativ të madh vizual dhe estetik. Edhe pse brezat mbrojtës zbusin disi efektin, degradimi i peizazhit dhe panoramave kulturore është i konsiderueshëm, duke sjellë një vlerësim negativ të rëndësishëm.

iii. Receptorët (R) e afektuar

Receptorët e afektuar nga zbatimi i Hartës zonale të Deçanit lidhen me ruajtjen e pamjes natyrore, panoramave kulturore dhe cilësinë vizuale të mjedisit urban

JR1. Peizazhet natyrore – male, fusha, pyje dhe zona të mbrojtura që mund të humbasin vlerën estetike nga urbanizimi.

JR2. Panoramat kulturore – trashëgimia vizuale e lidhur me monumentet, arkitekturën tradicionale dhe pamjet historike.

JR3. Komunitetet lokale – cilësia e jetës ndikohet nga pamja e mjedisit ku jetojnë.

JR4. Turizmi – ruajtja e peizazhit është e rëndësishme për atraktivitetin turistik dhe zhvillimin ekonomik lokal.

4.2.11. Faktori mjedisor K: Menaxhimi i mbeturinave

Përshkruan sistemet e grumbullimit, riciklimit dhe trajtimit të mbeturinave. Ky faktor është i lidhur ngushtë me shëndetin publik, cilësinë e ajrit, ujërave dhe tokës, duke qenë një element kyç për menaxhimin e qëndrueshëm mjedisor.

i. Përshkrim i përmbledhur i zhvillimeve të planifikuara nga HZK-ja

HZK-ja parashikon menaxhimin e mbeturinave duke përcaktuar masa të ndryshme.

Në zonat rurale nuk ka masa të qarta, por krahasuar me zonat urbane dhe sub-urbane ku parashikohet ndërtimi i infrastrukturës për grumbullim, riciklim, kompostim si dhe trajtim të mbeturinave të rrezikshme, duke siguruar menaxhim të plotë për shkak të dendësisë së lartë.

Zonat bujqësore gjenerojnë mbeturina organike që mund të shfrytëzohen për kompostim ose bioenergji, por kërkohet kujdes për të shmangur ndotjen e tokës dhe ujërave. Në zonat pyjore theksohet nevoja për ndotje minimale, ndërsa në zonat turistike menaxhimi i mbeturinave është i integruar në infrastrukturë për të ruajtur pastërtinë dhe mjedisin.

HZK-ja parashikon që industria e lehtë të përfshijë sektorin e riciklimit dhe ambalazhimit, duke kontribuar pozitivisht, por njëkohësisht ekziston rreziku i ndotjes nga aktivitetet industriale. Në sipërfaqet ujore ndalohet depozitimi i mbeturinave dhe materialeve të rrezikshme, duke lejuar vetëm menaxhim të kontrolluar për rehabilitim.

Ndalohet krijimi i deponive të pakontrolluara për të shmangur ndotjen. Zonat mbishtresore parashikojnë masa për riciklim dhe pastrimin e kanaleve, duke siguruar mbrojtjen e mjedisit.

ii. Ndikimet (N)

Tabela 28: Menaxhimi i mbeturinave

Faktori mjedisor K: Menaxhimi i mbeturinave		K02		K02	
Zonë banimi rurale		+	-	+	-
Zonë banimi urbane		+	-	+	-
Zonë banimi sub-urbane		+	-	+	-
Zonë e shfrytëzimit të përzier		+	-	+	-
Zonë bujqësore		+	-	+	-
Zonë pyjore		0		0	
Zonë industriale		+	-	+	-
Zonë komerciale		+	-	+	-
Zonë e komunikacionit – transportit		-		0	
Zonë turistike		+	-	0	
Zonë mbrojtur		0		0	
Zonë e mbrojtur arkeologjike – historike		0		0	
Sipërfaqe ujore		+	-	0	
Zonë minierë sipërfaqësore – gurthyes		-		0	
Zonë e shërbimeve		+	-	+	-
Zonat mbishtresore		0		0	
K01. Reduktimi i të gjitha llojeve të mbeturinave K02. Trajtim i sigurt i mbeturinave të rrezikshme.					
++	Pozitiv i rëndësishëm	HZK-ja ka të ngjarë të ketë një ndikim pozitiv të konsiderueshëm mbi qëllimet e VSM-së.			
+	Pozitiv	HZK-ja ka të ngjarë të ketë një efekt të vogël pozitiv në objektivat e VSM-së.			
0	Neutral	HZK-ja M ka të ngjarë të ketë një efekt neutral në objektivat e VSM-së.			
-	Negativ	HZK-ja ka të ngjarë të ketë një efekt të vogël negativ në objektivat e VSM-së.			
--	Negativ i rëndësishëm	HZK-ja ka të ngjarë të ketë një efekt negativ të rëndësishëm në objektivat e VSM-së.			
?	I pasigurt	Efektet e PNKMIM-it në objektivat e VSM janë të pasigurta në këtë fazë ose nuk përmenden			

Shumica e zonave vlerësohen me ndikime të përziera në raport me arritjen e objektivave mjedisore. Zonat e banimit, të shfrytëzimit të përzier, komerciale, turistike kanë ndikim pozitiv, sepse parashikohet ndërtimi i infrastrukturës për riciklim, kompostim dhe trajtim të mbetjeve të rrezikshme. Kjo është veçanërisht e domosdoshme për zonat me dendësi të lartë, ku menaxhimi i mbeturinave është kritik. Megjithatë, prodhimi i madh i mbeturinave shtëpiake dhe mungesa e ndarjes së tyre në burim shpesh e vështirësojnë realizimin e objektivit KO1 për reduktimin e të gjitha llojeve të mbeturinave. Po ashtu, prania e mbeturinave të rrezikshme në jetën e përditshme, si bateritë, ilaçet e skaduara apo detergjentët kimikë, kur përzihen me mbeturinat e zakonshme, krijon rrezik për shëndetin dhe mjedisin, duke e bërë më të ndërlikuar arritjen e objektivit KO2 për trajtim të sigurt. Kështu, edhe pse zonat e banimit ofrojnë potencial të madh për menaxhim të qëndrueshëm, ato

mbeten një sfidë e vazhdueshme që kërkon infrastrukturë të fortë dhe vetëdijesim të komunitetit. Infrastruktura e transportit gjeneron mbeturina nga mirëmbajtja e rrugëve, vakra të përdorur apo pjesë të konsumuar, të cilat e vështirësojnë realizimin e objektivit KO1. Aktivitetet bujqësore gjenerojnë mbeturina organike që, nëse menaxhohen siç duhet, mund të shfrytëzohen për kompostim ose bioenergji, duke reduktuar mbeturinat. Megjithatë, në mungesë të menaxhimit të kujdesshëm, ato rrezikojnë të ndotin tokën dhe ujërat. Edhe zona industriale ka ndikim të përzier: nga njëra anë, përfshirja e sektorit të riciklimit dhe ambalazhimit kontribuon në uljen e mbeturinave, por nga ana tjetër, potenciali ndotës i industrive e bën këtë zonë të rrezikshme për KO2 nëse nuk respektohen kufizimet e përcaktuara.

Zonat e mbrojtura, arkeologjike-historike dhe zonat pyjore kanë një efekt kryesisht neutral në menaxhimin e mbeturinave. Këto hapësira nuk gjenerojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë sasi të mëdha mbeturinash, pasi aktivitetet zhvillimore janë të kufizuara dhe të kontrolluara. Megjithatë, ato nuk kontribuojnë as në mënyrë të dukshme në reduktimin apo trajtimin e mbeturinave, duke mbetur më tepër zona ku ndikimi është i balancuar. Ky neutralitet reflekton faktin se ruajtja e tyre lidhet më shumë me mbrojtjen e mjedisit natyror dhe trashëgimisë kulturore, sesa me menaxhimin aktiv të mbeturinave.

Dheu nga aktivitetet e gurthyesit trajtohet si mbeturinë minerare dhe kërkon menaxhim të posaçëm për të shmangur ndikimet negative në mjedis.

iii. Receptorët (R) e afektuar

Receptorët e afektuar nga zbatimi i Hartës zonale të Deçanit lidhen me cilësinë e tokës, ujërave, ajrit dhe shëndetin e komunitetit.

KR1. Tokat bujqësore dhe urbane – ndotja nga depozitimi i pakontrolluar i mbeturinave.

KR2. Burimet ujore – infiltrimi i substancave të rrezikshme nga mbeturinat.

KR3. Ajri – ndotja nga djegia e mbeturinave dhe gazrat e lëshuara.

KR4. Popullsia lokale – ndikimi në shëndetin publik dhe cilësinë e jetës.

KR5. Ekosistemet natyrore – humbja e biodiversitetit nga ndotja e mjedisit.

4.2.12. Faktori mjedisor L: Trafiku dhe transporti

Vlerëson ndikimet nga lëvizja e njerëzve dhe mallrave, ndotjen dhe zhurmën e lidhur me transportin. Ky faktor është i lidhur ngushtë me cilësinë e ajrit, shëndetin publik dhe mirëqenien e popullsisë, duke qenë një element kyç për zhvillimin e qëndrueshëm urban.

i. Përshkrim i përmbledhur i zhvillimeve të planifikuara nga HZK-ja

HZK-ja ka bërë përcaktimin që infrastruktura e trafikut dhe transportit të zhvillohet në mënyrë të diferencuar sipas tipologjisë së zonave, duke synuar lëvizshmëri të qëndrueshme dhe reduktim të trafikut privat.

Në zonat rurale, rrugët, trotualet dhe shtigjet për çiklistë parashihet të lehtësojnë lidhjen e fshatrave me qytetin dhe komunat fqinje, duke promovuar transportin publik dhe alternativ. Zona sub-urbane mbështetet nga rrjeti rrugor i asfaltuar dhe ndriçuar, si dhe stacionet e shërbimit, që sigurojnë qasje të mirë me zonën urbane dhe qendrore. Në zonën urbane, qyteti kompakt dhe dendësia e lartë favorizojnë përdorimin e transportit publik, me stacion autobusi, parkingje dhe garazhe publike, duke reduktuar trafikun e pakontrolluar.

Zonat bujqësore kërkojnë infrastrukturë funksionale për transportin e produkteve drejt tregjeve urbane, ndërsa zonat pyjore lejojnë shfrytëzimin e rrugëve për menaxhimin e pyjeve dhe hapjen e shtigjeve për ecje. Në zonat turistike, shtigjet për ecje e çiklizëm dhe parkingjet sigurojnë qasje të lehtë

për vizitorët, duke promovuar turizmin e qëndrueshëm. Zona industriale kërkon infrastrukturë moderne për logjistikë dhe distribuim, duke përfshirë qendra shërbimi për eksport.

Në sipërfaqet ujore, ndalohet lëvizja e automjeteve të paautorizuara dhe ndërtimi i rrugëve pa drenazh, për të mbrojtur cilësinë e ujit. Zona e minierave sipërfaqësore-gurthyesit ka kufizime të rrepta, duke ndaluar zhvillimin e aktivitetit të saj pranë rrugëve kryesore për të shmangur dëmtimin e infrastrukturës. Ndërsa në zonat mbishtresore, ndalohet ndërtimi i rrugëve të mëdha pranë zonave të mbrojtura dhe kërkohet qasje e kontrolluar, e përshtatur për turizëm të qëndrueshëm, duke shmangur rrezikun e përmytjeve dhe erozionit.

ii. Ndikimet (N)

Tabela 29 : Trafiku dhe transporti

Faktori mjedisor L: Trafiku dhe transporti	LO1		LO2
Zonë banimi rurale	+		0
Zonë banimi urbane	+	-	++
Zonë banimi sub-urbane	+	-	+
Zonë e shfrytëzimit të përzier	+	-	+
Zonë bujqësore	0		0
Zonë pyjore	0		+
Zonë industriale	-		+
Zonë komerciale	+	-	+
Zonë e komunikacionit – transportit	++		++
Zonë turistike	+	-	+
Zonë mbrojtur	+		+
Zonë e mbrojtur arkeologjike – historike	+		+
Sipërfaqe ujore	+		+
Zonë minierë sipërfaqësore - gurthyes	-		0
Zonë e shërbimeve	0		0
Zonat mbishtresore	+		+

LO1. Ulja e trafikut privat për të reduktuar ndotjen; LO2. Promovimi i transportit publik dhe alternativave të transportit të pa-motorizuar.

++	Pozitiv i rëndësishëm	HZK-ja ka të ngjarë të ketë një ndikim pozitiv të konsiderueshëm mbi qëllimet e VSM-së.
+	Pozitiv	HZK-ja ka të ngjarë të ketë një efekt të vogël pozitiv në objektivat e VSM-së.
0	Neutral	HZK-ja M ka të ngjarë të ketë një efekt neutral në objektivat e VSM-së.
-	Negativ	HZK-ja ka të ngjarë të ketë një efekt të vogël negativ në objektivat e VSM-së.
--	Negativ i rëndësishëm	HZK-ja ka të ngjarë të ketë një efekt negativ të rëndësishëm në objektivat e VSM-së.
?	I pasigurt	Efektet e PNKMIM-it në objektivat e VSM janë të pasigurta në këtë fazë ose nuk përmenden

Në zonat rurale, ndikimi është pozitiv sepse rrugët, trotualet dhe shtigjet për çiklistë lehtësojnë transportin publik dhe alternativ, duke lidhur fshatrat me qytetin.

Në zonat urbane dhe sub-urbane, zonat turistike, komerciale, shfrytëzimit të përzier, ndikimi është i dyanshëm. Pozitiv sepse mbështetet nga rrjeti rrugor i asfaltuar dhe stacionet e shërbimit, që sjell përfitime të dukshme për lëvizshmërinë dhe promovimin e transportit publik, por nga ana tjetër, negativ sepse ndërtimi i rrugëve njëkohësisht krijon edhe rreziqe për rritjen e trafikut privat dhe ndotjes. Në zonën urbane, qyteti kompakt dhe infrastruktura e transportit publik japin ndikim shumë pozitiv, por ndërtimi i parkingjeve dhe garazheve mund të nxisë përdorimin e automjeteve private. Ndërsa në zonat turistike, shtigjet për ecje dhe çiklizëm japin efekt pozitiv, por ndërtimi i rrugëve dhe parkingjeve mund të shtojë trafikun privat dhe presionin mbi mjedisin.

Në zonat pyjore, shtigjet për ecje dhe qasja e kontrolluar kontribuojnë në transport pa motorizuar. Zonat e mbrojtura dhe arkeologjike-historike ruajnë transportin e qëndrueshëm përmes qasjes së kontrolluar.

Në sipërfaqet ujore, ndalohet lëvizja e automjeteve të paautorizuara për të mbrojtur cilësinë e ujit.

iii. Receptorët (R) e afektuar

Receptorët e afektuar nga zbatimi i Hartës zonale të Deçanit lidhen me cilësinë e ajrit, nivelin e zhurmës, konsumin e energjisë dhe cilësinë e jetës së komunitetit.

LR1. Popullsia lokale – ekspozimi ndaj ndotjes së ajrit dhe zhurmës e shkaktuar nga trafiku.

LR2. Mjedisi urban – rritja e trafikut sjell konsum të lartë energjie dhe ul cilësinë e jetës.

LR3. Ekosistemet natyrore – ndikohen nga ndotja e ajrit dhe fragmentimi i habitateve për shkak të infrastrukturës rrugore.

LR4. Ekonomia lokale – transporti i mallrave dhe njerëzve ndikon në efikasitetin ekonomik, por mund të sjellë presion mbi burimet.

4.3. Gjetjet kryesore mbi efektet e pritshme nga zbatimi i HZK-së

Zonat që shfaqin ndikime negative të rëndësishme dhe negative mbi objektivat e VSM-së janë kryesisht të lidhura me aktivitetet urbane, industriale dhe minerare, si dhe me zonat mbishtresore që ndërlihen me rreziqet e klimatike.

- **Zonat urbane të banimit** shfaqin ndikime negative (-) në disa faktorë mjedisorë, si cilësia e tokës, ajri dhe ndryshimet klimatike. Dendësia e lartë e ndërtimeve, trafiku dhe ngrohja me lëndë djegëse fosile rrisin presionin mbi mjedisin dhe shëndetin publik.
- **Zonat industriale** kanë ndikime negative (-) mbi tokën, ajrin, zhurmën dhe klimën, për shkak të ndotjes kimike, emisioneve dhe aktivitetit mekanik. Edhe pse të lokalizuara, ato kontribuojnë në degradim dhe kërkojnë masa mbrojtëse të forta.
- **Sipërfaqet ujore**, kur ndoten nga ujërat e zeza ose përdorimi i pesticideve, kanë ndikime negative (-) mbi tokën dhe shëndetin publik, duke rrezikuar cilësinë e ujit dhe ushqimit.
- **Zonat e komunikacionit dhe transportit** shfaqin ndikime negative (-) mbi ajrin dhe zhurmën, për shkak të trafikut dhe asfaltimit, duke rritur ndotjen atmosferike dhe akustike.
- **Zonat komerciale dhe turistike** tregojnë ndikime negative (-) në ajër, zhurmë dhe biodiversitet, sidomos kur aktivitetet nuk menaxhohen me kujdes, duke gjeneruar ndotje dhe presion mbi habitate.
- **Minierat sipërfaqësore (gurthyesit)** paraqesin ndikime negative (-) mbi tokën dhe biodiversitetin, duke rrezikuar fragmentimin e ekosistemeve dhe cilësinë e habitateve.
- **Zonat me rrëshqitje të dheut dhe erozion dhe rrezik nga përmytjet** kanë ndikime negative (-) mbi tokën, duke ulur pjellorinë dhe rritur rrezikun e degradimit.

V. VLERËSIMI I EFEKTEVE MJEDISORE DHE MASAT E PARASHIKUARA

5.1 Masat e parapara lehtësuese për eliminimin apo zbutjen e efekteve të mundshme negative të shkaktuara nga zbatimi i HZK-së

Masat zbutëse të propozuara fokusohen në përmirësimin e menaxhimit të burimeve, kontrollin e ndotjes, rehabilitimin e zonave të degraduara, si dhe në promovimin e praktikave të qëndrueshme në zonat zhvillimet e të cilave pritet të kenë ndikim negativ në objektivat e VSM-së. Këto masa përfshijnë ndërhyrje teknike, planifikuese dhe ndërgjegjësuere, me qëllim reduktimin e ndikimeve negative dhe rritjen e qëndrueshmërisë mjedisore dhe cilësisë së jetës në komunë.

Tabela 30: Tabela përmbledhëse e efekteve dhe masat zbutëse

Kategoria e zonës	Efektet kryesore negative	Masat zbutëse të përshtatshme
Zonat urbane të banimit	<p>Ndotje e ajrit sidomos nga përdorimi i lëndëve djegëse, transporti dhe aktivitetet e ndërtimit;</p> <p>Degradim i tokës dhe peizazhit urban nga ndërtimet, mbeturinat urbane;</p> <p>Gjenerim mbeturinash urbane dhe të rrezikshme.</p> <p>Zhurmë;</p> <p>Presion mbi shëndetin publik;</p> <p>Efektet e “urban heat island” – (rritja e temperaturave lokale për shkak të betonizimit dhe mungesës së gjelbërimit).</p>	<p>Rritja e sipërfaqeve gjelbëruese urbane</p> <p>Investime në energji të rinovueshme (diellore) dhe masa për eficiencë energjie në ndërtesa, për të reduktuar varësinë nga lëndët fosile.</p> <p>Nxitja e transportit publik dhe jomotorik (biçikleta, ecje) për të ulur trafikun.</p> <p>Planifikim urban me dendësi të kontrolluar për të shmangur betonizimin e tepruar.</p> <p>Vendosja e sistemit të ndarjes së mbeturinave në burim dhe investime në riciklim</p> <p>Kufizimi i ndërtimeve të larta në zona me peizazh të veçantë, për të mos prishur harmoninë vizuale dhe panoramat natyrore.</p> <p>Monitorim dhe pastrim i deponive ilegale; ndërtim i impiantit për trajtimin e mbeturinave të rrezikshme.</p> <p>Vendosja e barrierave akustike dhe kufizimi i orareve të punimeve për reduktim të zhurmës.</p> <p>Sigurimi i hapësirave të gjelbra për aktivitet fizik, duke kontribuar në mirëqenie fizike e psikologjike.</p> <p>Menaxhim i rrezikut nga të nxehtit ekstrem, për mbrojtje të komuniteteve urbane.</p> <p>Rritja e sipërfaqeve gjelbëruese urbane për të përmirësuar ajrin dhe ulur efektin e “heat island”.</p>
Zonat industriale	<p>Dëmtim i cilësisë së dheut për shkak të ndotjes kimike dhe mbeturinave industriale.</p> <p>Ndotje e ajrit nga emisionet e proceseve prodhuese.</p> <p>Degradim i peizazhit dhe biodiversitetit për shkak të aktivitetit industrial.</p> <p>Emetime akustike nga makineritë dhe proceset prodhuese.</p>	<p>Zbatim i standardeve mjedisore për të siguruar përputhshmëri ligjore dhe ekologjike.</p> <p>Menaxhim i mbeturinave industriale dhe ndarja e tyre në burim për riciklim.</p> <p>Monitorim i ndotjes së tokës dhe ujit për të siguruar kontroll të vazhdueshëm.</p> <p>Rehabilitimi i zonave të dëmtuara vizualisht për të rikthyer peizazhin.</p> <p>Përdorimi i teknologjive të pastra dhe të qeta për të ulur ndotjen dhe zhurmën.</p> <p>Zonim i kontrolluar dhe distancim nga zonat e banimit për të mbrojtur komunitetin lokal.</p>
Sipërfaqet ujore	<p>Ndotje nga ujërat e zeza urbane dhe industriale apo aktivitetet komerciale</p> <p>Kontaminim nga pesticide dhe plehra kimike që përdoren në bujqësi;</p>	<p>Mbulimi me rrjet kanalizimi i të gjitha vendbanimeve</p> <p>Instalimi i sistemeve të trajtimit të ujërave të zeza, për të shmangur ndotjen e burimeve ujore.</p> <p>Ndalimi ose reduktimi i pesticideve kimike dhe promovimi i bujqësisë organike.</p>

	<p>Ndotje nga hedhja e mbeturinave të zakonshme, sidomos pecetat e lagëta</p> <p>Degradim i ekuilibrit hidrologjik nga mbipërdorimi ose menaxhimi i dobët.</p> <p>Rreziku nga ndryshimet klimatike (vërshimet, thatësirat)</p>	<p>Pastrimi i deponive ilegale pranë lumenjve dhe liqeneve. Fushata për reduktimin e përdorimit të pecetave të lagëta dhe promovimi i alternativave të biodegradueshme.</p> <p>Breza mbrojtës përgjatë trupave ujorë Monitorim i vazhdueshëm i cilësisë së ujit sipërfaqësor dhe nëntokësor Investime në sisteme të ujitjes efikase për të shmangur mbipërdorimin e ujit.</p> <p>Ndërgjegjësim i komunitetit lokal për ruajtjen e pastërtisë së ujit dhe raportimin e ndotjes.</p>
Zonat e komunikacionit dhe transportit	Ndotje e ajrit; zhurmë	<p>Nxitja e përdorimit të transportit publik dhe alternativ-jomotorik (biçikleta, ecje) Mbjellje e brezave të gjelbër përgjatë rrugëve Menaxhim i trafikut për reduktim të trafikut të ngjeshur Vendosja e barrierave akustike pranë rrugëve kryesore për të ulur ndikimin e trafikut mbi zonat e banuara (ku është e nevojshme)</p>
Zonat komerciale dhe turistike	Ndotje e ajrit dhe zhurmë; presion mbi biodiversitetin	<p>Planifikim i qëndrueshëm turistik dhe promovim i turizmit ekologjik Kontroll i kapaciteteve zhvillimore dhe kufizim i ndërtimeve në zona të ndjeshme Menaxhim i turizmit të qëndrueshëm në zonat e mbrojtura, duke balancuar zhvillimin ekonomik me ruajtjen e ekosistemeve natyrore Menaxhim i mbeturinave Mbështetje për bizneset e vogla që përdorin praktika të gjelbra dhe ekonominë qarkore, duke nxitur modele të reja të prodhimit e konsumit që reduktojnë mbeturinat dhe rrisin efikasitetin Kufizime për ngjarjet turistike dhe rekreative (koncerte, festivale), duke vendosur standarde për oraret dhe intensitetin e zhurmës Krijimi i korridoreve ekologjike për lidhjen e habitateve, duke mundësuar lëvizjen e lirë të specieve dhe rritjen e diversitetit biologjik Ndërprerja e aktiviteteve të dëmshme në zonat e mbrojtura, si shfrytëzimi i pakontrolluar i burimeve natyrore, gjuetia ilegale apo ndërtimet, për të ruajtur ekuilibrin ekologjik Kufizimi i ndërtimeve të larta në zona me peizazh të veçantë, për të mos prishur harmoninë vizuale dhe panoramat natyrore</p>
Miniera sipërfaqësore (gurthyesit)	Degradim i tokës; humbje e biodiversitetit; fragmentim i habitateve	<p>Kufizim i zgjerimit të aktivitetit Monitorim i ndikimeve mjedisore Brez mbrojtës gjelbërues nga kufijtë e vendbanimeve përreth</p>
Zonat mbishtresore_ Përmbytjet, rrëshqitja e	Degradim i terrenit; rrezik për banoret, tokat dhe kulturat bujqesore si dhe per infrastrukturën	<p>Ndërtimi i digave mbrojtëse, pastrim i kanaleve kulluese, rregullim i shtratit të lumenjve Pyllëzim në zonat me erozion të mesëm Stabilizimin e terrenit me rrëshqitje të dheut përmes mbjelljes së bimësisë dhe teknikave inxhinierike</p>

dheut dhe erozion		
Zonat bujqësore	Ndotje e tokës dhe ujërave nga pesticidet dhe plehrat kimike; Degradim i strukturës së tokës; Humbje e biodiversitetit; Emisione të gazrave serrë (NH ₃ , N ₂ O)	Përdorim i kontrolluar i pesticideve dhe plehrave Monitorim i cilësisë së tokës dhe ujit (kryerja e analizave periodike për të identifikuar ndotjet dhe për të siguruar përdorim të qëndrueshëm të burimeve) Adaptimi i bujqësisë ndaj kushteve klimatike, përmes kulturave rezistente dhe sistemeve të zgjuar të ujitjes. Zbatimin e praktikave të bujqësisë së qëndrueshme (Rotacioni i kulturave, përdorimi i plehrave organike dhe teknika konservuese të punimit të tokës) Kufizimin e ndërtimeve në tokat pjellore (ruajtja nga urbanizimi dhe ndërtimet pa leje) Trajnim dhe ndërgjegjësim i fermerëve (programe edukative për teknika të gjelbra dhe menaxhim efikas të burimeve) Fushata të ndërgjegjësimit publik për përdorimin e qëndrueshëm të tokës dhe praktikave miqësore me mjedisin. Menaxhim të mbeturinave bujqësore për kompostim, duke i kthyer ato në burime të dobishme për bujqësinë dhe energjinë.

VI. PLANI I MONITORIMIT TË ZBATIMIT TË MASAVE

Plani i monitorimit të zbatimit të masave synon të sigurojë ndjekjen e vazhdueshme të progresit, përcaktojë afatet, identifikojë treguesit matës dhe përcaktojë përgjegjësit për realizimin e tyre.

Tabela 31 : Plani për monitorimin e zbatimit të masave dhe menaxhim mjedisor

Kategoria e zonës: Zona urbane e banimit		Objektivi I VSM: A01, A02, C01, F02, J01	
Masat kryesore	Afatet	Indikatorët matës	Institucionet përgjegjëse
Rritje e sipërfaqeve të gjelbra dhe hapësira për aktivitet fizik.	Afatmesëm (3-5 vite)	Sipërfaqe e gjelbër shtuar; numri i hapësirave të reja për rekreacion	Komuna/drejtoria e urbanizmit dhe mbrojtjes së mjedisit
Investime në energji diellore dhe eficiencë në ndërtesa	Afatgjatë (deri 10 vite)	% e energjisë së rinovueshme; Numri i ndërtesave me standarde eficiencë	Komuna/drejtoria për shërbime publike, Fondi Kosovar për eficiencë të energjisë
Nxitja e transportit publik, biçikletave dhe ecjes	Afatmesëm (3-5 vite)	Reduktim i trafikut; rritje e përdorimit të transportit publik/jomotorik	Komuna/drejtoria e shërbimeve publike
Dendësi e kontrolluar dhe kufizim i ndërtimeve të larta në peizazhe të veçanta.	Afatgjatë (deri 10 vite)	Ri-shqyrtimi I dendësisë së banimit	Komuna/drejtoria e urbanizmit dhe mbrojtjes së mjedisit
Ndarje në burim, riciklim, pastrim i deponive ilegale dhe impiant për mbeturina të rrezikshme.	Afatmesëm (3-5 vite)	Sasia e mbeturinave të ricikluara; numri i deponive të pastruara; funksionaliteti i impiantit	Komuna/drejtoria për shërbime publike Donatorë/GIZ
Barriera akustike dhe kufizim i orareve të punimeve.	Afatshkurtër (1-2 vite)	Matje e nivelit të zhurmës; numri i barrierave akustike të vendosura	Komuna/drejtoria për shërbime publike

Menaxhim i rrezikut nga të nxehtit ekstrem dhe reduktim i efektit "heat island" përmes gjelbërimit.	Në vazhdimësi	Numri i masave të zbatuara për mbrojtje nga nxehtësia; Sipërfaqe e gjelbër e shtuar	Komuna/drejtoria e urbanizmit dhe mbrojtjes së mjedisit
---	---------------	---	---

Kategoria e zones: Zonat industriale		Objektivi I VSM: A01, A02, B01, D01, G01, H01, J01, K02	
Masat kryesore	Afatet	Indikatorët matës	Institucionet përgjegjëse
Zbatim i standardeve mjedisore për të siguruar përputhshmëri ligjore dhe ekologjike.	Afatshkurtër (1-2 vite)	Numri i inspektimeve; Raportet e përputhshmërisë	Komuna/inspekcioni Ministria e Mjedisit, Inspektorati i Punës,
Menaxhim i mbeturinave industriale dhe ndarja e tyre në burim për riciklim.	Afatmesëm (3-5 vite)	% e mbeturinave të ricikluara; Numri i impianteve funksionale	Komuna/drejtoria për shërbime publike
Monitorim i ndotjes së tokës dhe ujit për të siguruar kontroll të vazhdueshëm.	Afatgjatë (monitorim çdo vit)	Raportet e monitorimit; Nivelet e ndotjes kimike	Komuna/drejtoria e shëndetësisë Ministria e Mjedisit/Instituti Hidrometeorologjik, Ministria e shëndetësisë/Instituti i Shëndetit Publik
Rehabilitimi i zonave të dëmtuara vizualisht për të rikthyer peizazhin.	Afatgjatë (deri 10 vite)	Sipërfaqe e rehabilituar; Numri i projekteve të rikthimit të peizazhit	Komuna/drejtoria për shërbime publike
Përdorimi i teknologjive të pastra dhe të qeta për të ulur ndotjen dhe zhurmën.	Afatmesëm (3-5 vite)	Numri i teknologjive të instaluar; Reduktim i emisioneve dhe zhurmës	Komuna/inspekcioni Operatori ekonomik
Zonim i kontrolluar dhe distancim nga zonat e banimit për të mbrojtur komunitetin lokal.	Afatgjatë (deri 10 vite)	Numri i zonave të zonuara; distanca e respektuar nga banimet	Komuna/inspekcioni dhe drejtoria e urbanizmit dhe mbrojtjes së mjedisit

Kategoria e zones: Sipërfaqet ujore		Objektivi I VSM: A02, B01, C01, H01, K01, K02,	
Masat kryesore	Afatet	Indikatorët matës	Institucionet përgjegjëse
Mbulimi me rrjet kanalizimi i të gjitha vendbanimeve	Afatmesëm (3-5 vite)	% e vendbanimeve të mbuluara me kanalizim	Komuna/drejtoria për shërbime publike
Instalimi i sistemeve të trajtimit të ujërave të zeza	Afatmesëm (3-5 vite)	Numri i impianteve funksionale; cilësia e ujit pas trajtimit	Komuna/drejtoria për shërbime publike në bashkëpunim me MMPH dhe donatorë
Ndalimi/reduktimi i pesticideve kimike dhe promovimi i bujqësisë organike	Afatgjatë (deri 10 vite)	% e përdorimit të pesticideve të reduktuara; sipërfaqe e bujqësisë organike	Komuna/drejtoria për ekonomi-sektori I bujqësisë në bashkëpunim me GLV-në dhe shoqatat e fermerëve
Pastrimi i deponive ilegale pranë sipërfaqeve ujore	Afatshkurtër (1-2 vite)	Numri i deponive të pastruara	Komuna/drejtoria për shërbime publike
Fushata për reduktimin e përdorimit të pecetave të lagëta dhe promovimi	Afatshkurtër (1-2 vite)	Numri i fushatave të realizuara; reduktim i konsumit të pecetave të lagëta	Komuna/drejtoria për shërbime publike, drejtoria e arsimit, OJQ-të mjedisore

i alternativave biodegradueshme			
Verifikimi dhe krijimi i brezave mbrojtës përgjatë trupave ujorë	Afatmesëm (3-5 vite)	Sipërfaqe e brezave të krijuar	Komuna/drejtoria për shërbime publike në bashkëpunim me MMPHI
Monitorim i vazhdueshëm i cilësisë së ujit sipërfaqësor dhe nëntokësor	Afatgjatë (monitorim çdo vit)	Raportet e monitorimit; nivelet e ndotjes	Komuna/drejtoria për shërbime publike në bashkëpunim me institutin e shëndetësisë
Investime në sisteme të ujitjes efikase	Afatmesëm (3-5 vite)	Numri i sistemeve të instaluara; reduktim i konsumit të ujit të pijshëm për ujitje	Komuna/drejtoria për zhvillim ekonomik-sektori I bujqësisë në bashkëpunim me Ministrinë e bujqësisë dhe donatorë
Ndërgjegjësimit i komunitetit lokal për ruajtjen e pastërtisë së ujit	Afatshkurtër dhe i vazhdueshëm	Numri i fushatave informuese; pjesëmarrja e komunitetit	Komuna/drejtoria për shërbime publike, drejtoria e arsimit, OJQ-të mjedisore

Kategoria e zones: Zonat e komunikacionit dhe transportit		Objektivi I VSM: C01, D01, F01, F03, H01, L01, L02	
Masat kryesore	Afatet	Indikatorët matës	Institucionet përgjegjëse
Nxitja e përdorimit të transportit publik dhe alternativ-jomotorik (biçikleta, ecje)	Afatmesëm (3-5 vite)	Rritja e numrit të përdoruesve të transportit publik/jomotorik; reduktim i trafikut	Komuna/drejtoria për shërbime publike në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës, policinë e trafikut, OJQ-të mjedisore
Mbjellje e drunjve përgjatë rrugëve	Afatmesëm (3-5 vite)	Sipërfaqe e brezave të gjelbër të krijuar; cilësia e ajrit e përmirësuar	Komuna/drejtoria për shërbime publike në bashkëpunim me OJQ-të mjedisore dhe donatorë potencialë
Menaxhim i trafikut për reduktim të trafikut të ngjeshur	Afatshkurtër (1-2 vite)	Raportet e qarkullimit; reduktim i kohës së vonësave në trafik	Komuna/drejtoria për shërbime publike në bashkëpunim me policinë e trafikut
Vendosja e barrierave akustike pranë rrugëve kryesore (ku është e nevojshme)	Afatgjatë (deri 10 vite)	Numri i barrierave të vendosura; matje e nivelit të zhurmës	Komuna/drejtoria për shërbime publike në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe donatorë

Kategoria e zones: Zonat komerciale dhe turistike		Objektivi I VSM: C01, D01, E01, G01, G02, J01, K01	
Masat kryesore	Afatet	Indikatorët matës	Institucionet përgjegjëse
Planifikim i qëndrueshëm i turizmit dhe promovim i turizmit ekologjik	Afatgjatë (deri 10 vite)	Rritja bizneseve të turizmit ekologjik	Komuna/drejtoria për zhvillim ekonomik në bashkëpunim me Ministrinë e Industrisë/Agjencinë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë, Asociacionin Kosovar të Turizmit, GLV-në
Kontroll i kapaciteteve zhvillimore dhe kufizim i ndërtimeve në zona të ndjeshme	Afatmesëm (3-5 vite)	Numri i lejeve të kufizuara; sipërfaqe e ruajtur	Komuna/inspekcioni
Menaxhim i turizmit të qëndrueshëm në zonat e mbrojtura në vecasnti	Afatgjatë (deri 10 vite)	Raportet e menaxhimit; ruajtja e biodiversitetit	Komuna/inspekcioni në bashkëpunim me MMPH/Drejtorinë e Pakut Bjeshkëve të Nemuna

Parkun e Bjeshkëve të Nemuna			
Menaxhim i mbeturinave	Afatshkurtër (1-2 vite)	Sasia e mbeturinave të ricikluara; numri i deponive të pastruara	Komuna/drejtoria për shërbime publike
Mbështetje për bizneset e vogla me praktika të gjelbra dhe ekonomi qarkore	Afatmesëm (3-5 vite)	Numri i bizneseve të gjelbra; reduktim i mbeturinave	Komuna/drejtoria për zhvillim ekonomik-sektori I bujqësisë në bashkëpunim me Ministrinë e bujqësisë dhe donatorë, OJQ mjedisore
Kufizime për ngjarjet turistike dhe rekreative (koncerte, festivale)	Afatshkurtër (1-2 vite)	Numri i ngjarjeve të kufizuara; matje e nivelit të zhurmës	Komuna/inspekcioni
Krijimi i korridoreve ekologjike për lidhjen e habitateve	Afatgjatë (deri 10 vite)	Sipërfaqe e korridoreve të krijuar; rritje e diversitetit biologjik	Komuna/drejtoria e urbanizmit-sektori I mjedisit në bashkëpunim me MMPH, Drejtorinë e Parkut Bjeshkët e Nemuna, Agjencionin e Pyjeve
Ndërprerja e aktiviteteve të dëmshme në zonat e mbrojtura	Afatshkurtër dhe i vazhdueshëm	Numri i aktiviteteve të ndaluara; raportet e inspektimeve	Inspektorët relevant nga niveli qendror në bashkëpunim me Komunën/inspekcionin
Kufizimi i ndërtimeve të larta në zona me peizazh të veçantë	Afatmesëm (3-5 vite)	Numri i ndërtimeve të kufizuara; ruajtja e panoramave natyrore	Inspektorët relevant nga niveli qendror në bashkëpunim me Komunën/inspekcionin

Kategoria e zones: Miniera sipërfaqësore (gurthyysi)		Objektivi I VSM: A01, C01, D01, E01, F02, H01, J01	
Masat kryesore	Afatet	Indikatorët matës	Institucionet përgjegjëse
Kufizim i zgjerimit të aktivitetit	Afatshkurtër (1-2 vite)	Numri i lejeve të kufizuara për zgjerim; sipërfaqe e ruajtur	Inspektorët relevant nga niveli qendror në bashkëpunim me Komunën/inspekcionin
Monitorim i ndikimeve mjedisore	Afatgjatë (monitorim çdo vit)	Raportet e monitorimit;	Inspektorët relevant nga niveli qendror në bashkëpunim me komunën/inspekcioni dhe drejtoria e urbanizmit-sektori I mjedisit
Brez mbrojtës gjelbërues nga kufijtë e vendbanimeve përreth	Afatmesëm (3-5 vite)	Sipërfaqe e brezave të gjelbër të krijuar; reduktim i ndikimit vizual dhe akustik	Komuna/drejtoria e shërbimeve publike në bashkëpunim me drejtorinë e urbanizmit-sektori I mjedisit

Kategoria e zones: Zonat mbishtresore_ përmytjet, rrëshqitja e dheut dhe erozion		Objektivi I VSM: A01, E01, F02, F03, H01, J01	
Masat kryesore	Afatet	Indikatorët matës	Institucionet përgjegjëse
Ndërtimi i digave mbrojtëse në zonat e rrezikuara nga përmytjet konform planeve të nivelit qendror	Afatgjatë (deri 10 vite)	Numri i digave të ndërtuara; sipërfaqe e mbrojtur; reduktim i rasteve të përmytjes	MMPHI- në bashkëpunim me Komunën/drejtorinë e shërbimeve publike
Pastrimi dhe mirëmbajtja e kanaleve kulluese	Afatshkurtër dhe i vazhdueshëm	Numri i kanaleve të pastruara; raportet e mirëmbajtjes; reduktim i bllokimeve	Komuna/drejtoria e shërbimeve publike në bashkëpunim me sektorin e emergjencave

Sisteme paralajmëruese të hershme për përmytje	Afatmesëm (3-5 vite)	Instalimi i sistemeve të alarmit; numri i paralajmërimeve të lëshuara; reagimi i komunitetit	Instituti Hidrometeorologjik, AME në bashkërendim me Komunën/sektori I emergjencave
Rregullimi i shtratit të lumenjve dhe mbrojtja e brigjeve	Afatgjatë (deri 10 vite)	Numri i projekteve të realizuara; sipërfaqe e stabilizuar; reduktim i erozionit dhe përmytjeve	Komuna/drejtoria e urbanizmit në bashkëpunim me MMPHI dhe donatorë
Fushata ndërgjegjësimi për komunitetin mbi rrezikun nga përmytjet	Afatshkurtër dhe i vazhdueshëm	Numri i fushatave të zhvilluara; pjesëmarrja e komunitetit; rritja e njohurive mbi masat mbrojtëse	Komuna/sektori i emergjencave në bashkëpunim me OJQ-të lokale
Pyllëzim në zonat me erozion të mesëm	Afatmesëm (3-5 vite)	Sipërfaqe e pyllëzuar; numri i fidanëve të mbjellë; reduktim i erozionit	Komuna/drejtoria e shërbimeve publike në bashkërendim me drejtorinë e urbanizmit- sektori I mjedisit dhe bashkëpunim me MMPH si dhe Agjencionin e pyjeve
Stabilizimi i terrenit me rrëshqitje të dheut përmes mbjelljes së bimësisë dhe teknikave inxhinierike	Afatgjatë (deri 10 vite)	Numri i projekteve inxhinierike të zbatuara; reduktim i rasteve të rrëshqitjes; sipërfaqe e stabilizuar	Komuna/drejtoria e shërbimeve publike në bashkërendim me drejtorinë e urbanizmit- sektori I mjedisit dhe bashkëpunim me MMPH si dhe Agjencionin e pyjeve
Monitorim i rrezikut nga erozioni dhe rrëshqitjet	Afatshkurtër dhe i vazhdueshëm	Raportet e monitorimit	Komuna/inspekcioni në bashkërendim me sektorin e emergjencave

Kategoria e zones: Zonat bujqësore		Objektivi I VSM: AO1, AO2, BO1, BO2, FO3, GO1, GO2, HO1, KO1	
Masat kryesore	Afatet	Indikatorët matës	Institucionet përgjegjëse
Përdorim i kontrolluar i pesticideve dhe plehrave	Afatshkurtër (1-2 vite)	Reduktim i përdorimit të pesticideve; raportet e analizave të tokës	Komuna/drejtoria për zhvillim ekonomik-sektori I bujqësisë në bashkëpunim me Ministrinë e bujqësisë
Monitorim i cilësisë së tokës dhe ujit (analiza periodike)	Afatgjatë (monitorim çdo vit)	Numri i analizave të kryera; raportet e cilësisë së ujit/tokës	Komuna/drejtoria e shëndetësisë në bashkërendim me Institutin e shëndetit publik të Kosovës
Adaptimi i bujqësisë ndaj kushteve klimatike (kultura rezistente, ujitje e zgjuar)	Afatgjatë (deri 10 vite)	Numri i kulturave rezistente të mbjella; sipërfaqe e ujitur me sisteme efikase	Komuna/drejtoria për zhvillim ekonomik-sektori I bujqësisë në bashkëpunim me Ministrinë e bujqësisë dhe donatorë
Zbatim i praktikave të bujqësisë së qëndrueshme (rotacioni i kulturave, plehra organike, teknika konservuese)	Afatmesëm (3-5 vite)	Sipërfaqe e trajtuar me plehra organike; numri i fermave që zbatojnë rotacion	Komuna/drejtoria për zhvillim ekonomik-sektori I bujqësisë në bashkëpunim me Ministrinë e bujqësisë dhe donatorë, shoqatat e fermerëve, GLV-në
Kufizim i ndërtimeve në tokat pjellore	Afatmesëm (3-5 vite)	Sipërfaqe e ruajtur bujqësore; numri i lejeve të refuzuara për ndërtim	Komuna/inspekcioni në bashkërendim me drejtorinë e urbanizmit- sektori I mjedisit dhe drejtoria e zhvillimit ekonomik-sektori I bujqësisë

Trajnim dhe ndërgjegjësim i fermerëve	Afatshkurtër (1-2 vite)	Numri i trajnimeve të realizuara; numri i fermerëve të trajnuar	Komuna/drejtoria për zhvillim ekonomik-sektori I bujqësisë në bashkëpunim me Ministrinë e bujqësisë dhe donatorë, shoqatat e fermerëve, GLV-në, OJQ respektive
Fushata të ndërgjegjësimit publik për përdorimin e qëndrueshëm të tokës	Afatshkurtër dhe i vazhdueshëm	Numri i fushatave të realizuara; pjesëmarrja e komunitetit	Komuna/drejtoria për zhvillim ekonomik-sektori I bujqësisë në bashkëpunim me donatorë, shoqatat e fermerëve, GLV-në, OJQ respektive
Menaxhim i mbeturinave bujqësore për kompostim	Afatmesëm (3-5 vite)	Sasia e kompostit të prodhuar; numri i fermave që përdorin kompostim	Komuna/drejtoria për zhvillim ekonomik-sektori I bujqësisë në bashkëpunim me Ministrinë e bujqësisë dhe donatorë, shoqatat e fermerëve, GLV-në, OJQ respektive

VII. Rezultatet e konsultimeve me organet, organizatat dhe publikun

Gjatë procesit të hartimit të Raportit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM) për HZK-në e Komunës së Deçanit janë zhvilluar takime konsultative me Drejtorinë e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Mbrojtje të Mjedisit, zyrtarët mjedisorë dhe akterë të tjerë relevantë institucionalë, me qëllim të shqyrtimit të të gjitha aspekteve të HZK-së që potencialisht mund të kenë ndikim negativ në mjedis. Në kuadër të konsultimeve është shqyrtuar edhe Plani i Veprimit, me fokus në identifikimin e projekteve dhe veprimeve që mund të kenë ndikim në mjedis, shqyrtimin e masave për mbrojtjen e mjedisit dhe integrimin e tyre në procesin e planifikimit hapësinor.

Gjatë takimeve konsultative janë trajtuar çështje që lidhen me mbrojtjen e tokës bujqësore, menaxhimin e ujërave, mbrojtjen e pyjeve dhe biodiversitetit, zhvillimin e zonave turistike, menaxhimin e mbeturinave, kontrollin e zhvillimit urban dhe mbrojtjen e trashëgimisë natyrore dhe kulturore. Është theksuar nevoja për monitorim dhe kontroll të vazhdueshëm të zhvillimeve në zonat e ndjeshme mjedisore, veçanërisht në territorin e Parkut Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” dhe përgjatë sipërfaqeve ujore.

Në pajtim me procedurat ligjore për VSM, Raporti i VSM-së do të jetë i qasshëm për publikun për një periudhë prej 30 ditësh para organizimit të debatit publik. Gjatë kësaj periudhe, qytetarët, organizatat dhe palët e interesit do të kenë mundësi të shqyrtojnë përmbajtjen e raportit, të japin komente dhe të shprehin mospajtimet e tyre lidhur me aspektet mjedisore dhe zhvillimore të HZK-së.

Të gjitha komentet, sugjerimet dhe vërejtjet e pranuar gjatë procesit të konsultimit publik do të përmbledhen në një raport të veçantë dhe do të shqyrtohen nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Mbrojtje të Mjedisit. Palët e interesuara do të informohen dhe do të marrin përgjigje lidhur me trajtimin e komenteve të tyre brenda afateve të përcaktuara procedurale.

VIII Konkluzione dhe rekomandime

HZK-ja e Komunës së Deçanit përfaqëson dokumentin kryesor rregullativ për organizimin dhe zhvillimin hapësinor të komunës, me fokus në zhvillimin e qëndrueshëm, përmirësimin e kushteve

socio-ekonomike dhe mbrojtjen e mjedisit. Dokumenti përcakton strukturën funksionale të territorit përmes zonave urbane, suburbane, rurale, bujqësore, pyjore, turistike, industriale dhe të mbrojtura, duke krijuar bazë të qartë për kontrollin e zhvillimit dhe menaxhimin e ndikimeve mjedisore.

Zonat urbane dhe qendrore paraqiten si qendra të zhvillimit ekonomik, administrativ dhe shërbyes, ku lejohet zhvillim më intensiv i banimit, tregtisë dhe shërbimeve publike. Ndërkohë, zonat suburbane krijojnë tranzicion ndërmjet qytetit dhe hapësirës rurale, duke mundësuar zhvillim të kontrolluar të banimit dhe funksioneve të përziera. Zonat rurale, bujqësore dhe pyjore kanë rol të rëndësishëm në ruajtjen e identitetit rural, tokës pjellore, biodiversitetit dhe ekuilibrit ekologjik të komunës.

Nga analiza e VSM-së rezulton se zhvillimet e planifikuara pritet të ndikojnë pozitivisht në përmirësimin e infrastrukturës, ekonomisë lokale, turizmit dhe shërbimeve publike. Investimet në ujësjellës, kanalizim, trajtim të ujërave të zeza, energji, menaxhim të mbeturinave dhe infrastrukturë rrugore do të kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së jetës dhe shëndetit publik. Megjithatë, urbanizimi, zgjerimi i infrastrukturës dhe aktivitetet ekonomike mund të rrisin presionin mbi tokën, ujërat, biodiversitetin dhe peizazhin, nëse nuk zbatohen masa të qarta mbrojtëse dhe monitoruese.

Një prej prioriteteve kryesore mbetet mbrojtja e tokës bujqësore dhe kontrolli i zhvillimit urban. HZK-ja thekson nevojën për ruajtjen e tokave bujqësore me vlerë të lartë, kufizimin e parcelimit të pakontrolluar dhe orientimin e aktivitetëve industriale në zona të përshtatshme. Po ashtu, zonat me erozion, rrëshqitje të dheut, vërshime kërkojnë trajtim të veçantë dhe masa mbrojtëse specifike. Në këto zona rekomandohen pyllëzimi, rehabilitimi i tokës, krijimi i brezave mbrojtës dhe kontrolli i aktivitetëve ndërtimore dhe minerare.

Burimet ujore paraqesin aset të rëndësishëm natyror dhe strategjik për komunën. Megjithëse furnizimi me ujë është i zhvilluar në pjesën më të madhe të territorit, mbeten sfida të rëndësishme si humbjet në rrjet, mungesa e kanalizimit në disa zona dhe rreziku nga ndotja e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore. Në këtë drejtim rekomandohet modernizimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, ndërtimi i impianteve për trajtimin e ujërave të zeza dhe mbrojtja e brezave përgjatë lumenjve dhe sipërfaqeve ujore.

Në aspektin e cilësisë së ajrit dhe ndryshimeve klimatike, trafiku, ngrohja me lëndë djegëse dhe aktivitetet ekonomike paraqesin burimet kryesore të ndotjes. Në të njëjtën kohë, pyjet, sipërfaqet e gjelbra dhe zonat e mbrojtura kanë rol të rëndësishëm në përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe ruajtjen e funksioneve ekologjike. Për këtë arsye rekomandohet zgjerimi i sipërfaqeve të gjelbra, mbrojtja e pyjeve, promovimi i transportit publik dhe shfrytëzimi i energjisë së ripërtëritshme.

Zhvillimi i turizmit dhe rekreacionit paraqet potencial të rëndësishëm ekonomik për komunën, veçanërisht në kuadër të Parkut Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”, zonave rekreative-turistike dhe trashëgimisë kulturore të Deçanit. Megjithatë, zhvillimi turistik duhet të jetë i kontrolluar dhe në përputhje me kapacitetet mjedisore të territorit, për të shmangur degradimin e peizazhit, biodiversitetit dhe vlerave natyrore e kulturore. Një prej aspekteve që kërkon vëmendje të shtuar lidhet me planifikimin e zonave turistike, për të cilat parashihet hartimi i 16 Planeve Rregulluese të Hollësishme (PRrH) në Zonën e Tretë të Planit Hapësinor të Parkut Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”. Përkundër faktit se këto plane parashihet të hartohen në harmoni me Planin Hapësinor të Parkut Kombëtar, zbatimi i tyre kërkon monitorim, kontroll dhe inspektim të vazhdueshëm institucional, me qëllim të mbrojtjes së biodiversitetit, peizazhit dhe vlerave natyrore të bjeshkëve nga zhvillimet e pakontrolluara dhe presioni urbanistik.

Një prej çështjeve që kërkon rishqyrtim të kujdesshëm lidhet me densitetin e planifikuar në zonën qendrore të qytetit. Duke marrë parasysh se sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës në Komunën e Deçanit janë evidentuar rreth 3030 njësi të zbrazëta të banimit, si dhe kapacitetet

aktuale infrastrukture dhe ndjeshmërinë mjedisore të zonës qendrore, rekomandohet që synimi për densitet prej 500 banorë/ha të rivlerësohet në raport me nevojat reale zhvillimore të komunës. Në këtë drejtim, prioritet duhet t'i jepet shfrytëzimit dhe revitalizimit të fondit ekzistues të banimit, përmirësimit të infrastrukturës dhe ruajtjes së cilësisë urbane dhe mjedisore, me qëllim të shmangies së mbingarkesës së infrastrukturës ekzistuese dhe presionit të panevojshëm mbi hapësirën urbane. Zhvillimi i infrastrukturës sociale dhe publike, përfshirë objektet arsimore, shëndetësore, sportive dhe rekreative, do të ndikojë drejtpërdrejt në rritjen e mirëqenies sociale dhe cilësisë së jetës së banorëve. Megjithatë, zhvillimi i tyre duhet të respektojë standardet teknike të planifikimit, raportin ndërmjet sipërfaqeve të ndërtuara dhe gjelbërimit, si dhe parimet e qasjes universale dhe eficiencës energjetike.

Në përfundim, HZK-ja e Deçanit krijon bazë të rëndësishme për zhvillim të qëndrueshëm territorial dhe ekonomik, por zbatimi i saj kërkon koordinim institucional, monitorim të vazhdueshëm të indikatorëve mjedisorë dhe zbatim konsekuent të masave të VSM-së. Ruajtja e balancit ndërmjet zhvillimit ekonomik, mbrojtjes së mjedisit dhe konservimit të trashëgimisë natyrore e kulturore mbetet kusht themelor për zhvillimin afatgjatë të komunës

Shtojce:Permbledhja joteknike-dokument I veçantë.